



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Bashkinë Devoll”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR DHE I PËRPUTHSHMËRISË”
TË USHTRUAR NË BASHKINË DEVOLL

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.	4
3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	14
II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit).....	19
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA	19
1. Objektivat e auditimit.....	19
2. Qëllimi i auditimit.....	19
3. Identifikimi i çështjes.....	20
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	20
5. Përgjegjësitë e audituesve	20
6. Kriteret e vlerësimit	20
7. Standardet e auditimit.....	21
8. Metodologjia e auditimit	22
9. Dokumentimi i auditimit.....	23
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	24
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.	24
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	24
2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.....	24
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	41
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.....	58
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	90
2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	156
2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njësisë Vendore.....	167
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	170
E. MASA DISIPLINORE.....	194

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 868/1 Prot, datë 10.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 13.10.2023 deri në datë 30.11.2023, në subjektin Bashkia Devoll u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, lejet e ndërtimit, aktiviteti i IMT, zbatimi i rekomandimeve, administrimi i aseteve, si dhe çështje të dala gjatë auditimit.

Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohej), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 14 akt konstatime dhe 1 (një) akt verifikim.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshtime, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë e materialit në projektraport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Pas trajtimit të observacioneve për projektraportin, bazuar në shkresën me nr. 257 prot., datë 24.01.2024, me anë të së cilës deklarohet se janë njohur me Projektraportin e auditimit, nga Bashkia Devoll nuk është kërkuar që të kryhet takim përmbyllës pranë zyrave të KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	Përmbledhje e gjetjes	Referenc a në raportin përfundi mtar (Nr. Fq)	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Devoll konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën 7,807,399 lekë shumë e cili i përket vetëm abonentëve privat. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën 26,752,371 lekë . Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, janë në vlerën 34,559,770 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll.	42-59	I lartë	Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale 34,559,770 lekë . a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare. b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite

				të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal. e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq. f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
2	Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, sipas listave të vendosura në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 1,635,662 lekë për 44 persona, kanë paguar detyrimet 40 persona me vlerë 1,498,217 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej 4 persona me vlerë 137,445 lekë . Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga vitet e mëparshme janë 29 persona me vlerë 2,176,456 lekë . Vlera debitorë 2,313,901 lekë është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll .	42-59	I lartë	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 2,313,901 lekë ndaj 33 personave. Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Korçë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
3	Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konstatohet se, Bashkia Devoll nuk ka lidhur kontrata të reja por ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Në total për 6 njësitë administrative janë aktive 13 kontrata për vitin 2022. Për vitin 2022 janë 13 kontrata aktive sipas pasqyrës nr.10 të paraqitur në anekset e projekt raportit të auditimit. Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja, vlerën 21,538,000 lekë, nga	42-59	I lartë	Drejtoria e të Ardhurave, Liçensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financës Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë 21,376,000 lekë .

	ku është arkëtuar vlera 161,200 lekë, dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera 21,376,000lekë. Kjo shumë konsiderohet e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.			
4	Bashkia Devoll nuk ka lidhur kontratë qiraje me 3 subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave minimale ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit. Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Devoll kanë ushtruar aktivitet 5 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri gëlqeror dhe hekur nikel referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 113 ha, detyrimi dysheme/minimal është përlllogaritur përafërsisht 7,006,000 për vitin 2022 , për 3 subjekte vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll si rezultat mos lidhjes së kontratave.	42-59	I lartë	Nga Bashkia Devoll, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me: 1. T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura. 2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. 3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 113 ha, duke aplikuar tarifat dysheme/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (7,006,000 , për 3 subjektet e mësipërme).
5	Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Devoll dhe nga auditimi i tyre, rezulton se ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve gjithsej aktivë 9 pika të tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tij, ku detyrimi për taksën e autorizimeve që subjekte duhet të likuidojnë është 9,000,000 lekë. Kanë paguar detyrimin 6 subjekte me vlerë 6,000,000 lekë dhe 3 subjekte e kanë paguar atë pjesërisht, ku nga vlera 3,000,000 lekë është paguar vlera 1,600,000 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 1,200,000 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll.	42-59	I lartë	Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej 1,200,000 lekë nga 3 subjektet, <i>respektivisht</i> ; 1. vlera 200,000 lekë nga subjekti “R.H.” ShPK; 2. vlera 400,000 lekë nga subjekti “M.” ShPK; dhe 3. vlera 600,000 lekë nga subjekti “I.O.” ShPK.
6	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt <i>“Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”</i> , me fond limit në shumën 27,650,357 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë, u konstatua: Referuar raportit përmbledhës të hartuar dhe nënshkruar nga KVO dhe titullari i AK, ku për këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE nga të cilët janë s'kualifikuar 2 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, vërehet se është s'kualifikuar OE “A.A.” ShPK, me vlerë oferte në	90-156	I lartë	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mire përdorimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomikitet.

	shumën 19,037,241 lekë me arsyen se nuk ka paraqitur vërtetimin për të provuar kapacitetet financiare për xhiron vjetore për vitet 2019,2020 dhe 2021, ku për një prej këtyre viteve vlera e xhiros së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Vlerësimi i KVO nuk është bërë i drejtë pasi OE “A.A.” ShPK ka paraqitur bilancet e viteve 2019 dhe 2020, në të cilat është evidente në llogaritë përkatëse situata e qarkullimit vjetor disa herë më shumë se vlera e objektit të kontratës për këtë procedurë. Pra rrjedhimisht nëse KVO do të kualifikonte këtë OE, në përputhje me qëllimin dhe parimet e LPP, Bashkia Devoll do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, në një diferencë prej 3,931,500 lekë (22,968,741-19,037,241) pa TVSh dhe një vlerë 4,717,800 lekë me TVSh e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Devoll. Kjo pasi dokumenti për xhiron vjetore, nuk ndikon thelbësisht në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet devijim i vogël, për përmbushjen e kontratës.			
7	Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 6 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 100, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak. Nga Bashkia Devoll për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 6 subjekte është likuiduar shuma 1,778,500 lekë. Vlera 1,778,500 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.	59-90	I lartë	2.1. Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.
8	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 (një) rast , Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë, sipas përcaktimeve të nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në përlllogaritjen e TNI-së për lejen e ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022. Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë	156-167	I lartë	Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të marren të gjitha masat për të përlllogaritur në mënyrë të saktë vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke e marrë në konsideratë koeficientet e çmimeve mesatare referuese të shitblerjes së hapësirave që përdoren për veprimtari ekonomike, tregtimi dhe shërbimi, si dhe për parkim të mbuluar dhe bodrume. Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të

	51,558,372.00 lekë. Sipas VKB-së me nr. 89, datë 20.12.2021, mbi “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Devoll”, vlera e TNI-së për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi është 4% mbi çmimin e shitjes për metër katror. Referuar këtyre të dhënave, si dhe rilllogaritjes nga ana e grupit të auditimit, është konstatuar se vlera e saktë e TNI-së është 2,444,400 lekë . Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Devoll është 2,319,492 lekë . Diferenca prej 124,908 lekë përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Devoll. Kjo diferencë ka ardhur nga llogaritja e gabuar e taksës për katin nëntokë dhe katin përdhe.			Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për TNI e pallogaritur në shumën 124,908 lekë, nga zhvilluesi z. K.Q. për lejen e ndërtimit nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022 me objekt “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”.
9	Në objektin “ Ujësjetllësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll ” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK me Nr.3322Prot. datë 10.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 79,541,080 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre të ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.1169Prot. datë 05.04.2022, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 7 (shtatë) zëra punimesh në shumën 1,428,100 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.	90-156	I lartë	Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës 1,428,100 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK.
10	Në objektin “ Ndërtim i ujësjetllësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras ” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 147,992,038 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me amendimet përkatëse, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën 907,955.53 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.	90-156	I lartë	Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës 907,955 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e dëmtuara nuk kryhen dhe materialet nuk dorëzohen, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr.3388Prot., datë 16.11.2020 për realizimin e punimeve civile.
11	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 3 (tre) procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kritere të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në kufizimin e pjesëmarrjes. Gjithashtu rezultoi se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë	90-156	I lartë	Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj

	teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. Këto kritere nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP, vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet, të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Në dokumentin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike rezulton nuk është bërë argumentimi tekniko/ligjor i tyre.			operatorëve ekonomikë.
12	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; në 5 (pesë) procedura prokurimi, nuk janë argumentuar specifikimet teknike të në mënyrë teknike dhe ligjore. Gjithashtu në 4(katër) procedura rezulton se nuk është bërë një përshkrim i objektit të kontratës në lidhje me përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit të aplikuar nga AK, për mallrat apo punët, apo shërbimet që do të kryhen. Në 2 (dy) raste rezulton se nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit të kontratës.	90-156	I lartë	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrat të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit referuar specifikimeve teknike të objektit të kontratës.
13	Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt <i>"Blerje karburant për nevojat e Bashkisë Devoll Naftë dhe Benzine"</i>, Autoriteti Kontraktor nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës së kontratës sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 <i>"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"</i>, neni 76, pika 2-3, pasi nuk dokumentohet dhe argumentohet sasia e karburantit mbi të cilën është hartuar fondi limit. Në njësinë e prokurimit nuk është asnjë nga anëtarët specialist i fushës, i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kriterëve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet.	90-156	I lartë	Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit. Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të specifikimeve teknike.
14	Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla konstatohet se: -Në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.. Janë kryer 4 procedura blerje me vlera të vogla ndërkohë që këto	90-156	I lartë	Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që: -Përgjatë hartimit të regjistrat të parashikimeve të prokurimeve, të

	procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtin objekt prokurimi Si rezultat i copëzimit dhe përpjesëtimit të vlerave të kontratave dhe fondeve të tyre, kanë sjellë për pasojë shmangie nga procedurat standarde të prokurimit. -Në 10 raste në SPE është publikuar ftesa për ofertë në të cilën janë përfshirë specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim. Në këtë dokument konstatohet se nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk janë argumentuar kriteret e veçanta për kualifikim; -Në 2 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla në ftesën për ofertë janë konstatuar kriteret jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çënojnë pjesëmarrjen e operatorë ekonomikë. -Në 4 raste në SPE nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë). -Në 1 rast referuar procesverbalit të hapjes dhe verifikimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla është s'kualifikuar një operatorë ekonomik për mospërputhje të fushës së veprimtarisë nga objekti i prokurimit. -Në 3 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë. -Në 3 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Devoll në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.			shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh. -Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim. -Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s'kualifikimit të tyre. -Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet s'kualifikimi i tyre. -Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.
15	Në objektin <u>“Ujësjiellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”</u> dhe <u>“Ndërtim i ujësjiellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidhohvë, Njësia Administrative Miras”</u> nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe nga vizita në terren u konstatua se në të gjitha pikat ku janë vendosur pajisjet e klorinimit me pjesët përbërëse nuk ishin në funksion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës, e kështu sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion.	90-156	I lartë	Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.
16	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se për lejen e ndërtimit me vendim me nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022 për “2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë”, me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga ndërtimet e tjera, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira	156-167	I lartë	Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të

	publike, konkretisht: - Dy objektet nuk respektojnë distancat urbane ndërtesë – ndërtesë nga njëra-tjetra, pasi distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve do të duhej të ishte 10 metra, ndërsa distanca e miratuar është 3 metra, në kundërshtim me nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 3; - Nuk respektojnë distancat nga kufiri i pronës, pasi distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve dhe kufirit të pronës do të duhej të ishte 5 metra, ndërsa distanca e miratuar është 3.2 metra, në kundërshtim me nenin 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1.			saktë në dokumentacionin shoqërues, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.
17	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se në 3 (tre) raste projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, konkretisht: 1. Për leje ndërtimi për “Stallë dhe ambiente ndihmëse”, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, është konstatuar se në projektin arkitektonik mungojnë prerjet teknike (dy të tilla), rrjedhimisht ky dokument nuk është i plotë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1/1, nënpika i); mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv dhe të raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit arkitektonik, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika g). 2. Për leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, është konstatuar se leja e zhvillimit, me vendim nr. 3824/1, datë 28.12.2021, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika d); mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në kundërshtim me shtojcën 2 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020; mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për të gjithë hartuesit e projekteve që përbëjnë projektin ndërtimor, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon certifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të	156-167	I lartë	Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor. SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve. SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë së mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime. Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të

	energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika g). 3. Për leje ndërtimi për “2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë”, me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022, është konstatuar se leja e zhvillimit, me vendim nr. 394/1, datë 22.02.2022, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika d); mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv, elektrik dhe hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon çertifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); deklarata e hartuesit të projektit arkitektonik nuk është e saktë, pasi në të citohet se: “se kam hartuar projektin konstruktiv për objektin”, ndërkohë që znj. Bruna Arkaxhiu ka hartuar projektin arkitektonik dhe jo atë konstruktiv), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre (3) muajt e fundit.			tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.
18	Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 2 (dy) raste Bashkia Devoll dhe SPZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6, SPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme: 1. Për leje ndërtimi për “Stallë dhe ambiente ndihmëse”, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, është konstatuar se nuk është kryer konvertimi i resursit të tokës, nga tokë “arë” në tokë “truall”, duke mos marrë në konsideratë kriteret e VKM-në nr. 440, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5; Nuk është respektuar VKM-në nr. 12, datë 27.02.2019, për “Miratimin e lejeve të zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urbane (UB), bujqësore (B) dhe Natyror (N)”, pika 6, pasi sipas kësaj VKM-je, autoritetet vendore mund të miratojnë lejet e ndërtimit vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv nga AZHT dhe pas njoftimit të KKT-së. Nga auditimi konstatohet se nuk është kërkuar mendimi i AZHT, gjithashtu nuk	156-167	I lartë	Spektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

	është njoftuar KKT; Nuk është kërkuar mendimi i AKM-së; Nuk është kërkuar mendimi i OST-së. 2. Për leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Efiçencës së Energjisë, për dhënie e konformitetit mbi raportin e auditimit të efiçencës së energjisë; Nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar, mbi dhënien e konformitetit të projektit në lidhje me respektimin e distancave nga aksi nacional Korçë – Kapshticë, si dhe mbi marrjen e informacioneve nga ana e ARRSH-së për projekte të mundshme zgjerimi të kësaj rruge.			
19	Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT bashkia Devoll, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll janë vendosur 3 gjoba në vlerën 600,000 lekë nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë gjobe, një gjobë me vlerë 500.000 lekë është falur me vendim gjykate me Nr.2587-(352) date 23.11.2022 duke mbetur pa u arkëtuar vlera 100,000 lekë, a)duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 100,000 lekë. b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjohës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”. c-Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.	167-170	I lartë	Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të ri kërkohet edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin për arkëtimin e 2 kundërvajtësve në vlerën 100,000 lekë), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përlllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.
20	Nga auditimi i dokumentacionit të Pasqyrave financiare rezultoi se Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 142,546,292 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 18,549,440 lekë dhe pakësim në vlerën 183,527,525 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave. b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 4,524,882 lekë. Gjatë vitit 2022	59-90	I lartë	Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndo shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 16,646,691 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

	për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,215,358 lekë dhe pakësim në vlerën 13,337,167 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,646,691 lekë.			
21	Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Devoll kryhet në programin Excel. Drejtoria nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Devoll i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.	42-59	I lartë	Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.
22	Bashkia Devoll në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 51,000,950 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit 2022 vlera 49,606,531 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 11,506,596 lekë për detyrimet e prapambetura. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 35,725,601 lekë për faturat e pranura gjatë periudhës 01.01.2022-31.10.2022 dhe për periudhën 01.11.2021-31.12.2021 janë krijuar detyrime në vlerën 36,592,665 lekë. Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura është 115,580,200 leke. Situata e faturave të prapambetura e ka çuar Bashkinë Devoll në vështirësi financiare.	59-90	I lartë	Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit
23	Nga auditimi i auditit të brendshëm është konstatuar se gjatë vitit 2022, kishte në përbërjen e saj dy punonjës, përkatësisht dy specialiste auditimi. Në strukturën e auditit të brendshëm nuk ka përgjegjës sektori që të mbulojë pozicionin e tillë, për periudhën në objekt auditimi viti 2022, në mospërputhje me ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.	25-42	I mesëm	Kryetari i Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës së NJBA.

3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionimi i auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll dhe japim opinion për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, fondet neto, investimet e aktivet afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i modifikuar/kualifikuar

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të modifikuar (kualifikuar)**¹ për llogaritë vjetore të vitit 2022 të Bashkisë Devoll, duke arritur në përfundimin se anomali të konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të shprehura në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale. Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Përshkrim i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë nivelin e materialitetit për shpenzimet, i cili ka vlerën 13,085 mijë lekë, si dhe faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si më poshtë:

-Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 135,072,931 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 79,935,202 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 79,935,202 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 20,627,875 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 20,627,875 lekë.

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” më datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 66,670,236 lekë, në këtë llogari nuk janë përfshirë debitorët nga taksat dhe tarifat vendore.

¹ “Opinion i modifikuar”, jepet në raste kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore.

-Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

-Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 768,513,311 lekë kosto historike është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) dhe në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,017,277,250 lekë kosto historike është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht, Hoçisht dhe Miras të pa analizuar që ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Devoll nga 345 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 10 prej tyre posedon titull pronësie.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 146,304,014 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e grandeve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

-Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,705,731 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,605,392 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 632,794 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 58,560,742 lekë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 10,224,794 lekë, nga të cilat 2,307,917 lekë i përkasin 5 kontratave të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Devoll nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

-Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 2,408,318,717 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 490,471,432 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,193,422 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 5,523,841 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 110,562,369 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektimi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Devoll, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave, veprimeve me bankën, zbatimin e buxhetit, miratimin e lejeve të zhvillimit/ndërtimit, etj.

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit, në tërësi ka rezultuar se aktiviteti i Bashkisë Devoll, është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me kuadrin ligjor dhe rregulloret e zbatueshme në fushat e menaxhimit financiar dhe kontrollit, prokurimit publik, nëpunësit civil, etj. Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar** mbi përputhshmërinë.

Ne kemi kryer auditimin e përputhshmërisë në mbështetje me Ligjin nr. 154/2014, miratuar në datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në përputhje me ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 29.12.2022. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI P-10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi i Etikës. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.56 , datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së.

Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit ***i kualifikuar***, me përjashtim të një ndonjë rasti që është material por jo i përhapur në administrimin e dokumentacionit të dosjes së tenderimit.

Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë:

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

-Bashkia DEVOLL nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Në total në pronësi të Bashkisë Devoll janë 3,036 pasuri të transferuara sipas VKM-ve përkatëse nga të cilat vetëm për 64 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie.

-Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Devoll dhe Njësive Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim

hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët, duke bërë që detyrimet e pa arkëtuara për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në kenë vlerën 34,559,770 lekë nga të cilat 26,752,371 lekë i përket vitit 2022.

-Llogaria 401-408 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 144,568,207 lekë ndërsa llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 16,646,691 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash et., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

-Në 2 raste në procedurat e prokurimit janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe konkretisht për procedurat me objekt: “*RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll*”, “*Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara*”.

-Në dy kontrata zbatimi për punë civile u konstatuan dëm ekonomik në shumën 2,336,055 lekë.

-Janë konstatuar anomali në fushën e lejeve të ndërtimit dhe zbatimit të tyre në teren.

1-Në 2 raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj.

2-Në 3 raste projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore.

3-Në 1 Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë.

4-Në 2 raste nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit

5-Në 1 nuk janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e kontrolleve dhe inspektimeve të nevojshme për ato raste që aplikojnë për leje ndërtimi, si dhe për inspektimin që këto struktura duhet të ushtrojnë mbi objektet e pajisura me leje ndërtimi.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Devoll:

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Devoll.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në

raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 868/1 Prot, datë 10.10.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, i ndryshuar, nga data 13.10.2023 deri në datë 30.11.2023, në subjektin Bashkia DEVOLL u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- | | | | |
|----|----|-----|-------------------------|
| 1. | E. | M. | <i>Përgjegjës grupi</i> |
| 2. | K. | F. | <i>Anëtar</i> |
| 3. | M. | H. | <i>Anëtar</i> |
| 4. | K. | H. | <i>Anëtar</i> |
| 5. | S. | H. | <i>Anëtar</i> |
| 6. | P. | Xh. | <i>Anëtar</i> |

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie.

Marrësi: Projekt Raporti i Auditimi i drejtohet subjektit të audituar Bashkia Devoll.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Devoll kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)²;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Devoll është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse

²Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë DEVOLL dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Auditin e Brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2022.
- Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 01.01.2021-31.12.2022.
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- Mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Devoll.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Bashkinë Devoll.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Devoll, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Devoll është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Devoll. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, u ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- V.K.M nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- V.K.M Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- V.K.M Nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzim i KM nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH^{-së}”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{-së} e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë Devoll, etj.
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Devoll grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë DEVOLL me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale³.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH^{ja} aplikon⁴.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe *së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

³ ISSAI 1315

⁴ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

Zona Gjeografike: Devolli kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare, sigurimi i të ardhurave të cilës mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër. Për shkak të pozicionit të saj kufitar me shtetin grek, një numër i konsiderueshëm banorësh kanë emigruar prej vitesh, duke gjeneruar të ardhura jo vetëm për veten e tyre por edhe për familjet e fshatrave.

Shumë zona të Devollit kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë ku banorët kanë braktisur totalisht fshatrat e thellë për t'u vendosur në zona më afër qytetit duke u fokusuar tek puna në bujqësi për shkak se toka është produktive. Përveç kultivimit të kulturave të ndryshme, si të lashtat dhe perimet, banorët merren shumë me pemëtarinë duke qenë ndër zonat me prodhim më të lartë në vend. Blegtoria është një tjetër aspekt përmes të cilës banorët gjenerojnë të ardhura, por kjo ka mbetur në nivelin e bizneseve familjare ndërsa mungesa e një thertore është shqetësim që duhet zgjidhur.

Investimet në infrastrukturë kanë qenë të mjaftueshme, por ka mangësi në rrugët dytësore të cilat do ishin në funksion të fermerëve për të lehtësuar aksesin në tokat bujqësore, si dhe ndërlidhjen e fshatrave të thellë të njësive administrative Miras. Për dekada, banorët kanë prerë pyjet duke shkaktuar dëme të pakthyeshme ndërsa pas rrafshimit të tyre ngrihet shqetësimi i gjetjes së burimeve alternative për ngrohje.

Misioni i Bashkisë Devoll është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve. duke garantuar vetë-qeverisjes në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore. Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

2.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në zbatim të pikës nr. 1, dhe nën-pikës nr. 1.1, të programit të auditimit nr. 868/1 prot., datë 10.10.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit.
2. Struktura organizative me ndryshimet përkatëse.
3. Urdhrat për caktimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues.
4. Kod sjellje, etike ose udhëzim mbi zbatimin e etikës.
5. Urdhrat për caktimin e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit strategjik.

6. Deklarata e cilësisë, raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, pyetësorët e vetëvlerësimit të dorëzuar në Ministrinë e Financave.

7. Dokumentacion tjetër mbështetës.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit: “Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm”, Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Devoll, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

-Bashkia Devoll ka Kod të Etikës, në nenet 35 dhe 36 të Rregullores së Brendshme miratuar me vendim të Kryetarit nr.103 date 24.02.2021, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë çdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, ka trajnime për këto raste zhvilluar në date 06.12.2022 nr.11 prot.

-Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë ngritur urdhrat e kryetarit në lidhje me mbrojtjen e sinjalizuesve. Në Rregulloren e Brendshme në nenin 35 janë përcaktuar veprimet që parandalohen, të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes, ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Për shkeljet e administrative në lidhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik” në nenin 90 të Rregullores së Brendshme janë parashikuar përgjegjësia administrative dhe sanksionet. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik.

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit(zyrën e protokoll-arkivit), duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, në strukturën e cila do të trajtoj ankesat dhe kërkesat, strukturë e cila nuk është përcaktuar.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në 6 muaj.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat e dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkyetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore. Për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

-është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Devoll me Vendimin e Kryetarit nr. 95, datë 31.03.2022

-është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar plan veprimet e menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtor janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilin drejtor sipas funksioneve që ato mbulojnë. Po kështu edhe në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

-Bashkia Devoll ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore.

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

-Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

-Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmban të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose tëspecializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Nuk ka një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Devoll është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave.

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për çdo vit. NA për çdo vit ka nxjerrë Urdhrat e ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”

Në Rregulloren e Brendshme në pikën (12.2) të nenit 12 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoli i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

-Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 për hartimin e PBA 2021-2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me nr.94 datë 30.03.2022

-Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS),për të cilin kane përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM ka kryer detyrat si:

-Janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Devoll në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësive të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Devoll. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjuesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”

Në Bashkinë Devoll është krijuar një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut nr.93 date 30.03.2022. Është hartuar regjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për të gjitha drejtoritë janë evidentuar risqet dhe janë përcaktuar veprime për të të adresuar mangësitë.

Në raportet e Auditit të Brendshëm trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

-Në Rregulloren e brendshme janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

Bashkia Devoll në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

-Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj)

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës dhe Buxhetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Specialisti i Financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë(NA). Struktura e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit përbëhet nga 8punonjës, 1 drejtor, 2përgjegjës Sektori.

-Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

-Në Rregulloren e Brendshme “Specialisti i Arshivës,” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë.

-Për menaxhimin e aktiveve është hartuar manuali i proceseve për menaxhimin e aktiveve në detyrat e drejtorisë Ekonomike, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

-Faqja Zyrtare e bashkisë Devoll në internet ka një sistem backup.

-Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup)apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

-Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet 62-72 të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Financiare për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merret Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative . Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive në rregulloren së Brendshme.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listëpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga Auditi i jashtëm (KLSH) *nuk* jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtuesit në Bashkinë Devoll kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Ministrisë së Financave/. Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit Sekretarit të Përgjithshëm.

-Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe MFE. Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 është në vlerën 115,580 mije leke. Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

-Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Devoll për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel pa e dubluar programin SIFQ. Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Drejtoria e Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit Devoll për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Ujësjiellësi, DRT, AKSH etj. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15:

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershme sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Në faqen e Bashkisë Devoll janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura, planet strategjike, raportet periodike, struktura organike, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Devoll nuk kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

-Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia, monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

-Për **vitin 2022** me shkresën nr.670 prot., datë 23.02.2023, janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Devoll dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”. Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësinë e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.

4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhet realizuar nëpërmjet: Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Realizimi të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësisë, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

-Në Bashkinë Devoll mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Ekziston plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit date 28.02.2023.

-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime si nga KLSH ashtu dhe nga Njësia e Auditit të brendshëm.

-Në Bashkinë Devoll aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Një nga drejtimitet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm për të gjitha subjektet e audituara duke e trajtuar atë si pikë të veçantë .

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

-Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe

Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

“Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

****Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016***

Titulli i gjetjes: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të

brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

“Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme rregulla të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, të marrë masa e nevojshme, që grupi i GMS të kryejë detyrat përkatëse, duke vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar si dhe të ndjekë realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Në zbatim të pikës 1.2, të Programit të Auditimit nr.868/1, datë 10.10.2023 me objekt “Mbikëqyrja e veprimtarisë së Njësive të Auditit të Brendshëm (këtu e vijim NJAB)”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura e NJAB sipas përcaktimeve në VKM nr.83, datë 03.02.2016 “Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Planet e punës së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë.
- Programet e auditimeve të miratuara, dërguar subjektit që auditohet, njoftimin.
- Dokumentet e Evadimit të materialeve të Auditit të brendshëm.
- Dokumentet e Sigurimit të cilësisë në auditimet e kryera.
- Vendimi i Këshillit të Bashkisë për miratimin e numrit të punonjësve të NJAB.
- Lista emërore dhe evidenca nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbi emërimin e punonjësve, statusin e punonjësve.
- Rregullorja e funksionimit të brendshëm të Bashkisë Devoll.

-Organizimi dhe funksionimi i strukturës së sektorit të Auditit të brendshëm:

Auditimi i Brendshëm, në Bashkinë Devoll e ka filluar funksionimin e saj në vitin 2016, me emërtesën “Sektori i Auditimit të Brendshëm”(sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë me nr.18, datë 29.02.2016), e cila edhe për vitin 2022 funksionon në nivel sektori sipas VKB nr.93, datë 26.12.2021 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve në institucionin e bashkisë dhe Institucioneve të varësisë për vitin 2022”, Urdhrin e Kryetarit me nr.1 datë 05.01.2022 “Për Miratimin e Strukturës të Administratës të Bashkisë Devoll për vitin 2022”, është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe përbëhet nga :

-1(një) përgjegjës dhe 2(dy) specialistë në plan dhe në fakt përbëhet nga 2 (dy) specialistë, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja “c”, si dhe nenit 64, shkronja “a” të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja “a”, “Për miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”

-Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësive të auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Devoll, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2022, është organizuar me 3(tre) punonjës, në nivel sektori me strukturë 1(një) përgjegjës sektori dhe 2(dy) auditues plan .

Në fakt kjo njësi gjatë vitit 2022, kishte në përbërjen e saj 2(dy) punonjës, përkatësisht 2(dy) specialiste auditimi, ku profili arsimor i gjithë stafit të kësaj njësie auditimi, rezulton që të jenë i diplomuar në fushën e ekonomisë, ku i gjithë stafi është i çertifikuar, me përvojë pune në fushën e auditimit dhe mbi 3 vjet dhe përvojë profesionale në fushën ku janë diplomuar, duke filluar nga 15-28 vjet. Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.1: Punonjësit e Drejtorisë të AB-së.

Nr	Periodha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2022						
1	E. Sh.	Specialit	Ekonomist	15	5.5vjet	Ne vitin 2013	Po
2	A. K.	Specialist	Ekonomiste	28	3.1vjet	Ne vitin 2013	Po

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm.

Në strukturën e AB, u konstatua që nuk ka përgjegjës sektori.

➤ **Dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron aktivitetin Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.**

Grupi i auditimit shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, ku konstaton se dokumentacioni baze mbi të cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë: Planet e punës së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë, për vitin 2022.

-Për vitin 2022 auditime të planifikuara 6 (gjashtë) dhe të realizuara 6 (gjashtë), sipas programeve mujore të auditimeve të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. 1.Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Shërbimeve me një Ndalesë (ONE STOP SHOP), miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.777/1, datë 01.03.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.777prot, datë 01.03.2022. 2.Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Kujdesit Social dhe PAK, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.1527/1, datë 28.04.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.1527prot, datë 28.04.2022. 3.Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Projekteve dhe Integritetit në Be dhe Diasporës, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2003/1, datë 06.06.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr. 2003prot, datë 06.06.2022. 4.Programi i Angazhimit të Auditimit për Çerdhën e Fëmijëve, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2280/1, datë 28.06.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.2280 prot, datë 28.06.2022. 5.Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Kadastrës (Sektori i Zhvillimit të Tokës, Mbrojtjes së Mjedisit), miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2996/1, datë 08.09.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr.2996 prot, datë 08.09.2022, 6.Programi i Angazhimit të Auditimit për Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr. 3543/1, datë 24.10.2022 dhe njoftimi për fillimin e auditimit me nr. 3543 prot, datë 24.10.2022.

Për vitin 2022 nga angazhimet e auditimit të kryera janë lënë 18 rekomandime nga të cilat 15 rekomandime të zbatuara dhe 3 rekomandime në proces zbatimi. Rekomandimet e lëna janë pranuar nga subjekti i audituar i cili ka hartuar **Plan-Veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar.**

Nga vlerësimi i kryer mbi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, konstaton se dokumentacioni baze mbi të cilën ushtron veprimtarinë NjAB, është si me poshtë:

1.Karta e Auditimit të Brendshëm ne Njësië se Auditimit Bashkia Devoll, miratuar me Urdhërin nr.531, datë 30.12.2022, protokolluar me nr. 449 Prot, datë 30.12.2022, dërguar Drejtorisë se Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.449/1 prot, datë 30.12.2022.

2. Plani strategjik si dhe plani vjetor, për vitin 2022, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të seksionit 3, kreu II të MABP, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm (kap. III), pika 3.5 “*Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të*

auditimit të brendshëm”, Planet strategjike dhe vjetore të punës së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë, për vitin 2022 me shkresën me nr 3030/1Prot, datë 15.10.2021, ndryshuar plani miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën me nr.159/2, datë 10.02.2022, për arsye të auditimit nga KLSH-ja, sipas programit me nr.50/1Prot, datë 18.01.2022 të disa Drejtorive e Sektorëve të cilat ishin programuar të auditoheshin në planin vjetor 2022 nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

Shkresat për dërgimin e planeve/dhe evidencave tek Njësia Qendrore Për Harmonizimin e AB, në Ministrinë e Financave?

Planet strategjike dhe vjetore të punës së Auditit të Brendshëm të miratuara nga Titullari i Bashkisë Devoll, për vitin 2022 dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm Tiranë me shkresën me nr. 3030/2Prot, datë 15.10.2021. Ndryshimi i planit të punës dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm Tiranë me shkresën me nr. 159/3/2Prot, datë 10.02.2022, bashkëlidhur dhe pasqyrat shoqërues, të cilat janë miratuar me shkresën nr.1915 prot, datë 13.10.2020, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1916 prot, datë 13.10.2020, i cili është rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 1867 prot, datë 19.10.2022, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 1868 prot, datë 19.10.2022.

Planet vjetore të auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kriteret e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planet vjetore të auditimit janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë, ku drejtimit kryesorë të auditimit kanë qënë:

- Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, si nga audituesit e brendshëm po kështu dhe nga auditimet e realizuara nga audituesit e jashtëm (KLSH) është kryer në çdo angazhim auditimi.

- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në përputhje me legjislacionin, për arritjen e objektivave dhe përmirësimin e performancës së njësive qeverisjes vendore-Verifikimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm, Verifikimi i riskut të subjektit,

- Verifikimi i pajtueshmërisë së veprimtarisë së drejtimit me politikat, rregullat dhe legjislacionin, Informacioni dhe komunikimi ,monitorimi. –Vlerësimi i strukturës është kryer në çdo angazhim auditimi .

- Vlerësimi i veprimtarisë së entitetit mbi menaxhimin efektiv të menaxhimit të taksave dhe tarifave vendore, menaxhimi i aseteve toka, pyje, kullota, menaxhimi i shërbimeve publike.

- Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura.

- Vlerësimi i rregullshmërisë ligjore baze dhe mbështetëse si dhe rregullorja që drejton veprimtarinë e subjektit.

Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, referuar kërkesave të nenit 14, pika ‘ç’ të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësonin e vetëvlerësimit** për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtoria e

Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 292/2prot, datë 09.02.2023 për vitin 2022.

Është bërë edhe dërgimi i informacionit mbi raportimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm në Bashkinë Devoll për vitin 2022 në Këshillin Bashkiak sipas shkresës me nr.675Prot,datë 24.02.2023. Informacion mbi kontrollin e auditimit të kryera nga specialistët e auditit të brendshëm për periudhën Janar-Gusht 2022, me shkresën nr.2872prot,datë26.08.2022. Informacion mbi monitorimin ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditit i brendshëm për vitin 2022, Këshillit Bashkiak Bashkia Devoll, me shkresën nr.1304prot,datë27.04.2023 . Raportime të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditit të brendshëm, periudha Janar-Gusht 2022,Zv/Kryetareve të Bashkisë Devoll me shkresën me nr.2941prot,datë02.09.2022.

-Veprimtaria e AB për periudhën 2022, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB, e cila paraqitet si me poshtë:

1.Auditim në Sektorin e Sherbimeve me një Ndalesë (ONE STOP SHOP) 1 Auditim Performancë.
-Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektorin e Sherbimeve me një Ndalesë (ONE STOP SHOP) me nr.777Prot,datë 01.03.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Sherbimeve me një Ndalesë (ONE STOP SHOP) , miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.777/1,datë01.03.2022.

2.Auditim në Sektorin e Kujdesit Social dhe PAK,Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave 1 Auditim Përputhshmëri.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektorin e Kujdesit Social dhe PAK,Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave me nr.1527,datë28.04.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Kujdesit Social dhe PAK,Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe Pagesave, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.1527/1,datë28.04.2022.

3.Auditim në Sektorin e Projekteve dhe Integritetit në Be dhe Diasporës 1 Auditim Përputhshmëri.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektorin e Projekteve dhe Integritetit në Be dhe Diasporës me nr.2003Prot,datë 06.06.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Projekteve dhe Integritetit në Be dhe Diasporës, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2003/1,datë 06.06.2022.

4.Auditim në Çerdhja e Fëmijëve 1 Auditim Performancë.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Çerdhja e Fëmijëve me nr.2280Prot,datë 28.06.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Çerdhjen e Fëmijëve,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2280/1,datë 28.06.2022.

5.Auditim në Sektorin e Kadastrës (Sektorin e Zhvillimit të Tokës,Mbrojtjes së Mjedisit) 1 Auditim Përputhshmëri.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Sektorin e Kadastrës(Sektorin e Zhvillimit të Tokës,Mbrojtjes së Mjedisit) me nr.2996 Prot,datë 08.09.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Sektorin e Kadastrës (Sektorin e Zhvillimit të Tokës,Mbrojtjes së Mjedisit),miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.2996/1,datë 08.09.2022.

6.Auditim në Drejtoria të Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, për auditimin e analizës së situatës për detyrimevet e prapambetura(Situatës së Borxhit) në Bashkinë Devoll 1 Auditim Përputhshmëri.

-Njoftimi për fillimin e auditimit në Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit, për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura me nr.3543 Prot,datë 24.10.2022.

-Programi i Angazhimit të Auditimit për Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit,për auditimin e analizës së situatës për detyrimet e prapambetura,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Devoll me nr.3543/1,datë 24.10.2022.

1.Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në **Bashkinë Devoll**, per auditimet e realizuara deri ne fund te vitit 2022, pas dërgimit të shkresës me nr.1136prot,datë03.03.2022 për dërgim informacioni pranë sektorit të Auditit të Brendshëm, eshte konstatuar se:

Pas përfundimit të auditimeve të realizuara të realizuar për veprimtarinë e periudhës 2022, janë lënë gjithsejt 18 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 18 rekomandime, kjo e pasqyruar në planin e veprimit të hartuar dhe miratuar nga subjekti i audituar nga të cilat 15 rekomandime të pranura e zbatuara dhe 3 rekomandime në proces zbatimi .

- **Rekomandime të karakterit organizative**, janë dhënë dhe pranuar 3 rekomandime.

- **Rekomandime të karakterit për arkëtim**, janë dhënë dhe pranuar 1 rekomandim.

- **Rekomandime të karakterit të tjera**, janë dhënë dhe pranuar 14 rekomandime.

Është dërguar informacion në ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Tiranë me shkresën me nr. 1097/1 prot, datë 03.04.2023 “Dërgohet raporti vjetor i monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditit të brendshëm së bashku me pasqyrat përkatëse.

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm.**

Nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm Bashkia Devoll, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “*Planifikimi i një angazhimi*”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjate kryerjes së angazhimit nga NJAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimin për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.6 “*Përgatitja e programit të angazhimit...*”, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm: Zbatimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri tjetrin.

➤ Verifikimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm.

➤ Verifikimi i riskut të subjektit.

➤ Verifikimi i pajtueshmërisë së veprimtarisë së drejtimit me politikën, rregullat dhe legjislacionin.

➤ Informacioni dhe komunikimi

➤ Monitorimi

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrin MF nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmblodhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimit dhe grupin e punës.

2.Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.

Nga NjAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II te MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*” të Manualit të Auditimit të Brendshëm , miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, e konkretisht:

- *Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit.*
- *Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit.*
- *Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit.*
- *Programi i angazhimit të auditimit.*
- *Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit.*
- *Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi.*
- *Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit.*
- *Projekt Raporti i auditimit.*
- *Raporti Përfundimtar i auditimit.*
- *Memo (përmbledhja e shkurtër përfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit te Institucionit.*
- *Monitorimi i brendshëm te aktivitetit te auditimit te brendshëm nga çdo auditues.*
- *Kontrolli i vlerësimit te cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim.*

3.Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese.

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i punës konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

4.Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese.

Nga njësia e AB të bashkisë, është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente te auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave te Manualit te Auditimit te Brendshem, kapit. VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente te auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor te Republikës së

Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuara sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim.

Mbi rezultatet e auditimit për vitin 2022, të dhënat janë dhe në pasqyrat shoqëruese bashkëlidhur materialit.

Konkluzion: Në strukturën e auditit të brendshëm nuk ka përgjegjës sektori që të mbulojë pozicionin e tillë, për periudhën në objekt auditimi viti 2022.

Titulli i gjetjes nr. 1 Mungesa e përgjegjësit të NjAB, Bashkia Devoll, pozicion vakant.

Situata:	Nga auditimi i auditit të brendshëm është konstatuar se gjatë vitit 2022, kishte në përbërjen e saj 2(dy) punonjës, përkatësisht 2(dy) specialiste auditimi. Në strukturën e auditit të brendshëm nuk ka përgjegjës sektori që të mbulojë pozicionin e tillë, për periudhën në objekt auditimi viti 2022.
Kriteri:	Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e përgjegjësit të NjAB, sjell mos ndarjen e duhur të detyrave dhe përgjegjësi gjatë auditimit për këtë njësi .
Shkaku:	Mos hapja e vendeve vakante nga intitucioni.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim	Kryetari i Bashkisë Devoll, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës së NJBA.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Devoll për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022, me ndryshime;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;

- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranim-faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren dhe evidencat e korespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2022. Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2022;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 93, datë 20/12/202, “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Devoll për vitin 2022”, ku përfshihet edhe struktura e drejtorisë së të ardhurave, lejeve dhe licensave, e cila përbëhet nga 11 Punonjes me përbërje 1 Drejtor, 2 përgjegjës sektori, 3 specialistë dhe 6 Inspektorë.

Struktura e Drejtorisë të Ardhurave Lokale për vitin 2022 është paraqitur në Pasqyrën 1 në anekset e projekt raportit.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Titulli i gjetjes: Nuk është kryer një planifikim i saktë i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore ku t’i referohet kërkesave reale të institucionit.

Situata:Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Devoll parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Devoll për vitin 2022 paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Në **Pasqyrën 2** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Nr	Emërtimi i taksave dhe tarifave	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
	<u>Të ardhura tatimore</u>			
1	Taksë Ndërtese	14,150,000.00	13,220,699.00	93.43
2	Taksë Trualli	3,000,000.00	2,751,055.00	91.70
3	Taksë Toke	24,000,000.00	12,884,191.00	53.68
4	Taksë Tabele	2,000,000.00	1,272,083.00	63.60
5	Taksë Tregu/zënie hapësirë publike	1,100,000.00	780,570.00	70.96
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë	10,000,000.00	13,274,544.57	132.75
7	Taksë Fjetje në Hotel	60,000.00	-	0.00
8	Tatim I Thjeshtuar	300,000.00	64,925.00	21.64
9	Regjistrimi i automjeti në përdorura	10,000,000.00	10,694,479.00	106.94
10	Taksë. Renta Minerale		25,948.00	
11	Të ardhura nga ASHK	150,000.00	501,495.00	334.33
12	Tatim mbi TAP	2,500,000.00	8,413,456.00	336.54
13	Taksë emergjencash	-	895,977.00	
14	Të ardhura të tjera	250,000.00	159,972.00	63.99
15	Leje për shitje me pakicë të karburanteve	1,000,000.00	600,000.00	60.00
	Shuma I	68,510,000.00	65,539,394.57	95.66

	Të ardhura jotatimore			
1	Tarifë Pastrimi	41,632,500.00	28,875,964.00	69.36
2	Tarifë Ndriçimi	18,641,600.00	13,388,905.00	71.82
3	Tarifë Gjelberimi	1,257,000.00	1,323,499.00	105.29
5	Tarifë Parkimi	870,000.00	835,400.00	96.02
6	Tarifa te ndryshme në Bashki	1,500,000.00	1,718,912.00	114.59
7	Të ardhura nga qeraja truall/objekti	2,390,596.00	2,085,556.00	87.24
8	Tarifë leje çertifikatë transporti	790,000.00	411,000.00	52.03
11	Tarifë uji për uitje	1,500,000.00	723,601.00	48.24
13	Tarifë sherbim varrimi	5,500,000.00	3,803,980.00	69.16
15	Tarifa Administrative/cerdhe	960,000.00	741,590.00	77.25
17	Leja Non Stop	200,000.00	105,000.00	52.50
18	Gjoha të ndryshme	2,400,000.00	124,134.00	5.17
20	Tarifë sherbim veteriner	150,000.00	-	-
22	Sponsorizime		13,235,101.90	
	Shuma II	77,791,696.00	67,372,642.90	86.61
III	Debi e parashikuar per mbledhje	38,143,140.00	13,540,529.00	35.50
	Totali	184,444,836.00	146,452,566.47	79.40

Burimi: Bashkia Devoll.

Për vitin 2022 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **184,444,836 lekë** dhe realizimi në vlerën **146,452,566.47 lekë** ose në masën **79.4%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **37,992,270 lekë**.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2022 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Devoll që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nën-pika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e

MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikimi i saktë i të ardhurave të pritshme nga taksat dhe tarifat vendore ndikon në hartimin e buxhetit të bashkisë, në angazhimet që parashikohen të ndërmerren gjatë vitit buxhetor. Për të ardhurat të cilat vijnë nga detyrimet prapambetura nga taksave dhe tarifave të cilat janë të paplanifikuara, shpërndahen sipas zërave por nuk ka një ndarje të ardhurave nga detyrimet e prapambetura dhe ato aktuale duke mos pasqyruar qartë se cili është burimi i tyre duke ndikuar në nivelin e realizimit të plan-faktit të të ardhurave vjetore të Bashkisë Pogradec.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Titulli i gjetjes: Mangësi të konstatuara në dokumentacionin mbi aktivitetin e Agjentëve Tatimorë.

Situata: Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të posaçëm nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”, ku përcaktohet se: “Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbajë, të llogarisë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shmanget mbledhjes së tyre, detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së pambledhura apo të shmangu.”, UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, Formularët e akt-rakordimeve.

Në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 95, datë 31.03.2022, nuk është përfshirë personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve me agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt rakordimeve me ta. Vetëm për ndjekjen e arkëtimeve dhe rakordimeve me Agjentin Tatimor, Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Devoll është parashikuar si detyrë konkretisht në nenin 120, pika 17 “Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore” të rregullores së brendshme.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen

automatiksht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Devoll dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Devoll. Gjithashtu Bashkia Devoll duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të fillojë procedurat për gjatitjen e këtyre agentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agentët e mbajtjes së tatimit në burim, agentët e taksave dhe agentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave që vilen me agentët tatimorë është Ujësja e Kanalizimeve Sh.a Devoll. Sipas akt-rakordimeve të mbajtura midis Bashkisë dhe Ujësja SH.A Bilisht janë mbajtur çdo muaj por në akt-rakordime kemi vetëm shumën e paguara sipas llojit të taksave dhe jo numrin e familjeve të cilët kanë paguar.

-Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.

-Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, nuk mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Të ardhurat e vjela nga agentët tatimorë për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

Në **Pasqyrën 3** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agentët tatimorë për vitin 2022.

Nr.	Emërtimi	Plani 2022	Realizimi 2022
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT Korçë)	300,000	64,925
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Korçë)	2,500,000	8,413,456
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	10,000,000	10,694,479
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	150,000	501,495
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana)		25,948
Totali		12,950,000	19,700,303

Burimi: Bashkia Devoll

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”.

Ndikimi/Efekti: Mos njohja e situatës çon në mungesë të ardhurash për Bashkisë Devoll.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Devoll dhe Agjentëve Tatimorë si dhe mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura nga agentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agjentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifën apo taksat të cilat mbledhen nga Agjentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me insitucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Titulli i gjetjes: Nuk është hartuar regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë.

Situata: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Devoll kryhet në programin Excel. Drejtoria nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullohet nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Devoll i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV për të cilat mund të ketë gabim në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Referuar të dhënave të marra nga DTV Bashkia Devoll, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Aneksi nr. 6. “Regjistri i biznesit Bashkia Devoll”

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2022	346	14	25	335
2	Biznesi Madh	2022	129	6	5	130
(1+2)	Gjithsej	2022	455	20	30	465

Burimi: Bashkia Devoll

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7.

Ndikimi/Efekti: Mos krijimi i regjistrit regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë krijojnë risk të lartë për dëmtimin apo humbjen e të dhënave.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Titulli i gjetjes: Nga Bashkia Devoll nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi) dhe për abonentët privatë dhe familjarë.

Situata: Referuar të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave për abonentët familjarë dhe abonentët privatë paraqiten si më poshtë:

Detyrimet e familjarëve:

Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensimit nuk ka hartuar regjistrin e familjarëve sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7,

ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj Në rregjistrim e mbajtur nga Bashkia Devoll gjendet si informacion vetëm lista emerore e personave të cilët duhet të ngarkohen me bazën e taksave. Rregjistrim fizik i mbajtur nga Bashkia Devoll nuk është i plotësuar sipas abonentëve për detyrimet e tyre sipas paketës fiskale dhe pagësat e kryera prej tyre.

Duke mos patur informacioni e saktë nga regjistri kjo do të sjelli edhe parashikim të gabuar për mbledhjen e taksave.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Devoll me VKB nr.90 datë 20.12.2021 ka përcaktuar si si agjent tatimor Ujësjeles Sh.A Bilisht për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për çdo familje dhe arkëtimin e gjobave deri në vlerën 50,000 lekë. Ndërmjet Bashkisë Devoll dhe Ujësjeles Sh.A Bilisht nuk është lidhur kontratë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për çdo familje dhe arkëtimin e gjobave deri në vlerën 50,000 lekë.

Këshilli Bashkiak Devoll është organi vendimarrës i cili mund vetëm të vendosi me shumicë votash për zgjedhjen e agjentit tatimor por kontrata e bashkëpunimit është dokumenti i cili e formalizon këtë vendim të Këshillit Bashkiak.

Për vitin 2022 agjenti tatimor Ujësjeles Sh.A Bilisht ka vepruar si agjent duke mos patur një kontratë.

Për vitin 2022 UKD ka të lidhur 8,531 kontrata me abonentë familjarë për të cilët është kryer dhe ngarkesa e taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale 2022 dhe sipas VKB nr.90 datë 20.12.2021.

Për analizimin e debitorëve të Bashkisë Devoll do të marrim në konsideratë vetëm numrin e abonentëve familjarë të cilët kanë të lidhur kontratë me UKD për abonentë familjarë të cilët nuk kanë një kontratë me UKD nuk kemi informacion për numrin e tyre dhe pagesat që kanë kryer për vitin 2022.

Nga analizimi i paketës fiskale 2022 për Bashkinë Devoll janë përcaktuar taksat dhe tarifat vendore si mëposhtë:

1) Taksë Ndërtesë: 17.5 lek/ m²

2) Taksë Trualli : 0.28 lek/ m²

3) Taksë Pastrimi: 2,400 lek/vit për familje

4) Taksë Ndriçimi: 1,800 lek/vit për familje (Bilisht) dhe 1,500 lek/vit për familje Njësitë Administrative.

5) Taksë Gjelbërimi 360 lek/vit për familje (Bilisht)

6) Mirëmbajtje Vareza 360 lek/vit për familje

7) Taksa e tokës është e ndarë në 7 kategori.

Taksat e mësipërme ngarkohen në bazë mujore nga UKD tek abonentët familjarë. Sipas aktrakordimeve mujore me UKD vlera totale për vitin 2022 e paguar nga abonentët familjarë është 59,134,388 lekë.

Nga taksat dhe tarifat vendore të përcaktuara në paketë fiskale dhe nga informacioni i përcjellë nga UKD për numrin e abonentëve familjarë kemi kryer analizën e mëposhtme për detyrimet e papaguara nga abonentët për vitin 2022.

Kjo analizë është kryer me rezerva për shkak:

1) Për sipërfaqët e ndërtesave Bashkia Devoll nuk ka informacion, edhe në paketën fiskale është parashikuar për abonentët të cilët nuk kemi informacion për sipërfaqën e ndërtesës taksa do të llogaritet për 100 m² ndërtesë. Kjo metodë taksimi mund të sjelli të ardhura të munguara për Bashkinë Devoll.

2)Për sipërfaqen e truallit Bashkia Devoll nuk ka informacion, edhe në paketën fiskale është parashikuar për abonentët të cilët nuk kemi informacion për sipërfaqën e truallit taksa do të llogaritet për 300 m² truall. Kjo metodë taksimi mund të sjelli të ardhura të munguara për Bashkinë Devoll.

3)Nga Bashkia Devoll nuk na është paraqitur informacioni për familjet e përjashtuara nga taksat dhe tarifat vendore konform legjislacionit.

4)Informacioni për taksën e tokës nuk është i plotë përshkak sepsë nuk është kryer ndarje e sipërfaqeve të tokës sipas kategorive të përcaktuar në paketën fiskale 2022.

Në **Pasqyrën 4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2022 si vijon:

Nr.	Për abonentët familjarë	Viti 2022		Vlera e parashikuar për tu mbledhur sipas paketës fiskale	Vlera e mbledhur për vitin 2022 sipas rakordimit me UKD	Vlera debitore 2022 abonente familjarë
		Nr. Familje që kanë kontratë me UKD	Vlera e taksa sipas paketës fiskale 2022			
1	Taksa e tokës bujqësore	8125		24,000,000	59,134,388	21,081,338
2	Taksa pastrimi	8531	2,400 lek/vit	20,474,400		
3	Taksë ndërtese (objekt banimi)	8531	17.5 lek m ² / vit	14,929,250		
4	Takse truall	8531	0.28 lek m ² / vit	716,604		
5	Taksë gjelbërimi Bilisht	2501	360 lek/vit	900,360		
6	Taksë ndriçimi	8531	1,800 lek/ vit Bilisht 1,500 lek/ vit Njesitë e tjera	14,076,150		
5	Mirëmbajtje vareza	8531	600 lek/ vit	5,118,600	59,134,388	21,081,338
	Total			80,215,364		

Burimi: Bashkia Devoll

➤ Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese.

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore për vitet e mëparshme nuk kemi informacion nga ana e Bashkisë Devoll dhe nuk mund të dalim më vlerë detyrimesh për abonentë familjarë. Për vitin 2022 nga analiza e mësipërme kemi analizuar me rezerva vlerën debitorë në shumën **21,081,338 lekë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Devoll**, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familiar deri në datën 31.12.2022. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Taksa e tokës:

Bashkia Devoll për vitin 2022 ka parashikuar të mbledhi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 24,000,000 lekë. Nga informacioni që na është përcjellës nga Drejtoria e të Ardhurave, Licencave dhe Lejeve kemi informacion për sipërfaqen totale që ju është ndarë 8,125 familjeve konkretisht 12,835.83 ha. Realizimi i kësaj takse për vitin 2022 është në vlerën 12,884,191 lekë ose 53% e totalit të parashikimit. Nga auditimi i taksës bujqësore nuk mund të shprehimi për saktësinë e parashikimit të kësaj takse sepse nuk kemi informacion për kategorizimin e tokës së ndarë dhe për të përcaktuar barrën tatimore për çdo familje që ka përfituar tokë bujqësore.

Informacioni për ndarjen e tokës është paraqitur në Pasqyrën nr. 5 në anekset e projekt raportit të auditimit.

Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **13,478,432 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll. Gjendja e debitorëve të krijuar për vitin 2022 është në vlerën 5,670,601 lekë. Vlera prej 7,807,831 lekë i përket viteve të mëparshme.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet në pasqyrën nr.7 si vijon:

Nr.	Loji i bizneseve	DETYRIMET	
		Viti 2022	
		Nr.sub	Vlera
1	Biznes i vogël	227	8,312,347
2	Biznes i madh	32	4,464,085
3	Institucione	5	702,000
	Shuma	264	13,478,432

Burimi: Bashkia Devoll

Sa më sipër dalim në konkluzionin se nga strukturat tatimore të bashkisë Devoll, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”. Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2022 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetorë i të ardhurave të Bashkisë Devoll.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 34,559,770 lekë**, e cila përbëhet nga:

-21,081,338 lekë detyrime nga **abonentët familjarë**;

-8,312,347 lekë detyrime nga **biznesi i madh**;

-4,464,085 lekë detyrime nga **biznesi i vogël**;

-702,000 lekë detyrime nga **institucionet**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli i gjetjes: Situata debitorë nga mos mbledhja e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 1,635,662 lekë për 44 persona, kanë paguar detyrimet 40 persona me vlerë 1,498,217 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej 4 persona me vlerë **137,445 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.

Pasqyra nr. 8. “Taksa e infrastrukturës për vitin 2022”

Taksa e ndikimit në infrastrukturë				
	Persona	Vlera e detyrimit	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 3.12.2021	63	4,080,752	1,904,296	2,176,456
2022	44	1,635,662	1,498,217	137,445
Total	103	5,716,414	3,402,513	2,313,901

Burimi: Bashkia Devoll

Pasqyra nr.8 (debitorët e vitit 2022) dhe **Pasqyra nr.9** (debitorët e viteve të mëparshme) janë paraqitur në anekset e raportit të auditimit.

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Devoll për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Devoll të jetë drejtuar ASHK Dega Korçë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore.

Kriteri: Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Devoll në vlerën **2,313,901** lekë.

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve midis Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Devoll dhe ASHK Rajonale Korçë, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **2,313,901 lekë** ndaj **33** personave.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t’i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Korçë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga veprimtaritë e ndryshme dhe përdorimi i aseteve të Bashkisë Devoll.**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

Situata: Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konstatohet se, Bashkia Devoll nuk ka lidhur kontrata të reja por ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillesatare. Në total për 6 njësitë administrative janë aktive 13 kontrata për vitin 2022.

Për vitin 2022 janë 13 kontrata aktive sipas **pasqyrës nr.10** të paraqitur në anekset e projekt raportit të auditimit.

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja për 5 subjekte me vlerë **21,376,000 lekë**.

Pasqyra nr.11 debitorë për kontratat e qirasë është paraqitur në anekset e projekt raportit të auditimit.

Kriteri: Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i nryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll në vlerën **21,776,000lekë**.

Shkaku: Mos likuidimi i detyrimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratat e dhënies me qira të tokave bujqësore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **21,376,000 lekë**, respektivisht:

-vlera **650,000 lekë** nga shoqëria “V.” sha;

-vlera **300,000 lekë** nga shoqëria ‘I.02’ SHPK;

-vlera **705,020 lekë** nga shoqëria ‘A.AL’ SHPK;

-vlera **2,482,980 lekë** nga shoqëria “M.H.Q.” SHPK;

-vlera **17,238,800 lekë** nga shoqëria “K.” SHPK.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli i gjetjes: Mungesë të ardhurash, nga mos arkëtimi i detyrimeve nga licencat/autorizimet të subjekteve që tregtojnë karburante.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së liçensës dhe lejinin e subjekteve të ushtrojnë aktivitetet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Devoll dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 9 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Në territorin e Bashkisë Devoll janë të rregjistruara 9 biznese në aktivitetet në tregtimin me pakicë të hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga 9 subjekte janë pajisur me autorizim 9 subjekte, nga të cilët 6 subjekte kanë paguar vlerën e plotë të liçensës dhe për këto subjekte është lëshuar liçensë më afat 5 vjeçar, për 3 subjekte të cilat nuk kanë paguar vlerën e plotë të detyrimit në **vlerën 1,200,000 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Devoll**. Për subjektet që nuk kanë kryer pagesën e plotë është lidhur akt-marrëveshje pagese. Lidhja e këtyre aktmarrëveshjeve është në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrëveshje është për detyrimet e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15.

Ndikimi/Efekt: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën 1,200,000 lekë nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjesë të tarifës së liçensës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar liçencën e tregtimit.

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,200,000 lekë** nga 3 subjektet, *respektivisht*;

- **vlera 200,000 lekë** nga subjekti “R.H.” SHPK;

- **vlera 400,000 lekë** nga subjekti “M.” SHPK;

- **vlera 600,000 lekë** nga subjekti “I.O.” SHPK

Lista e subjekteve të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre:

Nr	Subjekti	Nipt	Afati I autorizimit		Detyrimi per autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	A.P.sh.p.k 2.		06.12.2018	05.12.2023	1,000,000	1,000,000	0
2	E.		12.01.2021	11.01.2026	1,000,000	1,000,000	0
3	K.SH.P.K		26.02.2020	25.02.2025	1,000,000	1,000,000	0
4	O.SHPK (B.O.)		17.06.2020	16.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
5	G.Petrol		23.06.2020	22.06.2025	1,000,000	1,000,000	0
6	G.GKG		03.11.2020	02.11.2025	1,000,000	1,000,000	0
7	R.H.				1,000,000	800,000	200,000
8	M. SHPK				1,000,000	600,000	400,000
9	I. 2021				1,000,000	400,000	600,000
	Total				9,000,000	7,800,000	1,200,000

Burimi: Bashkia Devoll

➤ **Të ardhurat nga asetet e fondit pyjor kullor:**

Titulli i gjetjes: Mos lidhje e kontratave të qirasë ndërmjet Bashkisë Devoll dhe subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare.

Situata: Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore, kullorore dhe improduktive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Devoll për të cilat nuk janë lidhur kontrata qiraje referuar dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave. Në territorin e Bashkisë Devoll ushtrojnë aktivitet 5 subjekte të pajisura me leje minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje për sipërfaqet pyjore dhe kullorore, por që i shfrytëzojnë këto pasuri për qëllime biznesi nga subjektet private.

Këto subjekte janë:

1. Subjekti “K.” SHPK me Nipt J.....B, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1071/1, datë 10.09.2007, për shfrytëzimin e vendburimit Progër Devoll për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe me sipërfaqen 0.064 km² ose 6.4 ha. Sipërfaqja e cila nuk është hequr nga fondi pyjor/kulloror është 3 ha (**3 ha * 62,000 lekë = 186,000 lekë**).

2. Subjekti “Th.” SHPK me Nipt K.....Q, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1832, datë 17.03.2017, për shfrytëzimin e vendburimit Progër Devoll për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe gëlqeror dekorativ dhe me sipërfaqen 0.7287 km² ose 72.8 ha (**72.8 ha * 62,000 lekë = 4,513,600 lekë**).

3. Subjekti “E.” SHPK me Nipt J.....Q, i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen nr. 1912, datë 08.06.2021, për shfrytëzimin e vendburimit Kapshticë Devoll për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ dhe me sipërfaqen 0.372 km² ose 37.2 ha (**37.2 ha * 62,000 lekë = 2,306,400 lekë**).

Referuar VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar, pika 2, lidhja nr. 2, pika nr. 6/1, pika nr. 9/5 dhe nr. 9/6, në përcaktohet që: “Pika 2. Për përdorim sipërfaqesh të fondit pyjor e kulloror publik, zbatohen tarifat dysHEME, që llogariten duke mbajtur parasysh përdorimin aktual të territorit dhe kohëzgjatjen e

veprimtarisë së parashikuar, sipas lidhjes 2 të shtojcës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij”.

Lidhja nr. 2, “Tarifat dysHEME për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullor publik për ushtrimin e veprimtarive”.

Pika 6. Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë) Nr. Përdorimi i territorit Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës **lekë/ha/vit.**

1 vit 2-5 vjet 6-10 vjet

1 Inproduktive 540 000 / 495 000 / **440 000”.**

6 Improduktive -1-5 vjet 7,800 lekë dhe 6-10 62,000 lekë.

Detyrimi total për 5 subjekte për të cilat nuk është lidhur kontratë për marrjen me qira për shfrytëzimin e fondit pyjor kullor për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, është në vlerën **7,006,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll.** Përllogaritja e detyrimit është kryer duke marrë vlerën minimale.

Kriteri: VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar, pika 2, lidhja nr. 2, pika nr. 6/1, pika nr. 9/5 dhe nr. 9/6.

Ndikimi/Efekti: Bashkia Devoll nuk ka kontroll mbi veprimtarinë ekonomike që zhvillohet nga subjektet private që përdorin sipërfaqe të fondit pyjor/kullor pronë e saj.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Bashkia Devoll, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 517 ha, duke aplikuar tarifat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (**7,006,000**, për 3 subjektet e mësipërme).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. **z. E.D.** me detyrë Kryetar i Bashkisë Devoll.

2. **z. G.H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave.

3. **znj. D.R.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave.

4. **znj. V.B.** me detyrë specialiste Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave.

5. **z. I.D.** me detyrë Përgjegjës Sektori i Inspektoriatit Tatimor, Kundravajtjeve Administrative, Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi.

6. **z. G.M.** me detyrë specialist i Sektorit të Kontabilizimit të të Ardhurave

7. **z. S.S.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit.

8. **z. E.C.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga z.E.C. është paraqitur observacioni me nr. 257/1 prot., datë 24.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 868/5 prot., datë 26.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Subjekti “K.” është i pajisur me leje minerare nr.1071, datë 10.09.2007 për sipërfaqen prej 0.064 km² ose 6.4 ha prej të cilave 2.4 ha janë jashtë fondit pyjor/kullosor publik dhe 3.95 ha janë në fondin pyjor kullosor.

Nga kjo sipërfaqe prej 6.4 ha, 3 ha janë hequr në vitin 2000, me shkresën numër 460/1 datë 13.06.2000, ku Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti “B.K.” sh.p.k, ka miratuar heqjen nga fondi të sipërfaqes prej 3 ha.

Sipërfaqja e mbetur prej 0.95 ha, është miratuar për heqje me Urdhërin nr. 258, datë 19.07.2019, të Ministrit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit.

Grupi i Auditimit:

Në lidhje me dokumentacionin e mësipërm paraqitur nga sektori i menaxhimit të pyjeve, kullotave dhe mjedisit është paraqitur dokumentacioni për subjektin “K.” si mëposhtë:

1.Kërkesa e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.8048/1 datë 13.12.2018 për përgatitjen e raportit tekniko ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar nga subjekti “K.”.

2.Urdhër nr.258 datë 19.07.2019 i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga fondi pyjor dhe zvogëlimin në volum të sipërfaqes prej 0.95 ha në ekonominë pyjorë të Bashkisë Devoll që do të përdoret për kryerjen e aktivitetit minerar të shfrytëzimit të gurit gëlqeror në objektin Progër nga shoqëria “K.” shpk.

3.Shkresa nr.460/1 datë 13.06.2000 e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Devoll për heqjen e një sipërfaqe prej 3 ha nga fondi pyjor për subjektin “B.K.”

Sipërfaqja prej 3 ha i përket një subjekti tjetër jo subjektit “K.” shpk i cili është pajisur me leje minerare në datë 10.09.2007.

Observacioni i paraqitur merret në konsideratë pjesërisht duke reflektuar ndryshimet përkatëse përgjatë hartimit të Raportit të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti “A.N.”, është i pajisur me lejen minerare me numër 1660/1, datë 10.05.2016 për shfrytëzimin e vendburimit Bilisht Devoll, për llojin e mineralit hekur nikel për sipërfaqen 3,509 km² ose 350.9 ha.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti pranë Drejtorisë të Pyjeve dhe Mjedisit na rezulton se:

Subjekti është i pajisur me lejen minerare me numër 1660/1, datë 10.05.2016 për llojin metalor. Gjithashtu referuar lejes mjedisore e tipit B “për minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to”, nënkuptohet që subjekti nuk do të ushtrojë veprimtarinë e tij mbi tokë por nëntokë.

Për këtë arsye subjekti nuk ka bërë asnjë kërkesë për heqje nga fondi pyjor dhe kullosor sic është e parashikuar në Vendiin nr. 559, datë 29.07.2022 “për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor koinbëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” dhe ligji 57/2020 “Për pyjet”.

Subjekti ka pezulluar lejen e shfrytëzimit për nxjerrjen e materialit hekur-nikel për një periudhë kohe pa afat dhe gjatë kësaj periudhe kohe nuk ka ushtuar veprimtari në aktivitetin e tij minerar dhe nuk mund të lidhnim kontratë qiraje me subjektin A.N. për arsyet e mësipërme. Kjo vërtetohet dhe nga shkresa e Agjencisë Koinbëtare e Buriineve Natyrore (AKBN), e cila ka

miratuar për pezullim të aktivitetit ininerar sipas shkresës së MIE me nr. 4429/3 Prot, datë 21.07.2020.

Grupi i Auditimit:

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit merr në konsideratë rregjistrin e lejeve minerare aktive të publikuar në fazën zyrtare të ëeb të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, leja minerare e subjektit “A.N.” rezulton aktive gjithashtu dhe dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga drejtoritë/sectorët subjekt auditimi për subjektin e mësipërm nuk na është vendosur dokumentacion në dispozicion.

Dokumentacioni i mësipërm i paraqitur në dispozicion nuk disponon shkresë hyrëse në subjektin e audituar Bashkia Devoll.

Dokumentacioni i paraqitur në observacion është shkresa nr.4429/3 datë 21.07.2020 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila konfirmon kërkesën e shoqësisë “A.N.” për pezullimin e aktivitetit ininerar dhe shkresa nr.1917/1 datë 03.05.2023 nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore me lëndë “kthim përgjigje për miratim programi” në të cilën citohet se subjekti vazhdon ta ketë aktivitetin e pezulluar referuar shkresës së MIE nr.4429/3 datë 21.07.2020.

Observacioni i paraqitur merret në konsideratë duke reflektuar ndryshimet përkatëse përgjatë hartimit të Raportit të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti Th. sh.p.k. është pajisur me lejen minerare me numër 1832, datë 17.03.2017, për llojin e mineralit gur gëlqeror dhe dekorativ për sipërfaqen prej 0.7287 km² ose 72.8 ha.

Nga të dhënat që Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit disponon kemi që:

Subjekti Th. shpk. ka kërkuar heqjen nga fondi pyjor dhe kullor për sipërfaqen prej 9.79 ha për të cilën, Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit ka përgatitur raportin teknik ekonomik për dhënien në përdorim/heqjen e kësaj sipërfaqe nga fondi.

Gjithashtu do njoftohet AKBN në lidhje me plan projektin e miratuar për ndërhyrjet që ka propozuar shoqëria Th. sh.p.k për shfrytëzimin e lejës minerare.

Pas marrjes së përgjigjes nga AKBN për sipërfaqen në të cilën është planifikuar shfrytëzimi për periudhën kohore të parashikuar, do të njoftohet subjekti Th. që të lidhë kontratën e qirasë sipas miratimit të bërë referuar plan projektit për shfrytëzimin e llojit të mineralit gëlqeror dekorativ.

Grupi i Auditimit:

Në lidhje me observacionin për subjektin “Th.” sh.p.k është paraqitur dokumentacioni si mëposhtë:

1.Raport për studimin teknike-ekonomik për dhënien në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve në pronësi të Bashkisë Devoll i datës 15.06.2021 për subjektin “Th.” sh.p.k me sipërfaqe 7.29 ha.

2. Raport për studimin teknike-ekonomik për dhënien në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve në pronësi të Bashkisë Devoll i datës 07.02.2023 për subjektin “Th.” sh.p.k me sipërfaqe 2.5 ha.

Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit është dokumenti zyrtar që vërteton heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor/kullor

Subjekti “Th.” sh.p.k. është pajisur me lejen minerare me numër 1832, datë 17.03.2017 dhe raportet teknike janë kryer në vitin 2021 dhe 2023 të cilat duhet të hartohen në momentin e marrjes së lejes minerare.

Observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti “E.M.” sh.p.k është i pajisur me lejen nr. 1857, datë 31.05.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Kapshticë Devoll për llojin e mineralit hekur nikel në sipërfaqen 0.497 km² ose 49.7 ha.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti E.M. pranë Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit rezulton se:

Subjekti E.M. është i pajisur me leje minerare shfrytëzimi për mineralin nikel silikat por e ka pezulluar lejen përkohësisht për një periudhë 2 vjecare, me shkresën me numër 15482/1, datë 28.12.2018 nga Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe Industrisë. Gjithashtu me shkresën numër 2004/1 prot, datë 05.06.2023 të dërguar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e cila ka miratuar kërkesën për pezullim të aktivitetit minerar sipas shkresës së MIE me Nr. 4448/3 Prot, datë 21.07.2020 për një periudhë kohe pa afat.

Subjekti nuk ka bërë kërkesë për heqje të sipërfaqes pyjore dhe kullosore për shkak se e ka ndërprerë aktivitetin e tij minerar. Ndodhur përballë këtyre fakteve, Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit nuk mund të lidhë kontratë qiraje me subjektin E.M. për një aktivitet i cili është pezulluar dhe gjatë gjithë kësaj kohe nuk është punuar.

Grupi i Auditimit:

Grupi i auditimit gjatë fazës së terrenit merr në konsideratë rregjistrin e lejeve minerare aktive të publikuar në fazën zyrtare të ëeb të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, leja minerare e subjektit “E.M.” shpk rezulton aktive gjithashtu dhe dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga drejtoritë/sectorët subjekt auditimi për subjektin e mësipërm nuk na është vendosur dokumentacion në dispozicion.

Dokumentacioni i mësipërm i paraqitur në dispozicion nuk disponon shkresë hyrëse në subjektin e audituar Bashkia Devoll.

Dokumentacioni i paraqitur në observacion është shkresa nr.15482/1 datë 28.12.2018 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila konfirmon kërkesën e shoqësisë “E.M.” për pezullimin e aktivitetit minerar me afat 2 vjeçar dhe shkresa nr.2004/1 datë 05.06.2023 nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me lëndë “kthim përgjigje për miratim programi” në të cilën citohet se subjekti vazhdon ta ketë aktivitetin e pezulluar referuar shkresës së MIE nr.4448/3 datë 21.07.2020.

Observacioni i paraqitur merret në konsideratë duke reflektuar ndryshimet përkatëse përgjatë hartimit të Raportit të Auditimit.

Pretendimet e subjektit:

Subjekti “E.” sh.p.k është i pajisur me lejen minerare me numër 1912 datë 08.06.2021 për shfrytëzimin e vendburimit Kapshticë Devoll për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ në sipërfaqen prej 0.372 km² ose 37.2 ha.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka kërkuar që të përgatitet raporti teknik-ekonomik për heqjen e sipërfaqes prej 36 ha, e cila është pjesë e fondit pyjor dhe kullosor publik dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit, pas marrjes së kërkesës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor ka përgatitur raporti teknik-ekonomik për sipërfaqen prej 36 ha.

Gjithashtu do njoftohet AKBN në lidhje me plan projektin e miratuar për ndërhyrjet që ka propozuar shoqëria E. sh.p.k për shfrytëzimin e lejës minerale. Pas marrjes së përgjigjes nga AKBN për sipërfaqen në të cilën është planifikuar shfrytëzimi për periudhën kohore të parashikuar, do të njoftohet subjekti E. që të lidhë kontratën e qirasë sipas miratimit të bërë referuar plan projektit për shfrytëzimin e llojit të mineralitgëlqeror dekorativ.

Grupi i Auditimit:

Në lidhje me observacionin për subjektin “Th.” sh.p.k është paraqitur dokumentacioni si mëposhtë:

1. Raport për studimin teknike-ekonomik për dhënien në përdorim/heqje nga fondi pyjor dhe kullësor të sipërfaqeve në pronësi të Bashkisë Devoll i datës 25.05.2023 për subjektin “E.” sh.p.k me sipërfaqe 36 ha.

Urdhri i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit është dokumenti zyrtar që vërteton heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor/kullësor

Subjekti “E.” sh.p.k. është pajisur me lejen minerare me numër 1912, datë 08.06.2021 dhe raportet teknike janë kryer në vitin 2023 të i cili duhet të hartohen në momentin e marrjes së lejes minerare.

Observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga z.G.M. është paraqitur observacioni me nr. 257/1 prot., datë 24.01.2024, i administruar në KLSH me nr. 868/5 prot., datë 26.01.2024 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me “Planifikimit të të ardhurave” është bazuar në parashikimet e secilit sektor përkatës janë kryer analiza të posacme në lidhje me realizimin ose jo të të ardhurave dhe në lidhje me ndarjen konkrete nga arketimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit. Ju kemi vene në dispozicion evidencat e mbajtura midis thesarit dhe drejtorise sone ku specifikohet qartë te ardhurat e mbledhura gjate vitit 2022 per cdo zë dhe detyrimet e prapambetura në zërin debi.

Në lidhje me taksën për lejen e tregëtimit të karburanteve lidhja e akt marrëveshjeve midis bashkisë dhe këtyre subjekteve është kryer duke qënë se janë në mungesë likujditeti dhe bashkisë nuk i intereson Bashkisë që këto subjekteve të mbyllen e cila do të sjelli mungesë të ardhurash dhe mbyllje vendeve të punës.

Në lidhje me të ardhurat e aseteve nga fondi pyjor për të cilën ngarkoni si përgjegjës Drejtorinë e të Ardhurave ju informojmë se sektori juridik dhe sektori i pyjeve janë sektorët që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejtë në hartimin e kontratave të qerave.

Grupi i Auditimit:

Në lidhje me observacioni e mësipërm pikat e mësipërme janë trajtuar në projekt raportin e auditimit dhe nuk ka argumenta ose dokumentacion shtese.

Observacioni i paraqitur nuk merret në konsideratë në hartimin e raportit të auditimit.

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2022.

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa

ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2022 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- ☐ Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- ☐ Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- ☐ Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- ☐ Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- ☐ Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- ☐ Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- ☐ Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- ☐ Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- ☐ Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Devoll për vitin 2022, janë të nënshkruara nga z. E.D. Kryetar i Bashkisë Devoll në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. M.H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues të cilat janë depoztuar pranë Degës së Thesarit Devoll me shkresën nr. 554/1 prot., datë 14.02.2023, brenda afatit ligjor të cilat janë konfirmuar me nr. 70 prot., datë 14.02.2023.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t’u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t’u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të raportimit financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Devoll për aktivitetin ekonomiko-financiare për periudhën **01.01.2022**, deri më datën **31.12.2022**.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shitesat, pakësimet apo nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilët kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjet dhe fletë-daljet etj.,.

1. Titulli i gjetjes: Asgjesim i aktiveve të cilat konsiderohen të dëmshme me ndikim në mjedis pa procedurë përkatëse.

Situata: Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Devoll për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Devoll dhe Njësive Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras ka nxjerrë Urdhrin nr. 408, datë 31.10.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit, të vlerësimit dhe asgjesimit të aktiveve me përbërje si më poshtë:

- a. Komisioni i inventarizimit përbëhet nga znj. I.S. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. A.A., znj. H.A., znj. S.Z. dhe z. O.F..
- b. Komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga z. J.N. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. M.H., znj. O.F..
- c. Komisioni i asgjesimit të aktiveve përbëhet nga z. A.C. kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A.K., znj. E.B..

Me Urdhrin nr. 408/1, datë 01.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë ka pësuar një ndryshim komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. E.M. kryetar komisioni dhe anëtarët z. A.A., znj. H.A., znj. S.Z., z. O.F., znj. I.S., znj. M.A.

Me shkresën nr. 353 prot., datë 27.01.2023, komisioni i inventarizimit ka mbajtur relacionin përfundimtar mbi realizimin e procesit të inventarizimit të Bashkisë dhe njësive administrative.

Me shkresën nr. 137/5 prot., datë 13.12.2022, shkresën nr. 137/6 prot., datë 16.12.2022, shkresën nr. 122 prot., datë 12.01.2023, shkresën nr. 186 prot., datë 16.01.2023, shkresën nr. 186/1 prot., datë 16.01.2023, dhe shkresën nr. 386 prot., datë 31.01.2023, nga komisioni i vlerësimit janë mbajtur relacionet përkatëse për Bashkinë dhe Njësitë Administrative mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit si më poshtë:

Lekë

Nr.	Llogaria	Proger	Miras	Hoçisht	Qendër	Bashkia + Administrata + Shkollat	Totali
1	327	353,235	129,449	12,430	26,039	2,194,141	2,715,294
2	218	102,550	152,290	506,744	800,667	2,025,950	3,588,201
3	214	0	232,398	16,800	20,400	1,758,965	2,028,563
Totali		455,785	514,137	535,974	847,106	5,979,056	8,332,058

Me shkresën nr. 419 prot., datë 02.02.2023, komisioni i asgjësimit ka mbajtur relacionin mbi përfundimin e procesit të asgjësimit të aktiveve në të cilën është kryer seleksionimi i materialeve metalike nga ato jo metalike për të ndjekur procedurën e shitjes për skrap me ankand. Sasia e hekurit e seleksionuar sipas bashkisë dhe njësive administrative paraqitet si më poshtë:

Kg

Bashkia dhe Njësia Administrative		Sasia
Njësia Administrative Miras		40
Njësia Administrative Proger		30
Njësia Administrative Hocisht		25
Njësia Administrative Qendër Bilisht		35
Administrata Bilisht		150
Shkollat Bilisht		30
Totali		310

Me shkresën nr. 419/2 prot., datë 03.02.2023, nga komisioni i agjesimit është mbajtur procesverbali mbi përcaktimin e vlerës së hekurit referuar ofertave të marra nga tre subjekte dhe të dhënave nga INSTAT ku për 310 kg hekur * 11 lekë/kg = 3,410 lekë.

Me shkresën nr. 419/1 prot., datë 02.02.2023, nga komisioni i asgjësimit është mbajtur relacioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit. Në këtë relacion citohet se: “Në datën 02.02.2023, përfundoi procesi i asgjësimit të materialeve jashtë përdorimit dhe u bë dorëzimi i dokumentave dhe materialeve me nr. 419 prot., datë 02.02.2023, Sektorit të Menaxhimit Financiar. Ky komision u ngrit me urdhër të Kryetarit nr. 352, datë 31.10.2022, i përbërë nga tre anëtarë. Pasi komisioni bëri verifikimin e aktiveve të përdorura për asgjësimin nga komisioni i vlerësimit ngritur me po të njëjtin urdhër dhe nga personat për asgjësimin nga komisioni i vlerësimit ngritur me po të njëjtin urdhër dhe nga personi përgjegjës u krye asgjësimi i të gjitha materialeve duke gruposur ose djegur materialeve sipas rasteve për çdo njësi administrative ndërsa materiale metalik është veçuar nga pjesët e tjera për t’u shitur për skrap”.

-Referuar relacionit të sipërcituar konstatohet se, nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transporti si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

-Në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga titullari i institucionit nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe gruposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet.

-Procesi i ankandit për shitjen e skrapit deri më datën 30.11.2023, që i përket fundit të periudhës së fazës së auditimit në terren ende nuk është realizuar.

Kriteri: Ligji nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” Kreu I pika 1 dhe pika 2, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 108 dhe pika 122.

Ndikimi/Efekti: Ndikimi negativ në përmirësimin e cilësisë së performancës mjedisore. Mos plotësim me dokumentacion të plotë të procesit të asgjësimit.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit si dhe të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.D. Kryetar i Bashkisë Devoll në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. M.H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar dhe znj. A.F. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe z. A.C., znj. A.K., znj. E.B. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për Asgjësimin e Aktiveve.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2022, të pozicionit financiar të Bashkisë Devoll, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Lekë

Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	2,745,597,188
Aktivet	2,947,072,669
Pasivet	201,475,481
Aktivet Neto	2,745,597,188

Lekë

Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën	258,701,190
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	79,935,202
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	52,505,196
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	126,260,792

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0

520	Disponibilitete në thesar	79,935,202	135,072,931	(55,137,729)
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizgjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		79,935,202	135,072,931	(55,137,729)

2. Titulli i gjetjes: Parregullsi në kuadrin e llogarive kontabile.

Situata: Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 135,072,931 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 79,935,202 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 79,935,202 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 20,627,875 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 20,627,875 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar”.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
31	Materiale	9,070,032	9,967,730	(897,698)
32	Inventar i imët	43,435,164	43,730,888	(295,724)
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizgjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		52,505,196	53,698,618	(1,193,422)

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 52,505,196 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 9,070,032 lekë dhe llogaria 32 “Inventar i imët” 43,435,164 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 1,193,422 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 1,193,422 lekë.

-Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 9,070,032 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	9,967,730
Shtesa (K)	54,098,105
Pakësime (D)	54,995,803
Gjendja në 31.12.2022	9,070,032

-Llogaria 32 “Inventarë i imët”, ka vlerën 43,435,164 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	43,730,888
Shtesa (K)	2,424,455
Pakësime (D)	2,720,179
Gjendja në 31.12.2022	43,435,164

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshim i 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	859,832	859,832	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	66,670,236	66,571,862	98,374
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	58,560,724	69,880,411	(11,319,687)
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
	Totali	126,090,792	137,312,105	(11,221,313)
	Të tjera aktive afatshkurtra			

409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	170,000	450,000	(280,000)
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
Totali		170,000	450,000	(280,000)

3. Titulli i gjetjes: Mos kontabilizimi në bilanc i debitorëve për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Devoll.

Situata: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 66,571,862 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 66,670,236 lekë me një rritje në vlerën 98,374 lekë.

Lekë

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2022	66,571,862
Shtesa (K)	1,059,574
Pakësime (D)	961,200
Gjendja debitoare në 31.12.2022	66,670,236

Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 51,642,272 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitoare. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit.

Kriteri: Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

Ndikimi/Efekti: Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kunërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t'u marrë”.

-Llogaria 477 “Diferenca konvertimi aktive”, ka vlerën 170,000 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2022	450,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	280,000
Gjendja në 31.12.2022	170,000

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë. Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 0 lekë kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Seksioni 3.1. Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2022	31.12.2021	Diferenca/Ndryshimi 2022-2021
	II. Aktive Afatgjata	2,688,371,479	2,400,330,302	288,041,177
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	56,389,661	25,720,022	30,669,639
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	56,389,661	25,720,022	30,669,639
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	2,477,582,804	2,133,867,220	343,715,584
210	Toka, Troje, Terene	3,228,553	3,228,553	0
211	Pyje, Plantacione	2,070,933	2,070,933	0
212	Ndërtesa e konstruksione	530,130,804	525,532,284	4,598,520
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,852,219,355	1,541,970,510	310,248,845
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	7,882,505	11,748,314	(3,865,809)
215	Mjete transporti	71,021,035	35,870,206	35,150,829
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	11,029,619	13,446,419	(2,416,800)
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	154,399,014	240,743,060	(86,344,046)
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	8,095,000	8,095,000	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	146,304,014	232,648,060	(86,344,046)

1. Aktivët Afatgjatë Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 25,720,022 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 31,955,640 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 7,959,314 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 56,389,661 lekë.

Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	32,393,336
	2	Amortizim i akumuluar	6,673,313
	3	Gjendja në 01.01.2022	25,720,022
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	31,955,640
	5	Amortizim i shtesës	1,286,001
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	64,348,976
	5	Amortizim i akumuluar	7,959,314
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	56,389,661

4. Titulli i gjetjes: Mos sistemimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” duke paraqitur në këtë llogari në mënyrë jo të drejtë edhe vlerën e projekteve prej 1,562,000 lekë, investimet e të cilave kanë përfunduar.

Situata: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë.

Kriteri: VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5.

Ndikimi/Efekti: Aktiv i bilancit për llogarinë 202 “Studime dhe projekte” nuk pasqyron vlerën e saktë të kësaj llogarie, për rrjedhojë ulje e vlerës reale të investimeve të përfunduara dhe rritje artificialisht e vlerës së projekteve, deformim të dhënash për këto dy llogari.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 1,562,000 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 3,228,553 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,228,553 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,228,553
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2022	3,228,553
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,228,553
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	3,228,553

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 2,070,933 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,070,933 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,070,933
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	Gjendja në 01.01.2022	2,070,933
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	2,070,933
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	2,070,933

-Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” më datë 01.01.2022, ka qenë në vlerën 525,532,284 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 30,875,134 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 179,257,641 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 530,130,804 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i	1	Kosto historike	678,513,311
	2	Amortizim i akumuluar	152,981,027
	3	Gjendja në 01.01.2022	525,532,284

veprimeve	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	30,875,134
	5	Amortizim i shtesës	26,276,614
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	709,388,445
	5	Amortizim i akumuluar	179,257,641
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	530,130,804

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 1,541,970,510 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 387,347,370 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 552,405,265 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,852,219,355 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,017,277,250
	2	Amortizim i akumuluar	475,306,740
	3	Gjendja në 01.01.2022	1,541,970,510
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	387,347,370
	5	Amortizim i shtesës	77,098,525
	6	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	2,404,624,620
	5	Amortizim i akumuluar	552,405,265
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	1,852,219,355

5. Titulli i gjetjes: Përfshirja në llogarinë 212 “Ndërtesa e konstruksione” vlera 94,936,727 lekë dhe llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” vlera 572,125,235 lekë e paanlizuar në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

Situata: 1. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 768,513,311 lekë kosto historike është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

2. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,017,277,250 lekë kosto historike është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Miras, Qendër dhe Hoçisht e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

Shkaku: Mos zbatimi i rregullave kontabël.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 11,748,314 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 106,704, pakësim në vlerën 2,028,563 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 11,889,325 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,882,505 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	<u>1</u>	Kosto historike	21,693,689
	<u>2</u>	Amortizim i akumuluar	9,945,375
	<u>3</u>	Gjendja në 01.01.2022	11,748,314
	<u>4</u>	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	106,704
	<u>5</u>	Amortizim i shtesës	1,943,950
	<u>6</u>	Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	2,028,563
	<u>7</u>	Amortizim nga pakësimet	0
	<u>4</u>	Kosto historike	19,771,830
	<u>5</u>	Amortizim i akumuluar	11,889,325
	<u>6</u>	Gjendja më datë 31.12.2022	7,882,505

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 35,870,207 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 36,944,338 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 28,760,048 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 71,021,035 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	62,836,745
	2	Amortizim i akumuluar	26,966,538
	3	Gjendja në 01.01.2022	35,870,207
	4	Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	36,944,338
	5	Amortizim i shtesës	1,793,510
	6	Pakësime gjatë vitit	0

		2022 (K)	
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	99,781,083
	5	Amortizim i akumuluar	28,760,048
	6	Gjendja më datë 31.12.2022	71,021,035

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 13,446,419 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,242,246 lekë, pakësim në vlerën 3,495,278 lekë dhe amortizim i akumuluar në vlerën 62,628,369 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 11,029,619 lekë.

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	<u>1</u>	<u>Kosto historike</u>	<u>73,911,020</u>
	<u>2</u>	<u>Amortizim i akumuluar</u>	<u>60,464,602</u>
	<u>3</u>	<u>Gjendja në 01.01.2022</u>	<u>13,446,419</u>
	<u>4</u>	<u>Shtesa gjatë vitit 2022 (D)</u>	<u>3,242,246</u>
	<u>5</u>	<u>Amortizim i shtesës</u>	<u>2,163,768</u>
	<u>6</u>	<u>Pakësime gjatë vitit 2022 (K)</u>	<u>3,495,278</u>
	<u>7</u>	<u>Amortizim nga pakësimet</u>	<u>0</u>
	<u>4</u>	<u>Kosto historike</u>	<u>73,657,988</u>
	<u>5</u>	<u>Amortizim i akumuluar</u>	<u>62,628,369</u>
	<u>6</u>	<u>Gjendja më datë 31.12.2022</u>	<u>11,029,619</u>

Auditim mbi administrimin e aseteve, procedurave të inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

6. Titulli i gjetjes: Mos dokumentim i plotë në bilanc i aktiveve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Situata: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Devoll ka në pronësi në total **3,036 pasuri** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

➤ **Njësia Administrative Miras:**

-Me VKM nr. 762, datë 28.05.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore në Komunën Miras, të Qarkut të Korçës”, janë transferuar gjithsej **936 pasuri** nga të cilat **janë pajisur me certifikatë pronësie 3 pasuri**.

-Me VKM nr. 15, datë 13.01.2022, “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Devoll, të Njesisë Administrative Miras, të pasurine nr. 408/1 dhe nr. 408/2, me vendodhje në Zonën Kadastrale nr. 3129 (Qytezë)” **janë pajisur me certifikatë pronësie 2 pasuri**. Referuar kësaj VKM-je një prej pasurive konkretisht pasuria me nr. 474/5 ZK nr. 2232, “Shkolla Cikli i Ulët Koshnicë” **është e rënuar**.

➤ **Njësia Administrative Bilisht:**

-Me VKM nr. 764, datë 07.11.2012, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bilisht,

të Qarkut të Korçës”, janë transferuar gjithsej **386 pasuri** nga të cilat janë **pajisur me certifikatë pronësie 18 pasuri**.

-Nga pronat e transferuara me VKM nr. 36, datë 27.01.2021, “Për disa ndryshime në VKM nr. 764, datë 07.11.2012, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publie, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bilisht të Qarkut të Korçës”, janë pajisur me certifikatë pronësie **2 pasuri**.

-Nga pronat e transferuara me VKM nr. 1006, datë 10.12.2010, “Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme prone private që preken nga ndërtimi i rrugës “Qemal Stafa” në Bashkinë Bilisht”, është pajisur me certifikatë pronësie **1 pasuri**.

-Nga pronat e transferuara me VKM nr. 263, datë 25.03.2015, “Për shpronësim për interes publik, të pronave të pasurive të paluajtshme prone private që preken nga rristurime i ujësjetllësit të qytetit dhe çelja e rrugëve “Naim Frashëri”, “Andon Bullaci”, “Novruz Gjoza” dhe “Iliria” të Bashkisë Bilisht”, janë pajisur me certifikatë pronësie **8 pasuri**. Gjithashtu me Akt Dorëzimit nr. 109, datë 10.06.2016, Drejtoria Rajonale Korçë, janë pajisur me certifikatë pronësie **2 pasuri**.

➤ **Njësia Administrative Hoçisht:**

-Me VKM nr. 17, datë 09.01.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Hoçisht, të Qarkut të Korçës”, janë transferuar gjithsej **568 pasuri** nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie **3 pasuri**.

Pasuria me nr. 626/1, ZK nr. 1254, me emërtimin “Ish-Kopështi Borsh” është zënë forcërisht.

Pasuria me nr. 1096/1, ZK nr. 1260, me emërtimin “Muzeu Bradvice” e zaptuar.

➤ **Njësia Administrative Proger:**

-Me VKM nr. 24, datë 14.01.2009, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Proger, të Qarkut të Korçës”, janë transferuar gjithsej **453 pasuri** nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie **11 pasuri**.

➤ **Njësia Administrative Qendër Bilisht:**

-Me VKM nr. 202, datë 13.03.2013, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të Komunës Qendër Bilisht të Qarkut të Korçës”, janë transferuar gjithsej **639 pasuri** nga të cilat janë pajisur me certifikatë pronësie **7 pasuri**.

-Nga pronat e transferuara me VKM nr. 268, datë 16.05.2018, “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Devoll, të Njesisë Administrative Qendër Bilisht, të disa pronave me venddodhje në Zonën Kadastrale nr. 3637 (tre) dhe Zonën Kadastrale nr. 1202 (Bitinke)”, janë pajisur me certifikatë pronësie **7 pasuri**.

-Nga pronat e transferuara me VKM nr. 139, datë 24.02.2016, “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Devoll, të Njesisë Administrative Qendër Bilisht, të pronës nr. 783, ZK nr. 1202, dhe për një shtesë në VKM nr. 1056, datë 16.07.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Qendër Bilisht, të Qarkut të Korçës”, janë pajisur me certifikatë pronësie **2 pasuri**. Gjithashtu me kontratë shitje janë pajisur me certifikatë pronësie **4 pasuri**.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Devoll dhe Njësive Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim

me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37.

b. Në total në pronësi të Bashkisë Devoll janë 3,036 pasuri të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura nga të cilat **vetëm për 64 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie.**

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Devoll **nga 345 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 10 prej tyre posedon titull pronësie.** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Në mënyrë të përmbledhur të dhënat paraqiten si më poshtë:

Llogaria	Sipas të dhënave në Pasqyrat financiare	Të pajisura me certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor
210 “Toka, troje, terrene”	10	6
211 “Pyje, kullota, plantacione”	13	0
212 “Ndërtesa e konstruksione”	136	3
213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”	186	1
Totali	345	10

Nga Bashkia Devoll nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

d. Gjithashtu në Njësinë Administrative Hoçisht konstatohet se 2 pasuri janë zaptuar apo zënë forcërisht pasuritë si më poshtë:

-Pasuria me nr. 626/1, ZK nr. 1254, me emërtimin “Ish-Kopështi Borsh” **është zënë forcërisht.**

-Pasuria me nr. 1096/1, ZK nr. 1260, me emërtimin “Muzeu Bradvice” **e zaptuar.**

Nga Bashkia Devoll nuk janë marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të kthyer pasuritë e sipërpërmendura në gjendjen e mëparëshme pra në përdorim si aset të bashkisë.

Kriteri: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c”.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrat financiare paraqesin informacion të gabuar për llogarinë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Shkaku: Mos krijim i regjistrimit të aktiveve për pronat e mësipërme. Mos marrja e masave për inventarizimin e pasurisë që paraqitet në llogarinë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” mos pasqyrimin e vlerave të tyre në aktivin e pasqyrave financiare. Mos marrja e masave për regjistrimin e pasurive të kësaj llogarie në ASHK.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

4. Invenstimet

-Llogaria 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 8,095,000 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 230 “Për aktivet afatgjata jo materiale”	
Gjendje në 01.01.2022	8,095,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2022	8,095,000

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 232,648,060 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 313,067,901 lekë dhe pakësim në vlerën 399,411,947 lekë ndërsa më datë 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 146,304,014 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”	
Gjendje në 01.01.2022	232,648,060
Shtesa (K)	313,067,901
Pakësime (D)	399,411,947
Gjendja në 31.12.2022	146,304,014

7. Titulli i gjetjes: Parregullsi në kuadrin e llogarive kontabile.

Situata: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 146,304,014 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, germa “c”.

Ndikimi/Efekti: Mos kuadrim i llogariv kontabile.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Devoll më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve,

detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

8. Titulli i gjetjes: Parregullsi në kuadrin e llogarive kontabile.

Situata: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,705,731 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,605,392 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 632,794 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 58,560,742 lekë.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	144,568,207	142,546,292	2,021,915
42	Detyrime ndaj personelit	15,536,499	13,934,315	1,602,184
16,17,18	Hua afat shkurtra	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	4,705,731	4,797,610	(91,879)
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	4,605,392	3,955,266	650,126
436	Sigurime shëndetësore	632,794	542,386	90,408
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	18,983,310	(18,983,310)
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisë ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	20,627,875	10,224,794	10,403,081
467	Kreditorë të ndryshëm	4,524,882	16,646,691	(12,121,809)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	6,104,101	6,104,101	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
Gjendje në fund të periudhës		201,305,481	217,734,765	(16,429,284)

9. Titulli i gjetjes: Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara. Marrja e angazhimeve për kryerjen e shpenzimeve përtej kufirit të fondeve buxhetore të disponuara realisht, në llogarinë e thesarit.

Situata: a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në datën 31.12.2022, është në vlerën 144,568,207 lekë paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Devoll. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	142,546,292
Shtesa (K)	185,549,440
Pakësime (D)	183,527,525
Gjendja debitoare në 31.12.2022	144,568,207

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 142,546,292 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 185,549,440 lekë dhe pakësim në vlerën 183,527,525 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 4,524,882 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,215,358 lekë dhe pakësim në vlerën 13,337,167 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,646,691 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2022	4,524,882
Shtesa (K)	1,215,358
Pakësime (D)	13,337,167
Gjendja kreditore në 31.12.2022	16,646,691

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, duke mbartur këto detyrime për periudhat e tjera kontabël të mëvonshme, denatyrin i buxhetit koherent dhe atij pasardhës.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndo shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 16,646,691 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlere 15,536,499 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2022 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2022	13,934,315
Shtesa (K)	190,070,386
Pakësime (D)	188,468,202
Gjendja debitore në 31.12.2022	15,536,499

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
8	10.01.2023	10,190,509
9	10.01.2023	3,300,517
10	10.01.2023	1,477,222
11	10.01.2023	285,259
12	10.01.2023	218,019
13	10.01.2023	37,950
14	10.01.2023	750
57	15.02.2023	26,273
Totali		15,536,499

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 4,705,731 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2022	4,797,610
Shtesa (K)	9,652,342
Pakësime (D)	9,744,221
Gjendja debitore në 31.12.2022	4,705,731

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
5	10.01.2023	742,637
7	10.01.2023	21,639
Totali		4,705,731

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2022 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 4,605,392 lekë dhe 632,794 lekë.

Lekë

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”	
Çelje e vitit 2022	3,955,266
Shtesa (K)	51,959,158
Pakësime (D)	51,309,032
Gjendja debitore në 31.12.2022	4,605,392
Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore	
Çelje e vitit 2022	542,386
Shtesa (K)	7,135,760
Pakësime (D)	7,045,352
Gjendja debitore në 31.12.2022	632,794

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2023 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	10.01.2023	1,735,185
2	10.01.2023	2,739,740
6	10.01.2023	45,586
7	10.01.2023	84,881
Totali		4,605,392
3	10.01.2023	310,510
4	10.01.2023	310,506
7	10.01.2023	11,778
Totali		632,794

10. Titulli i gjetjes: Mbi mangësitë e konstatuara në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në pasqyrat financiare.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 10,224,794 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Devoll.

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2022	20,627,875
Shtesa (K)	11,045,040
Pakësime (D)	641,959
Gjendja debitore në 31.12.2022	10,224,794

Lekë

Nr.	Emërtimi	Viti	Vlera
1	Përmirësimi i banesave	2021	1,023,182
2	G. D. Rruga Cangonj	2015	619,940
3	G. D. Rruga e Kuçit	2015	93,023
4	G. D. Ura Tip Baily	2018-2019	185,145
5	G. D. Kanali Bracanj-Trstenik	2017	386,627
Totali			2,307,917

Për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,307,917 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Devoll, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së

punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,228,104 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Kriteri: Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Pasqyrim jo i saktë i kësaj llogarie.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 6,104,101 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”	
Çelje e vitit 2022	6,104,101
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja debitore në 31.12.2022	6,104,101

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket:

Lekë

Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”	Gjendja 01.01.2022	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2022
Debitorë Njësia Administrative Proger	859,382	0	0	859,382
Debitorë Ish-Bashkia Bilisht	5,244,719	0	0	5,244,719
Totali	6,104,101	0	0	6,104,101

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

2. Të tjera pasive afatshkurtra

-Llogaria 478 “Diferenca konvertimi pasive” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 170,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse”	
Çelje e vitit 2022	450,000
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	280,000
Gjendja debitore në 31.12.2022	170,000

11. Titulli i gjetjes: Parregullsi në kontabilizimin e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”.

Situata: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 2,408,318,717 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlëra neto)” në vlerën 490,471,432 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,193,422 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 5,523,841 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 110,562,369 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlëra neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë.

Lekë

C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	2,745,597,188	2,508,679,191
D	FONDI I KONSOLIDUAR	2,745,597,188	2,508,679,191
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,663,122,577	2,408,318,717
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	79,935,202	97,821,065
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	2,539,409	2,539,409
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	2,947,072,669	2,726,863,956

Lekë

Fondi i konoliduar	Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar”			
2,745,597,188	Mbyllje më datë 31.12.2022		Çelje më datë 01.01.2022	
	Debi		Kredi	
	5,523,841	Pakësimet sipas pasqyrës nr. 7/b	490,471,432	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	110,562,369	Amortizimi sipas pasqyrës nr. 7/b	1,193,422	Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”
	116,086,210		2,899,983,571	
2,889,983,571 - 116,086,201 = 2,783,897,361				
2,745,597,188 – 2,663,122,577 = 120,774,784				

Kriteri: Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17.

Ndikimi/Efekti: Deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2022 të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar”.

Shkaku: Mos zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 62,886,684 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 76,423,044 lekë ose me një rritje në vlerën 13,536,360 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	76,423,044	62,886,684
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	64,925	382,375
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	64,925	382,375
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	16,679,310	16,598,272
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	15,635,246	14,651,368
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	501,495	113,916
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	542,569	1,832,988
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	59,662,009	45,906,036
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	11,294,479	10,758,037
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	48,367,530	35,147,999
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	16,800	0
709	7. Gjyba e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 46,591,753 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,960,017 lekë ose me rritje në vlerën 1,368,264 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	47,960,017	46,591,753
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,085,556	1,733,975
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	2,085,556	1,733,975
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	45,874,461	44,857,778
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	29,759,864	27,559,428
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	2,300,591	1,736,514
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	118,000	179,420
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestreime e zhdëmtime	13,696,006	15,382,416
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 889,235,230 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 895,253,472 lekë ose me një pakësim në vlerën 6,018,242 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
72	V. GRANTE KORENTE	895,253,472	889,235,230
720	1. Grant korent i brendshëm	895,253,472	889,235,230
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	733,231,149	794,955,514
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	395,000	996,574
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	8,439,404	7,628,865
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	139,952,817	69,880,411
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	13,235,102	15,773,866
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 186,077,052 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 207,597,349 lekë ose me një rritje në vlerën 21,520,297 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 30,245,016 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 34,464,586 lekë ose me një rritje në vlerën 4,219,570 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Devoll me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
6001	Paga, personel i përhershëm	206,656,379	182,276,270
602	Paga personel i përkohshëm	0	0
603	Shpërblime	940,970	3,800,782
609	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	30,956,555	27,166,674
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	3,508,031	3,078,342
Totali		242,061,935	216,322,068

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2021, ka qenë në vlerën 146,078,685 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 155,600,391 lekë ose me një rritje në vlerën 9,521,706 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Devoll me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	155,600,391	146,078,685
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	8,641,560	6,622,200
6021	Materiale dhe shërbime speciale	20,410,774	36,117,218
6022	Shërbime nga të tretë	87,863,966	71,882,315
6023	Shpenzime transporti	28,265,093	17,632,354
6024	Shpenzime udhëtimi	185,380	199,560
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	0	0
6026	Shpenzime për qiramarrje	475,806	403,161
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,225,452	6,928,542
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	8,532,360	6,293,335

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Devoll nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 295,952,052 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 263,189,312 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2022	31.12.2021
	V. TRANSFERIME KORENTE	308,686,393	295,952,052
604	1. Transferta korente të brendshme	25,077,691	32,762,740
6040	Transferime korente tek nivele tjera të Qeverisë	14,177,691	18,932,310
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	10,900,000	13,830,430
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizata ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	283,608,702	263,189,312
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	167,292	1,774,808
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	283,441,410	261,414,504

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 1,019,636,532 lekë dhe totali shpenzimeve është 939,701,330 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 79,935,202 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 79,935,202 lekë.

Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj.,. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

12. Titulli i gjetjes: Përfitimi i shërbimeve pa procedurë prokurimi.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në 6 raste janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfitur nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, prashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Analiza e detajuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i projektit	Urdhër Shpenzimi		Operatori Ekonomikë	Vlera
		Nr.	Datë		
1	Aktivitet për mbrëmjen e maturës	454	27.07.2022	Bordero (Ylli Baka)	178,500
2	Open cinema në Devoll	443	26.07.2022	Steljo Gace	300,000
3	Marrje stendash me qira	432	25.07.2022	Promo print	120,000
4	Shërbim dekorit festiv	447	26.07.2022	Promo print	110,000
5	Maratona kengë moj	673	20.10.2022	Shoqata Promotor	600,000
6	Takim dhe aktivitete në gjurmët e Driteroit	775	13.12.2022	Shoqata aktivizmi letrar dhe kulturor	470,000
Totali					1,778,500

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 100, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak. Nga Bashkia Devoll për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 6 subjekte është likuiduar shuma 1,778,500 lekë. **Vlera 1,778,500 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.**

Kriteri: Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligji nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8.

Ndikimi/Efekti: Shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vlerën 1,778,500 lekë.

Shkaku: Nuk janë respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Për vitin 2022, numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin nr. 1, datë 05.01.2022, të z. E.D. Kryetar i Bashkisë me objekt “Për miratimin e strukturës të administratës të Bashkisë Devoll për vitin 2022”, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Devoll për vitin 2022 me numër 380 punonjës. Me Vendimin nr. 93, datë 20.12.2021, të Këshillit Bashkiak është miratuar niveli i pagave për vitin 2022 sipas strukturës organizative.

13. Titulli i gjetjes: Mungesë e rregullave të përcaktuara qartë për rekrutimin e punonjësve të cilët rregullojnë marrëdhëniet e punës me anë të Kodit të Punës.

Situata: Nëpunësit e Bashkisë Devoll i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kapitullit III, “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, ku përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Kriteria dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t’i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
- Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;
- Një sistem stimulues për punonjësit për t’i nxitur të rrisin cilësinë e kryerjes së detyrave të caktuara;
- Një sistem për qarkullimin e punonjësve për të lejuar punonjësit të përftojnë një eksperiencë të gjerë në njësinë ku punojnë;
- Një sistem transparent sanksionesh, që të përcjellë një ide të qartë të qëndrimit të titullarit të njësisë ndaj shkeljes së rregullave të vendosura dhe një tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla;
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërbllimin dhe motivimin e stafit.

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar me Vendimin nr. 95, datë 31.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Kriteri: Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”.

Ndikimi/Efekti: Situatë jo transparente mbi procedurat e rekrutimit të punonjësve.

Shkaku: Mos implementim i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Planifikimi dhe realizimi i strukturës organizative paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2022	
	Plan	Fakt
Bashkia Devoll		
Totali	380	343

Burimi i të dhënave: Bashkia Devoll.

Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të Bashkisë Devoll konstatohet se në total struktura është e përbërë nga 79 punonjës të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Shërbim Civil dhe 290 punonjës me Kod Pune. Kjo situatë ka ndodhur për shkak se, vendet vakante të

cilat janë hapur për shërbimin civil nuk janë plotësuar si pasojë e mos aplikimit nga personat e interesuar. Në total realizimi i strukturës është në masën 90.2%.

Listë pagesat përfshijnë pagën e grupit (klasifikimin e diplomës së nivelit të dytë në master shkencor ose profesional sipas rastit), pagën për funksion (niveli i klasifikuar), raportet mjekësore të paguara nga punëmarrësi, shtesa vjetërsi (klasifikimi në vit, % dhe në vlerë), paga bruto, ndalesat (sipas rastit, pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore 9.5%, pagesat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore 1.7% tatimi mbi pagën). Listë prezencat janë hartuar sipas ditëve gjithsej të punës për çdo punonjës. Paga e aplikuar minimale dhe paga maksimale në përputhje me VKM nr. 158, datë 12.03.2022, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”. Për sa i përket shpërblimeve për orët jashtë orarit të punës janë aplikuar vetëm për punonjësit e MZSH-së (punonjës zjarrfikës), ndërsa për punonjësit e tjerë të institucionit nuk ka, për shkak se nuk janë shfrytëzuar orët jashtë orarit zyrtar, pasi punonjësit i përmbahen 40 orëve në javë, sipas orarit të shpallur në rregulloren e brendshme të institucionit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.D. Kryetar i Bashkisë Devoll në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, **znj. M.H.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar dhe **znj. A.F.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Buxhetit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues sipas periudhave respektive.

14. Titulli i gjetjes: Në gjashtë raste punonjësit me profesion elektrikistë, pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit të Agjencisë së Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative u konstatua se, janë punësuar gjashtë punonjës me profesion elektrikistë pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës
1	J. H.	Elektrikist
2	P. B.	Elektrikist
3	E.A.	Elektrikist
4	A. M.	Elektrikist
5	J.S.	Elektrikist
6	A.D.	Elektrikist

Kriteri: Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”.

Ndikimi/Efekti: Risk i mundshëm për ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së punonjësve.

Shkaku: Mos njohje e dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Agjencia e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektrikistë me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. A.R. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Për sa është trajtuar në Akt Konsatimin nr. 7, datë 30.11.2022, dhe në Projekt Raportin e Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Devoll është paraqitur observacioni me shkresë nr. 257/1 prot., datë 24.01.2024, administruar në KLSH praktikën nr. 868/5 datë 26.01.2024, nga

znj. A.F. Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Buxhetit, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit konstatohet se për 6 punonjës me profesion elektrikistë nuk janë pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknike, veprime keto në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Nga ana jonë ju sqarojmë se dosjet e personelit nuk administrohen nga Sektori i Planifikimit të Buxhetit por nga Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore kjo në bazë të “Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës” me numër protokolli 95, datë 31.03.2022, neni 143, pika 5, shprehet: Specilaisti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore zbaton masa të veçanta për ruajtjen dhe mirë administrimin e informacionit konfidencial dhe të dhënave personale të punonjësve.

-Gjithashtu Vendimi nr. 833, datë 28.10.2020, kreu II. Dosja e personelit:

1. Dosja e personelit është individuale dhe përmban të dhëna të karakterit të përgjithshëm, profesional, akademik, masa disiplinore, të dhëna për vlerësimin e rezultateve në punë, si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me këtë dosje janë:

a) i punësuar, të cilit i përket dosja;

b) eprori direkt;

c) nëpunësit e njësisë së burimeve njerëzore që përgjigjen për mbajtjen dhe sistemimin e tyre;

ç) titullari i institucionit;

d) sekretari i përgjithshëm;

dh) Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;

e) Departamenti i Administratës Publike; si dhe

ë) institucione të tjera të ngarkuara nga ligji.

3. Njësia e burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen, plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar.

4. Çdo i punësuar në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore është i detyruar t’u përgjigjet menjëherë kërkesave të njësisë së burimeve njerëzore për të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të këtij kreu, si dhe të njoftojë menjëherë për ndryshimin e tyre, duke paraqitur edhe dokumentin përkatës që vërteton këto ndryshime.

-Të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit

Në dosjen e të punësuarit duhet të përfshihen:

dh) certifikatat ose diplomat e kualifikimeve apo të specializimeve, të lidhura me pozicionin e punës

Siç shihet dhe nga vendimi burimet njerëzore janë përgjegjëse për plotësimin e dosjeve të personelit dhe administrimin e dosjeve të elektrikistëve me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, pasi edhe urdhrat e emërimit hartohen nga ky sektor. Shpresoj nga ana juaj të merren parasysh argumentat e mësipërme.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me pretendimet e ngritura nga znj. A.F. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Buxhetit ju bëjmë me dije se, se kjo është një problematikë që i përket Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe jo Sektorit të Planifikimit dhe Buxhetit. Për më tepër ky observacion është identik me observacionet e fazës së akt konstatimeve dhe nga grupi i auditimit **është marrë në konsideratë** ku janë kryer

reflektimet përkatëse që në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit duke u ngarkuar me përgjegjësi znj. A.R. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

2.4.4. Auditim mbi hartimin e zbatimit e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendimet përkatëse të KB.

Në zbatim të drejtimit 4, të programit të auditimit nr. 868/1 Prot, datë 10.10.2023, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë;

1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.

3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara dhe marrja në dorëzim sipas rastit.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Devoll, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Devoll, në disa rast nuk është bërë e mundur që urdhër prokurimet të konfirmohen në Degën e Thesarit, për të siguruar garancinë e fondeve dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratës, veprime në kundërshtim me udhëzimin plotësues nr. 02, datë 19.01.2018 të MF “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, i ndryshuar.

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Devoll (regjistrat e parashikimit dhe realizimit), për periudhën 01.01.2022–31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara të cilat paraqiten (bashkëlidhur Raportit Përfunrimtar të Auditimit në aneksin nr. 1 dhe aneksin nr. 2, pika 4, “Mbi realizimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”).

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021-31.12.2022, Bashkia Devoll ka realizuar 50 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit në shumën totale 251,164,346 lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën totale 232,942,857 lekë nga të cilat:

Për vitin 2022 janë realizuar 11 procedura prokurimi me fond limit në shumën 232,275,950 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën 217,387,238 lekë pa TVSH, ose 93,6% e fondit limit.

Për vitin 2022 janë realizuar 39 procedura blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 18,888,395 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën 15,555,619 lekë pa TVSH ose 82% e fondit limit.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Më poshtë trajtohen disa nga procedurat e prokurimit të audituara në Bashkia Devoll, e konkretisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt “*RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll*” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “ Procedure e Hapur - Pune ” REF-40312-08-31-2022 Urdhri nr. 2909/5 prot. datë 31.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 2909/1, datë 31.08.2022 1.E.A. 2.E.M. 3.G.K.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 2909/1, datë 31.08.2022 1.E.A. 2.E.M. 3.G.K.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2909/7 prot., datë 31.08.2022. 1.R.H. 2.X.P. 3.D.D.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 91,833,096 (nëntëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSh	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE: (A.I.C.SHPK & A.I.General C.ShPK) 91,001,674.05 (nëntëdhjetë e një milion e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër pikë zero pesë) lekë pa TVSh		6. Diferenca me fondin limit 831,422 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 21.09.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit dhe Buxheti i Bashkise Devoll		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 1 OE b) S’kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj.			
10.Ankimime AK-s’ka APP-ka; KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 30 prot, datë 17.10.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka,në datën 09.09.2022 u be modifikimi i DST sipas Rekomandimeve të APP

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “*RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll*”, me fond limit në shumën 91,833,096 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 91,001,674 lekë, kanë marrë pjesë 1OE, nga të cilët 1OE është kualifikuar dhe 0 OE/BOE janë s’kualifikuar, ku është shpallur fitues BOE: A.I.C.SHPK & A.I.General C.ShPK) ” me vlerë oferte në shumën: 91,001,674.05 (nëntëdhjetë e një milion e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër pikë zero pesë) lekë pa TVSh konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

Titulli i gjegjes: Nuk janë argumentuar specifikimet teknike, nuk dokumentohet dhe argumentohet fondi limit dhe përzgjedhja e procedurës.

Situata: Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin nr. 2909/1, datë 31.08.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.E.M. 3.G.K.. Sipas procesverbalit Nr. 2909/2 Prot. të datës 31.08.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit është bazuar tek vlera e preventivit dhe projektit të zbatimit të hartuar nga S. e projektimit në përputhje me Manualin e çmimeve sipas VKM 629 datë 15.7.2015 “Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të Tyre” e cila rezulton të jetë 91,833,096 lekë pa TVSh.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 2909/1, datë 31.08.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.E.A. Person Pergjegjës 2.E.M. Anëtar 3.G.K. Anëtar.

Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 2909/2, datë 31.08.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim. Nga sa më sipër rezulton se në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës nuk rezulton të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht specifikimet teknike të hartuara. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i punëve të cilat do të kryhen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur punë”, veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK Z. E.D., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. E.A., zj. E.M. e z. G.K..

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku citohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, nuk ka argumentim të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrit të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.E.A. 2.E.M. 3.G.K., janë evidentuar në procesverbalin Nr. 2909/6 Prot. të datës 31.08.2022, të cilat janë si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

- Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe

b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

1.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP – 1/A (Punime gërmimi ne toke.)
- NP – 2/C (Ndertime cvile dhe industriale)
- NP –3/B (RiK.dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasade)
- NP –11/A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarje e energjisë.)
- NP – 12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- NS – 1/A (Punime per prishjen e ndertimeve)
- NS –2/A (Impiant hidro-sanitar, guzhina, lavanteri, mirembajtje e tyre)
- NS –4/B (Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri, plastike, metalike, dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese)
- NS – 8/A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri)
- NS –12/A (Impiant teknologjik, termik dhe kondicionimit)
- NS –13/A (Impiant dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni)
- NS-14/A (Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj)
- NS -18/ A (Punime topogjeodezike)
- NS- 19/A (Sisteme kundra zhurmes per infrastrukture), sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Ky kriter për paraqitjen e licencave nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, mund të ndikojë në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar jo më pak se 120 (njëqind e njëzetë) për periudhën Dhjetor 2021-Korrik 2022 të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Dhjetor 2021 - Korrik 2022.

b)List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Dhjetor 2021 - Korrik 2022.

Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 42 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 120 punonjës me kohë të plotë për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si Drejtues teknik të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për (Dhjetor 2021 - Korrik 2022) stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2(dy) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Gjeodet
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Mekanik
- 1(një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Elektronik

a. Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022 te shoqeruar me kontrate pune, diplome dhe Libreze Pune, stafin mbështetës si më poshtë:

- 2 (dy) inxhinier ndertimi, profile gjeoteknik
- 1 (nje) inxhinier mekanik,
- 1 (nje) gjeodet
- **1 (nje) Arkitekt**
- 1(nje) inxhinier telekomunikacioni

Kërkesa për arkitekt në këtë procedurë nuk është e argumentuar ligjërisht dhe për më tepër nuk është në përputhje me zbatueshmërinë dhe objektin e kontratës pasi projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar dhe procedohet për OE i cili do të marrë përsipër realizimin e objektit dhe kontratës së zbatimit të punimeve. Kriter i cili konsiderohet kufizues.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, te shoqeruar me kontrate pune, diploma, stafin mbështetës si më poshtë:

- 1 (nje) Ekspert mjedisi te pajisur me Certifikate “Per Vlersimin e ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedisor.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për ekspert mjedisi në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë përkatëse për 1 (një) specialist ekspert zjarrefikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.
- 2 (dy) punonjes si "Përgjegjës për sigurimin dhe kontrollin e cilesise."

2.3.7.1 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të Administratorit të shoqërisë Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt do të jetë/jenë i/ të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, i cili/të cilët të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet dhe të jetë i pajisur me Diplomë, Kontratë pune, Librezë pune.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht për eksperiencën prej 5 vite të drejtuesit teknik.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Murator 3
- Hekurkthyes 1
- Saldator 2
- Hidraulik 2
- Karpentier 2
- Mekanik 1
- Elektracist 3
- Teknikë Ndërtimi 2

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave:

➤ Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 10 (dhjete) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 42 duke filluar nga Drejtues projekti me licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 120 punonjës me kohë të plotë për periudhën Dhjetor 2021 - Korrik 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- b) Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të energjisë ISO 50001/2011 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- c) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor ISO 14001-2015 (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- d) Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë OHSAS 18001-2007, (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
- Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.***

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Leje dhe Licenca të lëshuara nga QKL, si mëposhtë:

- Licencë Kodi III.2.B “Per Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve”.
- Licencë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL. Kodi 1.2.A.

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës kriter i cili ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së OE.

a) Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasi	Statusi
1	Eskavator	Copë	3	Në pronësi ose me qira
2	Fadrome	Copë	3	Në pronësi ose me qira
4	Mjet autovinç	Copë	3	Në pronësi ose me qira
5	Kamion vetëshkarkues kapacitet mbajtës jo me pak se 20 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 – 10 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Kamioncine vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1-5 ton	Copë	8	Në pronësi ose me qira
8	Autobot uji	Copë	3	Në pronësi ose me qira
9	Autobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qira
10	Autopomp betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qira
11	Elektrotraxhe	Copë	3	Në pronësi ose me qira
13	Skela metalike	M2	2500	Në pronësi ose me qira ose kontrate furnizmi
14	Pompa Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Vibruese betoni	Copë	3	Në pronësi ose me qira
16	Betoniere	Copë	2	Në pronësi ose me qira
17	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qira
18	Rul me vibrim	Cope	2	Në pronësi ose me qira

Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi/Distributori, Certifikata ISO Prodhuesi/Distributori, Katalog per:

- Bojerat
- Kamerat

- UPS
- Kaldaja
- Pompa
- Tubacione te ujit te pijshem

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues, sipas deklaratës së mësipërme, brenda afatit nga dërgimi i njoftimi për paraqitjen e tyre.

2.3.14 Operatori Ekonomik të ketë 1(nje) punonjës–Auditues Energjitik i Certifikuar me titull: “Auditues Energjitik ne Ndertesa dhe instalime industriale.

Per punonjes auditues energjitik duhet te kete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit), Certifikata per audituesin energjitik te leshuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar, kriter i cili ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së OE.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Devoll pas rekomandimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik pas monitorimit te Procedures me objekt: “RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll” me REF-40312-08-31-2022, me fond limit: 91.833.095.66 lekë pa TVSH. Ne datën 09.09.2022 janë bërë ndryshimet si më poshte:

Pika 1 tek Kriteret e vecanta te kualifikimit BEHET:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Ne Piken 2.3.10, të kapacitetit teknik,: “Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë,

CERTEFIKATA BEHET:

4.“ Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë **OHSAS (ISO 45001:2018)**, (ose ekuivalente) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)”.

Pika 2.3.9 BEHET:

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 10 (dhjete) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

Manovratorët mund të figurojnë në listpagesa ose mund të disponohen nga operatorët ekonomikë edhe nepermjet kontraktimit për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listpagesat e shoqërisë.

SHENIM: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-se, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin Nr. 2909/7 prot. të titullarit të AK, datë 31.08.2022, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar) 2.X.P. (Anëtar) 3.D.D. (Anëtar) Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2909/14 Prot, të datës 23.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/ S’kualifikuar
1	B.O.E. A. - I.G.C.ShPK & A.I.C.ShPK	91,001 674.05 (nëntëdhjetë e një milion e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër pikë zero pesë) lekë pa TVSh	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës **Nr. 2909/17 Prot më datë 12.10.2022**, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operator pjesëmarrës janë s’kualifikuar 0 OE, është kualifikuar 1 OE i cili plotëson kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 12.10.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë BOE “A.-I.G.C.& A.I.C.” për të cilën është lidhur kontrata datë 17.10.2022 për vlerën 91,001,674 lekë pa TVSh dhe 109,202,008.86 lekë me TVSh dhe me afat 6 (gjashtë) muaj nga fillimi i punimeve.

Titulli i gjetjes: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala” Bilisht Devoll”, me fond limit në shumën 91,833,096 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 91,001,674 lekë, u konstatua se: Me procesverbalin nr. 2909/6prot, datë 31.08.2022, nga Bashkia Devoll, Njësia e Prokurimit, janë miratuar kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Nga auditimi rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar kriteret e kualifikimit duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, eficientën dhe ekonomikitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për OE pjesëmarrës. Konkretisht është kërkuar arkitekt, ndërkohë që projekti është i përfunduar, kërkohet inxhier mjedisi ndërkohë që ky investim është Rindërtim i shkollës në të njëjtin vend që ka qënë objekt ekzistues, certifikata të cilat përveç se nuk janë të argumentuara nuk lidhen ngushtësisht me objektin dhe natyrën zbatuese të kontratës. Vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe

ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, liçencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore, audituesi i energjisë, arkitekti, etj. Këto kritere duhet të vendosen sipas natyrës dhe volumit të punimeve pasi referuar LPP vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.

Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E.D., zj. E.A., zj. E.M. dhe z. G.K. në cilësinë e anëtarëve të NjP.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, ku përcaktohet se;

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarje, trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

2. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant per nevoja te Bashkise Devoll Naftë dhe Benzine" me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburant per nevoja te Bashkise Devoll Naftë dhe Benzine"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit : E Hapur mbi kufirin e lartë monetar-Mallra (Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara) "REF-35059-06-30-2022 Urdhri Nr. 2318/5 prot., datë 30.06.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 2318/1 datë 30.06.2022 1.E.A. 2.M.M. 3.E.K.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 2318/1, datë 30.06.2022 1.E.A. 2.M.M. 3.E.K.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2318/2 prot. datë 30.06.2022. 1.R.H. 2.G.K. 3.V.Q.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 61,875,429 (gjashtedhjetë e një milion e teteqind e shtatedhjetë e pesë mijë e katerqind e njezet e nente) lekë ose 519 394 (peseqind e nentembdhjetë mijë e treqind e nentendhjetë e kater) Euro. i ndare si më poshtë: Loti nr.1 "Blerje Naftë" , me fond limit: 58,987,711 (pesedhjetë e tete milion e nentqind e tetedhjetë e shtate mijë e shtateqind e njembdhjetë) lekë pa TVSh. Loti nr.2 "Blerje Benzine" , me fond limit 2,887,718 (dy milion e tetqind e tetedhjetë e shtate mijë e shtateqind e tetembdhjet) lekë pa TVSh ose 24 240 (njetzet e kater mijë e dyqind e dyzet) Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 30/06/2022 është 119.38 Lekë/ Euro.	5. Oferta fituese, vlera fituese: Loti nr.1 "Blerje Naftë" Operatori Fitues: O.SHPK 56,931,300 (pesedhjetë e gjashtë milion e nentqind e tridhjetë një mijë e treqind) leke pa TVSh. Loti nr.2 "Blerje Benzine" Operatori Fitues: O.SHPK 2 538 450 (dy milion e peseqind e tridhjetë e tete mijë e katerqind e pesedhjet) leke pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit Loti nr.1 "Blerje Naftë" 4,681,616 lekë pa TVSh Loti nr.2 "Blerje Benzine" 349,268 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 05.08.2022 7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj.	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise Devoll.		9. Operatorët Ekonomike LOTI 1 NAFTA: a)Pjesëmarrës në tender, 2 (Dy)OE b) S'kualifikuar 0 B/OE,

		c) Kualifikuar 2(Dy) B/OE LOTI 2 BENZINA: a) Pjesëmarrës në tender, 2 (Dy) OE b) S'kualifikuar 0 B/OE , c) Kualifikuar 2(Dy) B/OE
10. Ankimime AK-s'ka APP-ka ; KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Loti nr.1 "Blerje Naftë" Nr. 2891 prot., datë 29.08.2022 Loti nr.2 "Blerje Benzine" Nr. 289/1 prot., datë 29.08.2022	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK APP-ja pas rekomandimeve mbi procedurën e prokurimit ka marrë përgjigje nga AK me e-mailin e dt.04.08.2022

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Blerje karburant per nevoja te Bashkise Devoll Naftë dhe Benzine", me fond limit në shumën 61,875,429 lekë pa TVSh ose 519,394 Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 30/06/2022 është 119.13 Lekë/ Euro, i ndarë si më poshtë:

Loti nr.1 "Blerje Naftë", me fond limit: 58,987,711 lekë pa TVSh ose 495,154 Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 30/06/2022 është 119.13 Lekë/ Euro.

Loti nr.2 "Blerje Benzine", me fond limit 2,887,718 lekë pa TVSh ose 24,240 Euro. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 30/06/2022 është 119.38 Lekë/ Euro.

Me vlera të kontratave në shumën Loti nr.1 "Blerje Naftë" 56,931,300 leke pa TVSh.

Loti nr.2 "Blerje Benzine" 2,538,450 leke pa TVSh.

Në procedurën e prokurimit Loti nr.1 "Blerje Naftë, kanë marrë pjesë 2(dy) OE, nga të cilët 2(dy) janë kualifikuar dhe asnjë nga OE/BOE nuk janë s'kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE O.SHPK me vlerë oferte në shumën 56,931,300 leke pa TVSh.

Në procedurën e prokurimit Loti nr.2 "Blerje Benzine" kanë marrë pjesë 2(dy) OE, nga të cilët 2(dy) janë kualifikuar dhe asnjë nga OE/BOE nuk janë s'kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE O.SHPK me vlerë oferte në shumën 2,538,450 leke pa TVSh konstatohet se:

AK në lidhje me "Hartimin e Specifikimeve Teknike" dhe "Përlllogaritjen e Fondit Limit";

-Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin Nr 2318/1, datë 30.06.2022 është ngritur grupi i punës "Për llogaritjen e fondit limit", i përbërë nga 1.E.A. 2.M.M. 3.E.K.

Sipas procesverbalit Nr. 2318/3 të datës 30.06.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në urdherin e Titullarit të institucionit Nr.06.05.2022 "Per caktimin e limitit mujor të karburantit për vitin 2022" i ndryshuar me Urdhërin Nr.06/3 datë 01.04.2022, Urdhërin 06/5 datë 25.04.2022 të cilët përcaktojnë limitin mujor të harxhimit të karburantit. Në përlllogaritjen e fondit limit njësia ju referua cmimeve zyrtare të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomise të datës 29 Qershor 2022 dhe në aktin Normativ Nr.05. Datë 12.03.2022 "Për disa shtesa në ligjin Nr.8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin transportimin dhe tregëtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. nr 2318/1, datë 30.06.2022 është ngritur grupi i punës, i përbërë nga 1.E.A. (Person Përgjegjës) 2.M.M. (Anëtar) 3.E.K. (Anëtar) Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 2318/3, datë 30.06.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk është dokumentuar dhe argumentuar llogaritja e sasisë së kërkuar mbi bazën e të cilës është përlllogaritur dhe vlera e fondit limit të kontratës.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.E.A. (Person Përgjegjës) 2.M.M.(Anëtar) 3.E.K.(Anëtar), janë evidentuar në procesverbalin nr. 2318/6 e datës 30.06.2022, të cilat janë si më poshtë;

Loti nr.1 Blerje Naftë

Shtojca 7

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.3 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje) pike stacioni të shitjes së karburantit (G.) me pakicë brenda territorit administrativ të Bashkise Devoll, Stacion i cili duhet te kete te pakten 5(pese) vjet ushtrim aktiviteti ne territorin e Bashkise Devoll. (vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi) ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar.

2.3.5 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë-në në pronësi ose me qera **1 (një) autobot** të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës (kondralitër). Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat dhe mjetet e tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor.

Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qerave + leje qarkullimmi (në rastet e marrjes me qera) si dhe Çertifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Automjeti të ketë të vendosur kontalitrin e kalibruar dhe certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të vërtetuar me çertifikatën e lëshuar nga kjo drejtori. Për arsye të vendodhjes së depozitave dhe mjeteve të tonazhit të rendë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim jo më të madh se 1000 (njemijë) litra.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar.

Loti nr. 2 Blerje Benzine

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3.3 Operatori/et Ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje) pike stacioni të shitjes së karburantit (benzine) me pakicë brenda territorit administrativ të Bashkise Devoll, Stacion i cili duhet të ketë te pakten 5(pese) vjet ushtrim aktiviteti në territorin e Bashkise Devoll. (vertetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontratë qeraje ose kontratë furnizimi) ku të jetë e përcaktuar adresa e saktë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar, kriter i cili mund të ndikojë në kufizimin e pjesëmarrjes së OE.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 2318/2 Prot datë 30.06.2022, të titullarit të AK,, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar komisioni) 2.G.K. (Anëtar) 3.V.Q. (Anëtar).

Në procedurën e prokurimit **Loti nr.1 “Blerje Naftë”** kanë marrë pjesë 2 (Dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2318/12 Prot. të datës 09.08.2022 **Loti nr.1 “Blerje Naftë”**, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Loti nr.1 “Blerje Naftë”.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/ S’kualifikuar
1	O.SHPK	56,931,300 (pesedhjetë e gjashtë milion e nentqind e tridhjetë një mijë e treqind) leke pa TVSh.	Kualifikuar
		11.2 lekë/litër Norma e fitimit	
2	K.SHPK	58,987,711 (pesedhjetë e tete milion e nentqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëbedhjetë) leke pa TVSh.	Kualifikuar
		11.4 lekë/litër	

Loti nr.2 “Blerje Benzine”

Me urdhrin nr. 2318/2 Prot datë 30.06.2022, të titullarit të AK,, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar komisioni) 2.G.K. (Anëtar) 3.V.Q. (Anëtar).

Në procedurën e prokurimit **Loti nr.2 “Blerje Benzine ”** kanë marrë pjesë 2 (Dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit Nr. 2318/13 Prot. të datës 09.08.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	O.SHPK	2,538,450 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e tete mijë e katerqind e pesedhjet) leke pa TVSh	Kualifikuar
		Norma e fitimit 11.2 lekë/litër	
2	K.SHPK	2,887,718 (dy milion e teteqind e tetëdhjetë e tete mijë e shtatëqind e tetëbedhjet) leke pa TVSh.	Kualifikuar
		Norma e fitimit 11.4 lekë/litër	

Nga KVO për procedurën e prokurimit: Loti nr.1 “Blerje Naftë është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 2318/17 Prot. më datë 25.08.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të

njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës nuk janë s'kualifikuar asnjë nga OE, janë kualifikuar 2 OE të cilët plotësojnë kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 25.08.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE/BOE "O." Sh.p.k për të cilën është lidhur marrëveshja kuader datë 29.08.2022 për vlerën Loti nr.1 "Blerje Naftë" 56,931,300 leke pa TVSh ose 68,317,560 leke me TVSh dhe me afat 24muaj/ nga data e lidhjes së marrëveshjes kuader deri në 29.08.2024.

Nga KVO për procedurën e prokurimit: Loti nr.2 "Blerje Benzine" është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 2318/19 Prot. më datë 25.08.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatorë pjesëmarrës nuk janë s'kualifikuar asnjë nga OE, janë kualifikuar 2 OE. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 25.08.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE/BOE "O." Sh.p.k për të cilën është lidhur marrëveshja kuader datë 29.08.2022 për vlerën Loti nr.2 "Blerje Benzine" 2,538,450 leke pa TVSh ose 3,046, leke me TVSh dhe me afat 24(Njëzet e katër) muaj/ nga data e lidhjes së marrëveshjes kuader deri në 29.08.2024.

Titulli i gjetjes: Nuk dokumentohet llogaritja e sasisë që nevojitet për karburant, nuk argumentohen specifikimet teknike dhe nuk ka specialist të fushës në komisionet e ngritura.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Devoll Naftë dhe Benzine"*, me fond limit në shumën 61,875,429 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën Loti nr.1 "Blerje Naftë" 56,931,300 leke pa TVSh ose 68,317,560 leke me TVSh Loti nr.2 "Blerje Benzine" 2,538,450 leke pa TVSh ose 3,046,140 leke me TVSh, u konstatua se:

-Autoriteti Kontraktor nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës së kontratës sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 76, pika 2-3, pasi nuk dokumentohet dhe argumentohet sasia e karburantit mbi të cilën është hartuar fondi limit.

-Nuk janë argumentuar specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit, veprime jo në përputhje me nenin VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 2.

-Në Njësinë e Prokurimit i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kriterëve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet. Veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 74, pika 2, në të cilin citohet se;

Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

dhe neni 75, paragrafi i parë në të cilin citohet se;

"Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës.

Me procesverbalin nr. 2318/6 e datës 30.06.2022, nga Bashkia Devoll, Njësia e Prokurimit, janë miratuar kriteret e kualifikimit dhe specififikimet teknike të procedurës së prokurimit. Nga auditimi rezulton njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar kriteret e kualifikimit të cilat nuk janë të argumentuara në lidhje me objektin dhe natyrën zbatuese të kontratës. Vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre. Hartimi i specifikimeve teknike nuk është argumentuar me dokumentacion në mënyrë teknike dhe ligjore. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E.D., zj. E.A., z. M.M. dhe z. E.K. në cilësinë e anëtarëve të NjP dhe llogaritjes së fondit limit.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 ku citohet se;

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cialt citohet se;

Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, ku përcaktohet se;

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3 e cila citon se;

Kërkesat e të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky

procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Mos përcaktim të saktë sipas nevojave për karburant, mosvlerësim të drejtë dhe objektiv të ofertave.

Shkaku: Mos njohja e legjislacionit, përcaktimi i anëtarëve të komisioneve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit. Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të specifikimeve teknike.

3. Procedura e prokurimit me objekt "**Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara**" me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur -Pune" REF-40407-09-01-2022 Urdhri nr. 2886/5 prot., datë 29.06.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 2886/1, datë 29.08.2022 1.E.A. 2.E.M. 3.Th.K.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr.2886/1, datë 29.08.2022 1.E.A. 2.E.M. 3.Th.K.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2886/6 prot. datë 29.08.2022. 1.R.H. 2.G.K. 3.A.H.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 27,650,357 (njëzet e shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e shtatë) leke pa TVSh	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE: A.K.2002"ShPK & V.-CO ShPK) 22,968,741 (njezet e dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzet e një) lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 4,681,616 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 26.09.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i shtetit. + Te ardhurat e Bashkise		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 4 (Kater)OE b) S'kualifikuar 2(Dy) B/OE, c) Kualifikuar 2(Dy) B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës:4 muaj.			
10.Ankimime AK-s'ka APP-s'ka; KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2886/21 prot., datë 08.11.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Në datën 16.09.2022 u be modifikimi I Dst pas kërkesave të OE të interesuar.

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara", me fond limit në shumën 27,650,357 leke pa TVSh, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë pa TVSh, kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët 2 janë kualifikuar dhe 2 OE/BOE janë s'kualifikuar, ku është shpallur fitues BOE: ("A.K.2002" ShPK & "V.-CO" ShPK" me vlerë oferte në shumën: 22,968,741 lekë pa TVSh konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” ;

Nga ana e titullarit të AK, me urdhrin Nr. **2886/1 prot. datë 29.08.2022** është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.E.M. 3.Th.K..

Sipas procesverbalit nr. 2886/2 prot. të datës 29.08.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit është bazuar tek vlera e preventivit dhe projektit të zbatimit të hartuar nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në përputhje me Manualin e çmimeve sipas VKM 629 datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” e cila rezulton të jetë e cila rezulton të jetë, **27,650,357 leke pa TVSh.**

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. nr **2886/1, datë 29.08.2022** është ngritur grupi i punës, i përbërë nga 1.E.A. (Person Përgjegjës)2.E.M.(Anëtar) 3.Th.K.(Anëtar) Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 2886/7, datë 29.08.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej: E.A. (Person Përgjegjës) 2.E.M.(Anëtar) 3.Th.K.(Anëtar) dhe janë evidentuar në procesverbalin Nr. 2886/7, datë 29.08.2022, në të cilin disa prej kritereve nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht dhe disa janë të panevojshme për këtë objekt prokurimi, edhe pas ndërhyrjes nga ankesat e paraqitura nga disa OE të interesuar për këtë procedurë, për të cilat është bërë nëpërmjet shtojcës modifikimi i Dokumenteve të Tenderit me datë 16.09.2022, të cilat janë si më poshtë;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: Kontratën, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit, lejen e përdorimit, faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht në lidhje e në funksion të objektit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

- NP-1 A (Punime Germimi ne toke)

- **NP-2 B (Ndertime civile dhe industriale)**
- **NP-3 A (RiK.dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)**
- **NS-1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)**
- **NS-4 A (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)**
- **NS-18 A (Punime topogjeodezike)**

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhenien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi .

Ky kriter për paraqitjen e licensave nuk është i argumentuar ligjërisht se përse i është kërkuar OE pjesëmarrës, gjithashtu janë kërkuar licenca të cilat nuk janë në përputhje dhe të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, mund të ndikojë në kufizimin e pjesëmarrjes së tyre.

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në listëpagesat e shoqërise, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm;

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë
- c) CV

2.3.4 Nje punësim mesatar për periudhën **Maj 2022 – Korrik 2022**, i të paktën **45** (dyzet e pesë) personave të vërtetuar me ;

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në licencën dhe listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Nderimi
- 1 (një) inxhinier Gjeodet ose Topograf

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si mëposhtë ;

- **2 (dy)** punonjës teknikë ndertimi
- **7 (shtatë)** punonjës karpertiere
- **3 (Tre)** punonjës muratore

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme ; dëshmia/certifikata/diploma; dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

2.3.7 “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht

- 2 (Dy) manovratorë të mjeteve të rënda, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;
- 4 (katër) shoferë për kamiona (kategoria C minimale) dhe Certifikatë e Aftësisë Profesionale, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

Kriteret për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar, përveç se nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, konsiderohet diskrimues pasi sjell pabarazi ndërmejt OE. Referuar listës së punonjësve të kërkuar, janë reth 20 për inxhinierë dhe punonjës të natyrave të ndryshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale, ndërkohë që një numër mesatar jo më pak se 45 punonjës me kohë të plotë për periudhën Maj 2022 - Korrik 2022, që i është kërkuar OE ofertues, ndikon në kufizimin e pjesmarrjes së tyre.

2.3.8 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i Makinerive	Sasia	
Kamion me vinc	1 copë	Pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues 7-12 ton	1 copë	Pronesi ose me qera
Kamioncine deri në 3.5 ton	2 copë	Pronesi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronesi ose me qera
Eskavator	1 cope	Pronesi ose me qera
Betoniere $V=0.25\text{ m}^3$	3 copë	Pronesi ose me qera
Fikse zjarri	10 copë	Pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	1 copë	Pronesi ose me qera
Depozite uji	1 copë	Pronesi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronesi ose me qera
Trako	1 copë	Pronesi ose me qera
Trapan	1 copë	Pronesi ose me qera
Kuti të ndihmës së shpejteë	4 copë	Pronesi ose me qera

Ky kriter për makineritë nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

• **Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.**

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

a) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;ose

b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

➤ a) Për mjetet e mesiperme, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), certifikate pronësie, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, fotot e tyre ku të duken qarte mjetet e mesiperme dhe certifikatat e transportit për mjetet e transportit.

➤ b) Kur mjetet janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirase, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentet e përshkruar me sipër. Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish në lidhje me objektin e kontratës së prokuruar.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent

- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë çertifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin Nr. 2886/6 prot. datë 29.08.2022, të titullarit të AK., është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar komisioni) 2.G.K. (Anëtar) 3.A.H. (Anëtar). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 (Katër) OE, për të cilët, referuar procesverbalit Nr. 2886/14 prot. të datës 10.10.2022, dhe Procesverbalit të rivlerësimit Nr, 2886/15 datë 20.10.2022 KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“A.K.2002” ShPK & “V.-CO” ShPK	22,968,741	Kualifikuar
2	“A.” ShPK	24,823,776	Kualifikuar
3	R. ShPK	19,589,602	Kualifikuar
4	“A.A.” ShPK	19,037,241	S’kualifikuar; OE nuk ka paraqitur asnjë dokument për të përmbushur piken 2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohete fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Referuar procesverbalit nr. 2886/15, të datës 20.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE rivlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	“A.K.2002” ShPK & “V.-CO” ShPK	22,968,741	Kualifikuar
2	“A.” ShPK	24,823,776	Kualifikuar
3	R. ShPK	19,589,602	S’Kualifikuar OE REJ SHPK nuk paraqiti dokumentacionin provues të Formularit përmbledhës i vetëdeklarimit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, dhe nisjes së afateve të ankimit. Ku autoriteti kontraktor i kërkoi ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 neni 26 VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Sipas percaktimeve të LPP.
4	“A.A.” ShPK	19,037,241	S’kualifikuar; OE nuk ka paraqitur asnjë dokument për të përmbushur piken

			2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet e fondit limit të kontratës që po prokurohet.
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr. 2886/18 prot. më datë 01.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 2 OE të cilët plotësojnë kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 01.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë: BOE "A.K.2002 ShPK & "V.-CO" ShPK" për të cilën është lidhur kontrata datë 08.11.2022 për vlerën 19,037,241 (nëntëmbëdhjetë milion e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e dyzet e një) lekë pa TVSH ose 27,562,489.2 (njëzet e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë pikë dy) lekë me TVSH, dhe me afat 4(katër) muaj/ nga data e fillimi i punimeve.

Titulli i gjetjes: Vlerësim i ofertave jo në përputhje me parimet dhe qëllimin e LPP.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Permirësimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfëra dhe te pafavorizuara*", me fond limit në shumën 27,650,357 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë, u konstatua: Referuar raportit përmbledhës së hartuar dhe nënshkruar nga KVO dhe titullari i AK, ku për këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE nga të cilët janë s'kualifikuar 2 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, vërehet se është s'kualifikuar OE "A.A." ShPK, me vlerë oferte në shumën 19,037,241 lekë me arsyen se nuk ka paraqitur vërtetimin për të provuar kapacitetet financiare për vërtetimin e xhiros vjetore për vitet 2019,2020 dhe 2021, ku për një prej këtyre viteve vlera e xhiros së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Vlerësimi i KVO nuk është bërë i drejtë pasi OE "A.A." ShPK ka parqitur bilancet e viteve 2019 dhe 2020, në të cilat është evidente në llogaritë përkatëse situata e qarkullimit vjetor disa herë më shumë se vlera e objektit të kontratës për këtë procedurë. Pra rrjedhimisht nëse KVO do të kualifikonte këtë OE, në përputhje me qëllimin dhe parimet e LPP, Bashkia Devoll do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, në një diferencë prej 3,931,500 lekë (22,968,741-19,037,241) pa TVSh dhe një vlerë **4,717,800 lekë me TVSh e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Devoll**. Kjo pasi dokumenti për xhiron vjetore, nuk ndikon thelbësisht në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet devijim i vogël, për përmbushjen e kontratës, sepse, sipas legjislacionit, mund të gjendet në dokumente të tjera zyrtare (në rastin në fjale, tek bilanci). *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E.D. dhe KVO z. R.H., z. G.K. dhe zj. A.H..*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2 ku citohet se; Qëllimi i këtij ligji është:

- | |
|--|
| <p>a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;</p> <p>b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;</p> <p>c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;</p> <p>ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;</p> |
|--|

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, ku përcaktohet se;

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, paragrafi i dytë, në të cilin citohet se:

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Ndikimi/Efekti: S’kualifikimi i OE ka sjellë për pasojë efekt negativ financiar në shumën 4,717,800 lekë për buxhetin e Bashkisë Devoll.

Shkaku: Vlerësim jo objektiv i KVO dhe jo në përputhje me legjislacionin e Prokurimit Publik.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mire përdorimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomicitet.

Titulli i gjetjes: Kriteria të kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara*”, me fond limit në shumën 27,650,357 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë, u konstatua se: Me procesverbalin nr. 2886/2 prot. të datës 29.08.2022, nga Bashkia Devoll, Njësia e hartimit të kriterëve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, ka hartuar kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Nga auditimi rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar kriteret e kualifikimit duke ulur ndjeshëm edhe efektivitetin, efikasitetin dhe ekonomicitetin e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kriterëve për OE pjesëmarrës. Vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk janë të sqaruara në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja kërkesave të tyre për, licencat, certifikatat e kërkuara, mjetet e punës, numri i fuqisë punëtore etj. Këto kriterë nuk duhet të vendosen pasi, referuar LPP, vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, sepse nuk janë të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet. Veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Për hartimin e specifikimeve teknike nuk është mbajtur procesverbali apo dokumentacion për argumentimin tekniko/ligjor të tyre. Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E.D., zj. E.A., zj. E.M. dhe z. Th.K. në cilësinë e anëtarëve të NjP.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, nenin 3, neni 21, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3, neni 78, pika 2.

Ndikimi/Efekti: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarje, trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

4. Procedura e prokurimit me objekt “Servis dhe Pjese Kembimi” me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ” Servis dhe Pjese Kembimi”			
1. Lloji/Urdhri i Procedure e Hapur –Sherbim (Marreveshje Kuader me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara)- REF- 38407-08-11-2022 Urdhri nr. 2769 prot, datë 11.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 2248/1, datë 27.06.2022 1.E.A. 2.G.K. 3.K.M.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 2248/1, datë 27.06.2022 1.E.A. 2.G.K. 3.K.M.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2248/6 prot., datë 29.06.2022. 1.R.H. 2.M.M. 3.A.C.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 15,130,000(pesëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSh.	5. Oferta fituese,: Operatori Fitues: T.3A SHA 14,189,167 (katërmëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSh		6. Diferenca me fondin limit. 940,833 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 29.08.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise Devoll.		9. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 1 (nje)OE b) S’kualifikuar: 0 B/OE , c) Kualifikuar 1(nje) B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 24 muaj.			
10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka; KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3112 prot., datë 16.09.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Nuk ka

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt ”Servis dhe Pjese Kembimi”, me fond limit në shumën 15,130,000 pa TVSh, dhe vlerë kontrate në shumën 14,189,167 lekë pa TVSh konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;

Titulli i gjegjes: Nuk janë argumentuar specifikimet teknike, nuk dokumentohet dhe argumentohet fondi limit dhe përzgjedhja e procedurës.

Situata: Nga ana e titullarit të AK, me urdhërin Nr. 2248/1 Prot, datë 27.06.2022 është ngritur grupi i punës “Përlllogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.G.K. 3.K.M.. Sipas procesverbalit Nr. 2248/2 Prot. të datës 28.06.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrit të

veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezultoi të jetë në vlerën 15,130,000 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSh.

-Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me urdhrin nr. 2248/1 Prot. datë 27.06.2022 është ngritur grupi i punës i përbërë nga 1.E.A. (Person Përgjegjës) 2.G.K. (Anëtar) 3.K.M. (Anëtar) “Për hartimin e specifikimeve teknike” nga të cilët është mbajtur procesverbali me Nr. 2248/2 Prot. datë 28.06.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim. Nga sa më sipër rezultoi se në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës nuk rezultoi të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu rezultoi se nuk është bërë një përshkrim i mallrave të cilat do të prokurohen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “Marrëveshje Kuadër E hapur”. Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK Z. E.D., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. E.A., z. G.K. e z. K.M..

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku citohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk dokumentohet përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, nuk ka argumentim të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përlllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë nga: E.A. (Person Përgjegjës) 2.G.K. (Anëtar) 3.K.M.(Anëtar), janë evidentuar në procesverbalin nr. 2769/1 të datës 11.08.2022, të cilat në përgjithësi janë sqaruar edhe nëpërmjet observacioneve për ato kritere të cilat ishin konstatuar të pa argumentuara, gjatë fazës së auditimit në terren, duke u konsideruar në përgjithësi në përputhje me Legjislacionin e Prokurimit Publik.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 2248/6 prot. datë 29.06.2022, të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave”, i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar komisioni) 2.M.M. (Anëtar) 3.A.C. (Anëtar). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 (Një) OE, për të cilin, referuar procesverbalit të vlerësimit të ofertave Nr. 2769/5 Prot. të datës 31.08.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	T.3A SHA	14,189,167 (katërmëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSh.	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me Nr. 2769/8 Prot. më datë 14.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operator pjesëmarrës nuk janë s'kualifikuar asnjë nga OE, është kualifikuar 1 OE i cili plotëson kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 14.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE/BOE "T.3A" SHA, e cila plotëson dokumentacionin e kërkuar nga AK, dhe është lidhur marveshja kuader datë 16.09.2022 për vlerën 14,189,167 lekë pa TVSh ose 17,027,000 lekë me TVSh dhe me afat 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër deri me 16.09.2024.

Titulli i gjetjes: Kriteria të kualifikimit të pa argumentuara dhe të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, gjithashtu specifikimet teknike nuk kanë asnjë argumentim tekniko/ligjor.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Servis dhe Pjese Kembimi", me fond limit në shumën 15,130,000 pa TVSh, dhe vlerë kontrate në shumën 14,189,167 lekë pa TVSh, u konstatua se: Me procesverbalin nr. 2769/1 te datës 11.08.2022, nga Bashkia Devoll, Njësia e Prokurimit, janë miratuar kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. Nga auditimi rezulton se njësia e prokurimit ka hartuar dhe miratuar kriteret e kualifikimit të cilat nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në funksion me objektin dhe natyrën zbatuese të kontratës. *Veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. E.D., zj. E.A., z. G.K. dhe z. K.M. në cilësinë e anëtarëve të NjP.*

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, nenin 3, neni 21, me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë.

Ndikimi/Efekt: Nuk nxit konkurrencën, mungesë pjesëmarrje, trajtim i pabarabartë i ofertuesve në procedurat e prokurimit.

Shkaku: Vendosja e kriterëve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

5. Procedura e prokurimit me objekt "Pastrim Pylli" me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Pastrim Pylli"			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedure e Hapur e thjeshtuar-Sherbime REF-40065-08-29-2022 Urdhri nr. 2790/4, datë 16.08.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 2790/2, datë 16.08.2022 1.E.C. 2.A.D. 3.A.K.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 2790/1, datë 16.08.2022 1. E.A. 2.E.C. 3.A.D.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2790/5, datë 24.08.2022 1.R.H. 2.G.K. 3.A.K.

4. Fondi Limit (pa TVSh) 1,650,769 (nje milion e gjashteqind e pesedhjetë mije e shtateqind e gjashtedhjetë e nente) leke pa TVSH	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (M.-L – SHPK) 1,550,808 (nje milion e pesëqind e pesedhjetë mije e tetqind e tete) leke pa TVSh	6. Diferenca me fondin limit 99,961 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 09.09.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise Devoll	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S'kualifikuar 0 B/OE, c) Kualifikuar 2 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.		
10. Ankimime AK-s'ka APP-s'ka; KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.2790/14 Prot. datë 06.10.2022	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP:

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Pastrim Pylli”, me fond limit në shumën: 1,650,769 leke pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën 1,550,808 leke pa TVSH, konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;

Me Urdhrin Nr. 2790/2, datë 16.08.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit, i përbërë nga 1.E.C. 2.A.D. 3.A.K., Sipas procesverbalit Nr. 2790/3 Prot. të datës 16.08.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur tarifat e përcaktuara në librin e normave të punës me krahë dhe me kafshë për punimet bujqësore dhe pyjore Shenjen e manualit faqe 231, pika 5-b, duke përlllogaritur si fond limit vlerën e cila rezulton të jetë: 1,650,769 leke pa TVSH, miratuar dhe nga Ministria

Me urdhrin nr. Urdhrin Nr. 2790/2, datë 16.08.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.E.C. (Pergjegjes i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve), 2.A.D. (specialist pyjesh) 3.A.K. (specialist Pyjesh). Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me Nr. 2790/3 Prot. të datës 16.08.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej: 1 E.A. 2.E.C. 3.A.D. të cilat janë evidentuar në procesverbalin Nr 2790/6 Prot. te datës 29.08.2022, të cilat në përgjithësi janë sipas Legjislacionit të Prokurimit Publik.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me Urdhrin nr. 2790/5, datë 24.08.2022 është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave” i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar) 2.G.K. (Anëtar) 3.A.K. (Anëtar).

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 (dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit të vlerësimit nr. 2790/10 Prot, të datës 14.09.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar / S'kualifikuar
1	M.-L - SHPK	1,550,808	Kualifikuar
2	L.	1,564,000	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 2790/13 Prot, të datës 26.09.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operatore pjesëmarrës janë s'kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 2 OE të cilët plotësojnë kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 26.09.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE: M.-L SHPK, e cila plotëson kërkesat e AK me dokumentacion përkatës dhe është lidhur kontrata Nr.2790/14 Prot. datë 06.10.2022 për vlerën 1,550,808 leke pa TVSh OSE 1,860,969 leke me TVSh dhe me afat 12 muaj nga nënshkrimi i kontrates.

6. Procedura e prokurimit me objekt **“Blerje Eskavator”** me të dhënat si më poshtë:

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Eskavator”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar-Mallra REF-43255-09-26-2022 Urdhri nr. 3146/5 prot.,datë 21.09.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.3146/1,datë 20.09.2022 1.E.A. 2.E.K. 3.K.M.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 3146/1,datë 20.09.2022 1.E.A. 2.E.K. 3.K.M.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3146/6 prot.,datë 21.09.2022. 1.R.H. 2.G.K. 3.A.D.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 4 350 000 (katër milion e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH	5. Oferta fituese,vlera fituese: Operatori Fitues: (V.-Co ShPK) 4,340,000 (katër milion e treqind e dyzet mijë) lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 10,000 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 07.10.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise Devoll		9. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender,2 OE b) S'kualifikuar 1 B/OE, c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 15 Ditë nga nënshkrimi i kontratës.			
10.Ankimime AK-s'ka APP-s'ka; KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.3589 prot.,datë 28.10.2022		12.Përgjigje Ankesës nga APP,AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Eskavator”,me fond limit në shumën 4,350,000 lekë pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën 4,340,000 lekë pa TVSh konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;

Titulli i gjegjes: Nuk janë argumentuar specifikimet teknike dhe përzgjedhja e procedurës.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Eskavator”, me fond limit në shumën 4,350,000 lekë pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën 4,340,000 lekë pa TVSh konstatohet se:

Me urdhrin. nr.3146/1 Prot,datë 20.09.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.E.K. 3.K.M.. Sipas procesverbalit të datës 20.09.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përlllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezulton të jetë 4,350,000 lekë pa TVSH. Me

urdrin nr. 3146/1, datë 20.09.2022 është ngritur grupi i punës “Për hartimin e specifikimeve teknike”, i përbërë prej, 1.E.A. Person Pergjegjës 2.E.K. (Anëtar) 3.K.M. (Anëtar).

Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me nr. 3146/2, datë 20.09.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim. Nga sa më sipër rezulton se në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës nuk rezulton të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu rezulton se nuk është bërë një përshkrim i mallrave të cilat do të prokurohen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur mallra”. Veprim për të cilin mban përgjegjësi *titullari i AK Z. E.D., anëtarët e njësish së prokurimit, zj. E.A., z. E.K. e z. K.M.*

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk argumentohen specifikimet teknike të objektit të prokurimit.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrin të prokurimit të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin teknikoligjor të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.E.A. 2.E.K. 3.K.M., janë evidentuar në procesverbalin Nr 3146/7 Prot. te datës 26.09.2022, të cilat në përgjithësi janë sipas Legjislacionit të Prokurimit Publik;

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 3146/6 prot. të titullarit të AK, datë 21.09.2022, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave” i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar), 2.G.K. (Anëtar), 3.A.D. (Anëtar). Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 (Dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3146/11 Prot., të datës 12.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	V.-CO” ShPK	4,340,000	Kualifikuar
2	S.32” ShPK	4,180,000	S’kualifikuar; KVO pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga OE ”S.32” SHPK për të përmbushur piken 2.3.2 të DST,ku; “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën ose librezën e mjetit, foto të eskavatorit dhe të kovave të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe me përshkrimin e karakteristikave teknike të mjetit që ofron, konstatoi se; karakteristikat e eskavatorit të paraqitur në SPE nga OE ”S.32” SHPK nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe me përshkrimin e

			karakteristikave teknike te mjetit qe kerkohet nga AK Bashkia DEVOLL.
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 3146/14 më datë 27.10.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operator pjesëmarrës janë s’kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE i cili plotëson kërkesat e AK. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 27.10.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE “V.-CO” ShPK, për të cilën është lidhur kontrata datë 17.10.2022 për vlerën 4,340,000 lekë pa TVSH dhe 5,208,000 lekë me TVSH, dhe me afat 15 ditë nga lidhja e kontratës 28.10.2022/deri më 10.11.2022.

7. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje Pelet” me të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pelet”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur e Thjeshtuar-Mallra REF- 44739-10-06-2022 Urdhri nr. 3327/1 prot., datë 05.10.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr.3073/1, datë 14.09.2022 1.E.A. 2.X.P. 3.G.K.	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr.3073/1, datë 14.09.2022 1.E.A. 2.X.P. 3.G.K.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3327/3 prot., datë 06.10.2022. 1.R.H. 2.E.L. 3.A.C.
4. Fondi Limit (pa TVSh) 1,666,640 (nje milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet) leke pa TVSH	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: (E.G.J.) 1,666,000 (nje milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) leke pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 640 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 17.10.2022	8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise Devoll		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 2 OE b) S’kualifikuar 1 B/OE , c) Kualifikuar 1 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor deri në dt. 31.12.2022			
10. Ankimime AK-s’ka APP-s’ka; KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr.4006 prot., datë 18.11.2022		12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Nga auditimi i dokumentacionit dosjes së procedurës së prokurimit me objekt “Pelet”, me fond limit në shumën 1,666,640 leke pa TVSH, dhe vlerë kontrate në shumën, 1,666,000 leke pa TVSH, kanë marrë pjesë 2 (Dy) OE, nga të cilët 1(Një) OE është kualifikuar dhe 1(Një) OE/ është s’kualifikuar, ku është shpallur fitues OE/BOE E.Gj. me vlerë oferte në shumën 1,666,000 leke pa TVSH. konstatohet se:

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”;

Titulli i gjegjes: Nuk janë argumentuar specifikimet teknike dhe përzgjedhja e procedurës.

Situata: -Nga ana e titullarit të AK, me Urdhrin nr.3073/1, datë 14.09.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.X.P. 3.G.K.. Sipas procesverbalit Nr. 3327 Prot. të datës 05.10.2022, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “studimit të tregut”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, ka studiuar

ofertat e tregut nga 3 OE të ndryshëm duke përllogaritur si fond limit vlerën mesatare të këtyre të fundit e cila rezultojnë të jetë, 1,666,640 leke pa TVSH.

-Nga titullari i AK, në zbatim të LPP-së, me Urdhrin nr.3073/1, datë 14.09.2022 është ngritur grupi i punës “Për llogaritjen e fondit limit”, i përbërë nga 1.E.A. 2.X.P. 3.G.K. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbali me Nr. 3327 Prot. të datës 05.10.2022 nga komisioni i krijuar për këtë qëllim. Nga sa më sipër rezultojnë se në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike të procedurës nuk rezultojnë të jenë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në Dokumentet e Tenderit. Rezultojnë se nuk është bërë një përshkrim i mallrave të cilat do të prokurohen dhe arsyeja e përzgjedhjes së kësaj procedure prokurimi “E hapur mallra”. Gjithashtu nuk është argumentuar në dokumentin e llogaritjes së fondit limit, sasia e kërkuar prej 40 ton. Veprim për të cilin mban përgjegjësi titullari i AK Z. E.D., anëtarët e njësisë së prokurimit, zj. E.A., zj. X.P. e z. G.K..

Kriteri: VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 2, ku citohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Ndikimi/Efekti: Nuk dokumentohet përllogaritja e vlerës limit të kontratës.

Shkaku: Mosrespektimi i kuadrit ligjor të PP.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrit të prokurimit të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin teknikoligjor të specifikimeve teknike dhe përzgjedhjes së procedurës së prokurimit.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej 1.E.A. 2.X.P. 3.G.K., janë evidentuar në procesverbalin Nr 3327/2 Prot. të datës 06.10.2022, të cilat janë në përgjithësi në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me Urdhrin nr. 3327/3 prot. datë 06.10.2022 të titullarit të AK, është ngritur “Komisioni i vlerësimit të ofertave” i përbërë prej, 1.R.H. (Kryetar) 2.E.L. (Anëtar) 3.A.C. (Anëtar) Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 (Dy) OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3328/1 Prot, të datës 25.10.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	E.GJ.	1,666,000 (një milion gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) leke pa TVSh.	Kualifikuar
2	L.S.	_____	S’kualifikuar; OE nuk ka ngarkuar asnjë dokument për të plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit përveç ekstraktit të QKB-se.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 3328/4 më datë 10.11.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 2 operator pjesëmarrës është s'kualifikuar 1 OE, është kualifikuar 1 OE i cili plotëson me dokumentacion kërkesat e AK për përmbushjen e kontratës. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 10.11.2022 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë OE: E.GJ., për të cilën është lidhur kontrata datë 18.11.2022 për vlerën 1,666,000 leke pa TVSh. Ose 1,999,200 leke me TVSh dhe me afat, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor deri në dt. 31.12.2022.

Observacion:

Për sa më sipër subjekti i audituar nëpërmjet shkresave nr 527/1, datë 24.01.2024, administruar nga KLSH me nr. 868/5, datë 26.01.2023, ka paraqitur komente dhe shpjegime për konstatimet në lidhje me procedurat e prokurimit e konkretisht, nga zj. E.A., zj. E.M., z. R.H., z. G.K., z. M.M., z. E.K., është paraqitur observacion lidhur me;

Pretendimi i subjektit:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i shkolles fillore “Myrteza Sala” nga observuesit janë paraqitur sqarime në lidhje me argumentimet e vendosjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit, për licencat e kërkuara profesionale, stafin e punonjësve të kërkuar së bashku me analizën, për ekspertin e mjedisin të pajisur me certifikatë “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, certifikata kualifikimi me sstandarde ISO etj, Licenca për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve, licencë për mbrojtjen nga zjarri, sqarime mbi mjetet e kërkuara, punonjës Auditues Energjitik i Certifikuar me titull “Auditues Energjie në ndërtesa industriale”, etj.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara” nga observuesit janë paraqitur sqarime në lidhje me argumentimet e vendosjes së kriterëve të kualifikimit, për licencat e kërkuara profesionale, stafin e punonjësve të kërkuar së bashku me analizën, certifikata kualifikimi me sstandarde ISO, sqarime mbi mjetet e kërkuara, etj. Gjithashtu pretendohet nga observuesit në lidhje me vlerësimin e ofertave se kualifikimi i operatorëve është bërë bazuar në kriteret e kualifikimit mbi të cilat është bërë dhe kualifikimi i OE “V. SHPK”, për të cilin grupi i auditimit për shpalljen fitues të tij është bërë në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Servis dhe Pjesë Këmbimi” pretendohet nga observuesit se paraqiten argumentimet e aplikimit dhe përzgjedhjes së procedurës, specifikimeve teknike dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Devoll Naftë dhe Benzine”, nga observuesit janë paraqitur sqarime në lidhje me argumentimet e vendosjes së kriterëve të kualifikimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Bashkia Peqin, grupi i auditimit sqaron se; Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura rezulton se nuk është dërguar asnjë dokumentacion shtesë, fakte, prova apo referencë ligjore, të reja nga ato që janë paraqitur gjatë fazës së auditimit në terren dhe observacionet e paraqitura për Projektraportin janë thuajse të njëjta nga observacionet e paraqitura për akt konstatimet. Për disa nga pretendimet e paraqitura risqarojmë se këto argumentime duhet të ishin pjesë e dokumentacionit të procedurave përkatëse, gjithashtu duhet të ishin pjesë e dokumenteve të publikuara në Sistemin elektronik të

Prokurimeve, gjë e cila nuk është bërë nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit. Sa i përket pretendimit të observuesve në lidhje me kualifikimin e OE “V. SHPK”, sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur në asnjë rast për pretendimin e paraqitur në lidhje me kualifikimin e këtij OE. Për këto pretendime, grupi është shprehur në fazën e hartimit të Projekt raportit të auditimit si dhe gjatë fazës së auditimit në terren ku ka kërkuar dhe sqarimet përkatëse dhe ka bërë me dije pretenduesit për shkeljet e konstatuara. Nga sa më sipër grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë observacionet e paraqitura duke vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II”.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II”.		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 3753/7 prot., datë 19.11.2021.	2. Hartuesit e Dokumenteve të tenderit: nr. 3753/1 prot., datë 19.11.2021. 1. E.A. 2. T.S. 3. R.K.	3. Komisioni Vlerësimit Ofertave: Nr. 3753/8, datë 19.11.2021. 1. R.H., kryetar 2. F.Z., anëtar 3. M.H., anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur” Punë		
5. Fondi Limit: 47,802,971.60 lekë pa Tvsh	6. Oferta fituese: BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk me vlerë oferte 24,214,282.05 lekë pa Tvsh.	7. Diferenca me fondin limit: 23,588,689.55 lekë pa Tvsh
8. Data e hapjes së tenderit: 24.01.2022.	9. Burimi i Financimit: Nga të ardhurat e veta dhe granti i Ambasadës së Republikës së Bullgarisë.	10. Operatorët Ekonomikë a) Pjesëmarrës: 3 OE b) S’kualifikuar: 0 OE c) Kualifikuar: 1. BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk 2. BOE “B.” Shpk & “E.” Shpk 3. BOE “S.2F” & “K.” Shpk
11. Ankimime AK: Nuk ka	12. Përgjigje ankesës nga AK: Nuk ka	13. Përgjigje nga APP apo KPP: AK më datë 15.01.2022, është kryer mofikimi i DT sipas rekomandimeve të APP-së.
14. Lidhja e kontratës: Datë 08.04.2022.	15. Vlera e kontratës (me TVSH): 29,057,138.46 lekë	

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlogaritja e fondit limit:

Për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II”, janë siguruar fonde në vlerën totale 60,329,262 lekë si rezultat i bashkë financimit të Ambasadës së Republikës së Bullgarisë dhe Bashkisë Devoll (nga të ardhurat e veta) sipas marrëveshjes së financimit të datës 18.12.2018, dhe VKB nr. 79, datë 29.10.2021, “Për një ndryshime në tavanet buxhetore të shpenzimeve për vitet 2022-2024”. Në këtë VKB janë miratuar fondet sipas zërave sipas kategorive përkatëse për realizimin e objektit “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” si më poshtë:

- Hartimi i projektit në vlerën 2,065,088 lekë;
- Zbatimin i projektit në vlerën 57,363,566 lekë;
- Supervizim në vlerën 803,090 lekë;
- Kolaudim në vlerën 97,518 lekë.

Për realizimin e këtij projektit është kontraktuar OE “H.-C.” e cili ka hartuar:

- Projekti zbatimi;
- Preventivi i punimeve;
- Grafiku i punimeve;

- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Raporti teknik;
- Specifikimet teknike;
- Analiza e çmimeve.

Me Urdhrin nr. 3753/1 prot., datë 19.11.2021, të z. E.D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur Njësia e Prokurimit (NjP) e përbërë nga znj. E.A., znj. T.S. dhe z. R.K..

Me Urdhrin nr. 3753/7, datë 19.11.2021, të z. E.D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ka urdhëruar NjP për kryerjen e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa Tvsh me anë të llojit të procedurës “Procedurë e hapur-Punë”.

Hartimi i kriterëve të DT:

Me shkresën nr. 3753/9 prot., datë 23.12.2021, nga NjP është mbajtur procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Me shkresën nr. 3753/2 prot., datë 19.11.2021, nga NjP është mbajtur procesverbali për përlogaritjen e fondit limit.

Më datë 29.12.2021, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në SPE, në adresën elektronike AK Bashkia Devoll, rezulton se: Për procedurën me REF-16240-12-23-2021, me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik”, Bashkia Devoll me fond limit 47,802,971.60 lekë pa Tvsh, ka sugjeruar disa kriterë të DT që nuk janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Me shkresën nr. 3753/11 prot., datën 14.01.2022, nga NjP është mbajtur procesverbali për rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku është hartuar një shtojcë në dokumentet e tenderit, trajtuar gjerësisht në Projektraportin e Auditimit.

Titulli i gjetjes: Në lidhje me kriteret e vendosura, janë konstatuar kriterë jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës. AK në hartimin e DT, ka vendosur kriterë që nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në s’kualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme.

Situata: 1. Në pikën nr. 2.3.3. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori) stafin teknik të shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
Stafi kryesor i përfshirë në licensën e shoqërisë	
1 (një)	Inxhinier Ndërtimi
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik
1 (një)	Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Në lidhje me kërkesën për **Inxhinier Hidroteknik** duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme

ekspertiza profesionale e Inxhinierit Hidroteknik. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulohen nga Inxhinieri Hidroteknik. Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2. Në pikën nr. 2.3.3/a. Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

-1 (një) inxhinier nga stafi kryesor i përfshirë në liçensën e shoqërisë të disponojë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merrem masa për ndërprerjen e kontratës dhe deri në propozimin në Agjencinë e Prokurimit Publik për marrje masash ndaj operatorëve ekonomikë.

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si më poshtë:

- Kontratë individuale të punës;
- Diploma/çertifikata;
- Cv;
- Stafi kryesor i inxhinierëve-të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën shtator 2021-nëntor 2021;

Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieri dhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.3/a, është i paangazhuar në kontrata të tjera.

Duke qenë se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 45001-2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen më këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Në pikën nr. 2.3.4. Operatori/ët ekonomikë ofertues duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

- N.P-1. A, “Punime gërmimi në tokë”;
- N.P-4. B, “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaji, metro, pista aeroportuale”;
- NP-5 A, “Punime nëntokësore, ura e vepra arti”;
- N.P-7. A, “Ujësjellësa, gazsjellësa, vajësjellësa, vepra kullimi dhe vaditje”;

Punime speciale ndërtimi

- N.S-6. A, “Sinjalistika rrugore jo ndriçuese”;
- N.S-18 A, “Punime topogjeodezike”;

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s' kualifikues.

Në lidhje me këtë kriter duke marrë shkas nga punimet e përfshira në preventiv dhe objektin e prokurimit konstatohet se, zërat e kërkuar nuk parashikojnë llojet e përfshira në përkufizimin e kategorive të mëposhtme, të parashikuara në VKM nr. 42, datë 16.01.2018, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” konkretisht:

Liçensa N.P. 7: Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajësjiellësa, vepra kullimi dhe vaditje përfshin: “Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal”.

4. Në pikën nr. 2.3.5. Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit nr. 12/2, të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Ose/sipas VKM nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, ku parashikohet se, nëse punëdhënësit nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë, mund t'i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës e vlefshme;
- Diplomë;
- Urdhër mjeku;

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. (Në mbështetje të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, neni 12/1, operatorët ekonomik pjesëmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme).

Nuk ka element të kontratës që të bëjnë të jetë e nevojshme kërkesa për **mjek**. AK nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik t'i vërtetojnë se plotësojnë çdo detyrim që ata kanë për funksionimin e tyre si shoqëri private. AK duhet të kërkojë vetëm plotësimin e kriterëve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës. Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.,) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

5. Në pikën nr. 2.3.6. Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- **ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalente;**

- **ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalente;**
- **ISO 45001-2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente;**
- **ISO 39001-2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut) ose ekuivalente;**
- **PAS 99:2012 (Sistemi i integruar i menaxhimit) ose ekuivalente;**

Të gjitha certifikata e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Pranohen edhe standarde Shqiptare SSH/EN:SSH/ISO mbi konformitetin e standardit evropian apo atij ISO dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Nëse ofertuesi do të paraqitet si bashkim operatorësh, certifikatat ose ekuivalente duhet të jenë në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 9001-2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”** kjo certifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’ lidhje ka: “shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i Rruges Bilisht-Vernik Loti II”.

Kërkesa për **Çertifikatën ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”**, ekspertizat profesionale për mjedisin, në të gjitha kuptimet është ezauruar në procesin e studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të preventivit, specifikimeve teknike, projektit, relacioneve teknike respektive edhe raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në rastet kur është e nevojshme. Jemi në rastin e furnizimit me materiale inerte për realizimin e punimeve, dhe po të kishin ndikime në mjedis duhet të realizoheshin në fazën e projektit.

Mbështetur në tipologjinë e kontratës që prokurohet si dhe tipologjinë e punimeve ndërtimore për ekzekutimin e kontratës për disponimin e **Çertifikatës PAS 99-2012 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut”** dhe **Çertifikatës ISO 39001-2012 “Sistemi i integruar i menaxhimit”**, nuk përmbush përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 44, pika 3, ku përcaktohet që: “Çertifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”. Kriteri i vendosur nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohen, nuk kanë nxitur konkurrencë dhe krijon mundësi për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.

6. Në lidhje me pikën nr. 2.3.2. Një punësim mesatar për periudhën shator 2021-nëntor 2021, të paktën 45 (dyzet e pesë) personave të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar. Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhet për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje shtator 2021-nëntor 2021, tregon besueshmëri për autoritetin.

Pikën nr. 2.3.4. Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të kenë të punësuar si staf teknik punonjës nga të cilët të jenë:

- ✚ 2 (dy) teknik ndërtim;
- ✚ 7 (shtatë) karpentier;
- ✚ 8 (tetë) shoferë;
- ✚ 12 (dymbëdhjetë) manovratorë;

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup certifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë.
- Secili prej tyre duhet të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën shtator 2021-nëntor 2021 ose vetëm për manovratorët dhe shoferët OE mund ti disponojë edhe nëpërmjet kontraktimit.

Për Teknik të mesëm ndërtimi duhet të paraqiten edhe:

- Diploma ose dëshmi e përfundimit të kualifikimit përkatës.

Për manovratorët dhe shoferët të paraqitet edhe:

Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë e lëshuar nga DPSHTRR. Për shoferët, leja e drejtimit në përputhje me kategorinë e mjetit, lëshuar nga DPSHTRR.

Pikën nr. 2.3.7. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Rul me vibrim deri në 10.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Rul me gunga	Në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfalto shtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Fadromë me goma, kovë përpara dhe mbrapa	Në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Eskavator me zinxhirë me peshë nga 15-24 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavator me goma me peshë nga 15-24 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Automjet vijëzimi me bojë termoplastike me kapacitet jo më të vogël se 4.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
14	RTV-Transportier mjete të rënda	Në pronësi ose me qira	Copë 2

a) Të gjitha mjetet e mësipërm të jenë të regjistruar në regjistrat publikë dhe të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

Për mjetet në pronësi:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme);
2. Çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme);
3. Policë sigurimi (e vlefshme);
4. Çertifikatë “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vetë”, të lëshuar nga Bashkia në të cilën ushtron aktivitetin (e vlefshme);

Për mjetet me qira:

1. Kontrata përkatëse noteriale e qirasë, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
2. Leje qarkullimi (e vlefshme);
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme);
4. Policë sigurimi (e vlefshme)
5. Çertifikatë “Për transport mallrash brenda vendit për llogari në të tretë”, të lëshuar nga Bashkia në të cilën ushtron aktivitetin (e vlefshme);

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Nr.	Lloji i Makinerive/Pajisje	Përkatësia	Sasia
1	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Pajisje për spërkatje bitumi	Në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Matrapik-çekic hidraulik	Në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Betoniere	Në pronësi ose me qira	Copë 4
5	Freze asfalti	Në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Mini Fadromë (Bobcat ose ekuivalent)	Në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Armaturë	Në pronësi ose me qira	Mbi 300 m ²
9	Makineri për vijëzim rrugor	Në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Fabrikë Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore	Në pronësi/me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

a) Për mjetet dhe pajisjet e mësipërme që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e ç ‘doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet dhe pajisjet e siguruar me qira, që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e ç ‘doganimit ose faturat tatimore të blerjes, duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

c) Për fabrikën e asfaltobetonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/ç ‘doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe plan vendosja e instalimit të pajisjes për vend ndodhjen e saj. Nëse është marrë me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

d) Për fabrikën e asfaltobetonit, mbështetur në VKM nr. 628, datë 15.07.2015, “Për miratimin e rregullave teknike dhe ndërtimit të rrugëve”, nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk duhet që të kalojë më shumë se 2 orë, fabrika e asfaltit bazuar në vendimin e sipërcituar nuk duhet të jetë më larg se 70 km nga objekti i prokurimit.

e) Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM nr. 312, datë 05.05.2010, si më poshtë vijon:

-Kokore minimumi 50 copë;

-Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë;

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë;

f) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Në pikën 2.3.2, dhe 2.3.4, mbi kapacitetin teknik është vendosur kriteri se operatori duhet të ketë të deklaruar në listëpagesë **fuqinë punëtore të sipërpërmendur për një periudhë jo më pak se 3 muajore (shtator-nëntor 2021)** nga dita e hapjes së tenderit. Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë 3-mujore, është i pa nevojshëm, i pamështetur në kuadrin ligjor në fuqi mbi të cilin zhvillohet veprimtaria e prokurimit publik. Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Është e mjaftueshme listëpagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të kërkuar të punonjësve. Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë ndonjë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në të ardhmen nga njësia e prokurimit.

Në lidhje me kërkesën për disponibilitetin e mjetit **Transportier për mjete të rënda**, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ky mjet. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që do të realizohen nga mjeti transportier për mjete të rënda. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Si dhe referuar volumeve të punës të parashikuara në preventivin e punimeve, kërkesa për disponibilitetin e **dy Kamionëve me vinç** është e ekzagjeruar, pasi një mjet i till do të ishte i mjaftueshëm.

Për sa trajtuar më sipër, argumentimi i kryer nga NjP për pikën nr. 2.3.2, nr. 2.3.4, dhe nr. 2.3.7, nuk është i bazuar teknikisht dhe ligjërisht për arsye se, në to nuk pasqyrohet analiza e detajuar mbi kuadrin ndërmjet grafikut të punimeve, normës së punës së punëtorëve, profesionit të punëtorëve dhe mjeteve apo makinerive të punës për të përcaktuar nevojat reale për numrin/kapacitetin e fuqisë punëtore dhe mjeteve/makinerive të punës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma “b” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2, neni 7, pika 3, neni 40, pika 3, neni 78, pika 2.

7. Në pikën nr. 2.3.7/c. Për fabrikën e asfaltobetonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/ç’doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe plan vendosja e instalimit të pajisjes për vend ndodhjen e saj. Nëse është marrë me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij

prokurimi. Në lidhje me kriterin e mësipërm për sa i përket rastit të operatorëve ekonomikë që disponojnë kontratë furnizimi me fabrikë prodhimi asfalti konstatohet se ky kriter ose kërkesa për paraqitjen e **Lejes Mjedisore QKL Kodi III.B.1**, i përket personave të tretë konkretisht operatorëve ekonomikë të cilët nuk marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 1, neni 2, neni 21, pika 1, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39 dhe neni 78.

Ndikimi/Efekti: Kufizimi i pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit publik, duke ngushtuar konkurrencën, duke penguar pjesëmarrjen në prokurimi të kandidatëve ose ofertues që kanë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën.

Shkaku: Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK Bashkia Devoll, Njësia e Prokurimit, të marrin masa që në hartimin e DT, të shmangin aplikimin e kriterëve që nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

Konkluzion: Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, AK duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. E.A., znj. T.S. dhe z. R.K. në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

Vlerësimi i ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:

Me Urdhrin nr. 3753/8, datë 19.11.2021.2022, të z. E.D. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) i përbërë nga z. R.H. kryetar i komisionit dhe anëtarët z. F.Z., znj. M.H..

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 3753/13 prot., datë 24.01.2022, i hapjes së procedurës së prokurimit nga ku ka rezultuar se 3 operatorë ekonomik kanë marrë pjesë me vlera ekonomike përkatëse të ofertuara.

Procesverbali i mbajtur nga KVO me shkresën nr. 3753/14 prot., datë 27.01.2022, mbi zhvillimin dhe vlerësimin e ofertave për vlerësimin e ofertave, për vlerësimin e dokumentacioneve të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë kualifikuar 3 operatorë ekonomikë, është shpallur si oferta më e favorshme dhe që plotëson gjithë kriteret e DT ajo e paraqitur nga BOE “A. II” Shpk & “N.” Shpk (Gjithashtu BOE “A. II” Shpk & “N.” Shpk me shkresën nr. 429 prot., datë 27.01.2022, ka paraqitur argumentimin mbi ofertën më të ulët).

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk me vlerë ekonomike të ofertës 24,214,282.05 lekë pa Tvsh.

2. BOE “B.” Shpk & “E.” Shpk me vlerë ekonomike të ofertës 35,665,193 lekë pa Tvsh.

3. BOE “S.2F” & “K.” Shpk me vlerë ekonomike të ofertës 36,666,666 lekë pa Tvsh.

Me shkresën nr. 3753/12 prot., datë 24.01.2022, nga KVO është mbajtur Raporti Përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e Titullarit të AK. Me shkresën nr. 3753/17 prot., datë 01.03.2022, Kryetari i Bashkisë ka miratuar Raportin Përmbledhës. Me shkresën nr. 3753/15 prot., datë 21.02.2022, është mbajtur formulari i njoftimit të fituesit si oferta më e suksesshme e BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk.

Titulli i gjetjes: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE “A. II” Shpk & “N.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Situata: 1. Në pikën nr. 2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, për vitin 2021.

Nga OE “N.” Shpk nuk janë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gjirokastrë, referuar likuidimeve të kontratave të kryera nga Dega e Thesarit Gjirokastrë ndërkohë që ka ushtruar aktivitetet në këtë qytet sipas kontratave si më poshtë:

-Kontrata me nr. 384 prot., datë 29.12.2020, me objekt “Mirëmbajtja e rrugës Unaza Korçë-Ersekë-Boboshticë-Dardhë”, institucioni Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë. Fatura tatimore nr. 71/2021, datë 31.12.2021, në vlerën 3,834,236 lekë regjistruar më datë 31.12.2021, dhe likuiduar më datë 12.01.2022, nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

-Kontrata me nr. 384 prot., datë 29.12.2020 me objekt “Mirëmbajtja e rrugës Unaza Korçë-Ersekë-Boboshticë-Dardhë”, institucioni Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë. Fatura tatimore nr. 54/2021, datë 08.12.2021, në vlerën 53,604,518 lekë regjistruar më datë 29.12.2021, dhe likuiduar më datë 30.12.2021, nga Dega e Thesarit Gjirokastrë.

2. Në pikën nr. 2.3.7. Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-20 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Grejder	Në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Rul me vibrim deri në 10.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Rul me gunga	Në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Autobitumatriçe	Në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfalto shtruese	Në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Fadromë me goma, kovë përpara dhe mbrapa	Në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Eskavator me zinxhirë me peshë nga 15-24 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavator me goma me peshë nga 15-24 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Automjet vijëzimi me bojë termoplastike me kapacitet jo më të vogël se 4.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 1
14	RTV-Transportier mjete të rënda	Në pronësi ose me qira	Copë 2

a) Të gjitha mjetet e mësipërme të jenë të regjistruar në regjistrat publikë dhe të paraqiten dokumentat e mëposhtme:

Për mjetet në pronësi:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme);
2. Çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme);
3. Policë sigurimi (e vlefshme);
4. Çertifikatë “Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vetë”, të lëshuar nga Bashkia në të cilën ushtron aktivitetin (e vlefshme);

Për mjetet me qira:

1. Kontrata përkatëse noteriale e qirasë, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
2. Leje qarkullimi (e vlefshme);
3. Çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme);
4. Policë sigurimi (e vlefshme);
5. Çertifikatë “Për transport mallrash brenda vendit për llogari në të tretë”, të lëshuar nga Bashkia në të cilën ushtron aktivitetin (e vlefshme);

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Nr.	Lloji i Makinerive/Pajisje	Përkatësia	Sasia
1	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Pajisje për spërkatje bitumi	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Matrapik-çekic hidraulik	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
5	Freze asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Mini Fadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Armaturë	në pronësi ose me qira	Mbi 300 m ²
9	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Fabrikë Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore	në pronësi/me qira ose kontratë furnizimi	Copë 1

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

- a) Për mjetet dhe pajisjet e mësipërme që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet dhe pajisjet e siguruara me qira, që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes, duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për fabrikën e asfaltobetonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/ç’doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe plan vendosja e instalimit të pajisjes për vend ndodhjen e saj. Nëse është marrë me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- d) Për fabrikën e asfaltobetonit, mbështetur në VKM nr. 628, datë 15.07.2015, “Për miratimin e rregullave teknike dhe ndërtimit të rrugëve”, nga koha e prodhimit, transportit, shtrimit nuk

duhet që të kalojë më shumë se 2 orë, fabrika e asfaltit bazuar në vendimin e sipërcituar nuk duhet të jetë më larg se 70 km nga objekti i prokurimit.

e) Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM nr. 312, datë 05.05.2010, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 50 copë;

- Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 copë;

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë;

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 copë;

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë;

f) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

a) Më datën 10.01.2022, ndërmjet Shoqërisë “V.” përfaqësuar nga administratori z. G.A. dhe OE “A.” Shpk përfaqësuar nga administratori z. E.Z. është lidhur kontrata e qirasë për marrjen me qira: 1 Rul me gunga e markës Dynapac tipi C. seria 61410541; 1 Rul ngjeshës me goma Bomag tipi BË16R e vitit 1998; 1 Kamion me vinç me targë A. dhe numër shasje ËJMB1VMT00C035207 dhe 1 Kamion me targë K. dhe numër shasje ËDB9523141K578794. Kontrata e sipërpërmendur është nënshkruar sipas vërtetimit noterial me nr. 42 Rep., dhe Kol., nr. 24, datë 10.01.2022.

- Për mjetin Kamion me targë K. dhe numër shasje ËDB9523141K578794 i cili i përket kontratës të sipërpërmendur, dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

- Për mjetin Kamion me vinç me targë A. dhe numër shasje ËJMB1VMT00C035207 i cili i përket kontratës të sipërpërmendur, dokumentacioni shoqërues për këtë mjet nuk është i plotë konkretisht, çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

b) Nga OE “A.” Shpk nuk është publikuar dokumentacion në SPE për mjetin autobot uji por në vend të tij mjeti Kamion i markës Iveco me targë D. dhe numër shasje ËJMD1RGSM09015769. Bashkëlidhur dokumentacionit të pronësisë së këtij mjeti ndodhet edhe fatura tatimore nr. 3, datë 14.01.2016, që ka si objekt blerjes një depozitë uji në vlerën 30,000 lekë nga shitësi OE “K.” Shpk, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Kapitulli III “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë”, neni 41, ku përcaktohet që: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”.

c) Për mjetin Eskavator me goma me numër shasje CGG021674, është kryer blerja e tij sipas kontratës nr. 2083 Rep., dhe nr. 1829 Kol., datë 27.04.2017, të lidhur ndërmjet personit fizik z. S.Xh. përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 774 Rep., dhe nr. 259 Kol., datë 22.05.2022, dhe OE “N.” Shpk me përfaqësues z. A.L. Referuar dokumentacionit të publikuar në SPE nga OE “N.” Shpk, mjeti Eskavator me goma nuk është i regjistruar në regjistrat publikë dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe

siguracionin e mjetit, por vetëm deklaratën/vërtetimin e zhdoganimit të datës 06.12.2012, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dogana Durrës, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, ku përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”.

Për sa trajtuar më sipër BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të vendosura në DT dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO por duhet të ishte s’kualifikuar. KVO nuk duhet t’i kishte propozuar Titullarit të AK të shpallte fitues BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SPE i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për s’kualifikimin e BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk, dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk. Sa më sipër KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 3, “Parimet të përgjithshme”, neni 98 “Anulimi i një procedure prokurimi”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 2, neni 67 “Klasifikimi i ofertave” pika 2, neni 83 “Njoftimi i fituesit”.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Ndikimi/Efekti: Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **24,214,282.05 lekë pa Tvsh.**

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP. Duke shpallur fitues **BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk**, i cili nuk plotëson kriteret e DT, është shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **24,214,282.05 lekë pa Tvsh.**

Konkluzioni: Procedura paraqitet me probleme si në aplikimin e kriterëve, ku evidentohet kriterë jo në përputhjen me procedurën dhe tipologjinë e saj, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e procedurës, si dhe në shpalljen fitues të BOE “A.” Shpk & “N.” Shpk, pasi nuk është në kushtet e plotësimit të gjitha kriterëve të DT, veprime në paligjshmëri të dispozitave të LPP, ku KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizuese, për një përdormi më efektin të fondit për vlerën **24,214,282.05 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.D. Kryetar i Bashkisë Devoll në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, **znj. E.A., znj. T.S., z. R.K.** në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe **z. R.H., z. F.Z., znj. M.H.** në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për sa është trajtuar në Akt Konstatimin nr. 8, datë 30.11.2022, dhe në Projekt Raportin e Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Devoll është paraqitur observacioni me shkresë nr. 257/1/8 prot., datë 24.01.2024, administruar në KLSH praktikën nr. 868/5 datë 26.01.2024, nga **Znj. E.A., znj. T.S.** anëtarë të Njesisë së Prokurimit dhe **z. R.H., znj. M.H.** anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

1. Pretendimi i subjektit: Për sa i përket gjetjes nr. 1, mbi kriterin Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori) stafin teknik të

shoqërisë, si më poshtë:

Numri	Pozicioni
Stafi Kryesor i përfshirë në liçensën e shoqërisë	
1 (një)	Inxhinier Ndërtimi
1 (një)	Inxhinier Hidroteknik
1 (një)	Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik

a. Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ çertifikuar si:

- 1 (Një) Inxhinier nga Stafi Kryesor i përfshirë në liçensën e shoqërisë të disponojnë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Ju paraqesim kontestimet tona si më poshtë: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Për inxhinierët e mësipërm që operatorët duhet të paraqesin në listëpagesa duhet të përmbushin këto detyra që janë parësore për kryerjen e punimeve dhe përfundimin me sukses të objektit.

•1 (një) inxhinier Hidroteknik për shtrimin e tubacioneve të kanalizimeve të ndryshme në objekt cilësohet si e nevojshme prania e një inxhinieri hidroteknik për zbatimin e projektit me cilësi, dhe mirëfunksionimin e tij. Ai do ketë parasysh edhe linjat ekzistuese që mund të preken gjatë gërmimeve dhe zgjidhjen e tyre të menjëhershme për të mos krijuar shqetësime tek banorët që preken.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në opinion e grupit të auditimit për të vendosur 14ml tombino Ø 600, mbi shtresë betoni nuk nevojitet Inxhinier Hidroteknik, do të mjaftonte një Inxhinier Ndërtimi aq më tepër kur është kërkuar edhe Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik.

2. Pretendimi i subjektit: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (Një) inxhinier që të disponojnë çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplomë/çertifikatë.

Numri i inxhinierëve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje Shtator 2021-Nëntor 2021, tregon besueshmëri për autoritetin se OE kanë stabilitetin e duhur në staf për zbatimin me sukses të kontratës dhe mos krijimin e problemeve të ndryshme që mund të dalin gjatë zbatimit të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinierët dhe punonjësit e kërkuar në pikën 2.3.3/a, janë të paangazhuar në kontrata të tjera.

Kriteri për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është vendosur në mbështetje të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe të VKM nr. 312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit gjykon se për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve

që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për ndihmën e parë dhe ndërhyrjet ndaj emergjencave dhe ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Kërkesa për diskonim “Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë” është e dubluar dhe konsiderohet e tepërt. Në DT është parashikuar edhe kërkesa që subjekti duhet të jetë i pajisur me çertifikatën OHSAS 18001- 2007/2013 ose ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalente (e vlefshme), konsiderohet e tepërt kjo kërkesë pasi çertifikata në vetvete është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë. Shoqëritë që pajisen me këtë çertifikatë duhet të plotësojnë kriteret përkatëse të cilat janë konsideruar të nevojshme nga institucionet çertifikuese ndaj dhe kjo çertifikatë i jep garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

3. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.3.4 Të DT: 2.4 Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të disponojnë liçensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

➤ **N.P 7. A Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajësjiellësa, vepra kullimi dhe vaditje.**

Ju paraqesim kontestimet tona sa më poshtë:

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. NP-7 A. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin e shërbimit hidrik kompleks” dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjiellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Janë parashikuar në preventiv punime për veprat kulluese, ndërtimi i kanaleve anësore dhe tombino.

Gërmim me makineri, toke zakonshme kategoria III m (Për kanalet)

Struktura monolite betoni C 16/20 (Beton për pusetë dhe portal)

Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtresë betoni

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në opinion e grupit të auditimit për të vendosur 14ml tombino Ø 600, mbishtresë betoni nuk nevojitet Liçensa N.P 7. A “Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajësjiellësa, vepra kullimi dhe vaditje”. Mjafton e tepron Liçensa NP 5 A “Punime nëntokësore, ura e vepra arti e cila është e shoqëruar edhe me Liçensën N.S 18 A “Punime topogjeodezike”.

4. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.3.5, sipas DT Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, Ose/sipas VKM nr. 108, datë 09.02.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, ku parashikohet se, nëse punëdhënësit nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë, mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Ju paraqesim kontestimet tona sa më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar i cili përcakton: “2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike dhe “12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës. Mjeku i ndërmarrjes ofron këshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson çështje të fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar një numër prej 45 punonjësish për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Rrjedhimisht kërkesa e AK që OE të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm, është në përputhje me nenin 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Organizimi i shërbimit mjekësor nga operatorët ekonomik është një çështje që ju përket atyre dhe organeve të tjera kontrolluese të këtij elementi (Inspektorati i Punës etj.) dhe jo çështje e verifikimit nga autoritetit kontraktor, përderisa mjeku nuk lidhet me natyrën e kontratës, që do të thotë me elementët e punimeve të preventivit.

5. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.3.6 të DT: Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatat të vlefshme si më poshtë:

- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë), ose ekuivalente
- ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit), ose ekuivalente
- ISO 45001-2018, (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë), ose ekuivalente
- ISO 39001 -2012 (Sistem i menaxhimit të sigurisë rrugore dhe trafikut), ose ekuivalente
- PAS 99:2012 (Sistemi i integruar i menaxhimit) ose ekuivalente

Ju paraqesim kontestimet tona sa më poshtë:

Për ISO 9001-2015; kjo certifikatë specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore.

Për ISO 14001-2015: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO 14001-2015, standard ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

-Standardet e Sistemit të Menaxhimit që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë,

-Standardet Operative që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe

-Standardet e Sistemit të Mjedisit që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet.

Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

Për ISO OHSAS 39001-2012: Ky Standard përcakton kërkesat minimale për një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor. Ky lloj standardi konsiston në sigurimin e një sistemi të sigurt të trafikut rrugor gjatë zbatimit të punimeve.

Për PASS 99-2012 Kjo certifikatë është një specifike publike me qëllim të ndihmojë shoqëritë të integrojnë sa më shumë sisteme të menaxhimit të implementuar. Përdorimi i PAS 99 ka si qëllim rritjen e efikasitetit dhe plotësimin e të gjitha kërkesave për standardet përfshirëse referuar planifikimit, implementimit dhe operimit të një sistemi menaxhimi integral por dhe duke patur parasysh monitorimin dhe përmirësimin e performancës në organizim.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Është detyra e NJP të arsyetojë domosdoshmërinë e nevojës së certifikatave respektive për realizimin e kontratës:

Për shembull: Ju e keni detyrimin ligjor që të provoni domosdoshmërinë për realizimit të punimeve të kontratës për certifikatat e kërkuara:

1. Certifikata ISO 9001:2015, shërben për: Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e godinave civile dhe industriale, mbikalime, nënkalime, ura, rrugë, autostrada, diga, kullë kontrolli ajror, impiante të brendshme elektrike dhe të telekomunikacionit. Rrjete të furnizimit me ujë dhe sistemi i kanalizimeve, rrjet i fibrës optike, impiant i pastrimit të ujërave të zeza, Hidrocentrale, vepra kullimi dhe vaditje, mbrojtja nga gërryerjet. Rehabilitim porti, sinjalistikës rrugore, N/stacione elektrike, kabina, punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë dhe zgjatim fideri, trase hekurudhore punime të inxhinierisë së mjedisit, krijim dhe mirëmbajtje e hapësirave të gjelbra në zona private dhe publike.

2. Certifikatën ISO 14001:2015 shërben për: Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e godinave civile dhe industriale, mbikalime, nënkalime, ura, rrugë, autostrada, diga, kullë kontrolli ajror, impiante të brendshme elektrike dhe të telekomunikacionit, rrjete të furnizimit me ujë dhe sistemi i kanalizimeve, rrjet i fibrës optike, impianti pastrimit të ujërave të zeza, hidrocentrale, vepra kullimi dhe vaditje, mbrojtja nga gërryerjet. Rehabilitim porti, sinjalistikës rrugore, n/stacione elektrike, kabina, punime elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të tensionit të ulët, mesëm dhe të lartë dhe zgjatim fideri, trase hekurudhore punime të inxhinierisë së mjedisit, krijim dhe mirëmbajtje e hapësirave të gjelbra në zona private dhe publike.

3. Certifikatën ISO 39001:2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor), që shërben për: Aktivitete që gjenerojnë trafik nga dhe drejt vendeve të kontrolluara ose të ndikuar nga organizata. Ofrimi shërbimeve dhe produkteve për sistemin e trafikut rrugor, menaxhimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, e mjeteve dhe produkteve të ngjashme.

4. Certifikimi i PAS 99 konfirmon faktin që shoqëria ka një qasje të saktë ndaj zhvillimit dhe zbatimit të sistemit të saj të menaxhimit të integruar.

OE duhet të tregojë aftësinë e tij vetëm në zbatim të projekt preventiv të zbatimit, specifikimeve teknike dhe kushteve të kontratës. Kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synimin të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore nuk janë të nevojshme për realizimin e kontratës.

OE në një procedurë prokurimi, në zbatim të Pikës 1, neni 108, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ku citohet: “Mos përmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 78, të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i afatit të zbatimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë”.

6. Pretendimi i subjektit: 2.3.7 Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe numri i tyre është përcaktuar bazuar në grafikun e punimeve, preventivin dhe orët e punës që duhen për të përmbushur kontratën.

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 7.5-20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçine me kapacitet mbajtës deri në 1.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Rul me vibrim deri në 10.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Rul me gunga	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfalto shtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Fadrome me goma, kovë përpara dhe mbrapa	në pronësi ose me qira	Copë 2
11	Eskavator me zinxhirë me peshë nga 15-24 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Eskavator me goma me peshë nga 15-24 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Automjet vijëzimi me bojë termoplastike me kapacitet jo më të vogël se 4.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	RTV-Transportier mjete të rënda	në pronësi ose me qira	Copë 2

Ju paraqesim kontestimet tona sa më poshtë:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për makineritë dhe mjetet e punës, lloji dhe funksioni i tyre është përcaktuar në bazë të analizës

së punimeve për çdo zë ndërsa numri është përcaktuar nga orët që duhet të kryejë secila prej tyre për afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve. Gjithashtu si specialistë që njohim zonën, është e nevojshme të vendoset kriteri i mjeteve të specifikuara pasi do punohet në zona të ngushta dhe për të mos dëmtuar objekte apo asfaltet ekzistuese, është vendosur edhe përdorimi i eskavatorëve me goma dhe i transportiereve të mjeteve të rënda.

Tonazhi i rulave përcaktohet në specifikimet teknike për ngjeshjen e asfalteve dhe nënshtresave me trashësi specifike sipas projektit për të arritur cilësinë e punimeve.

Para-kontratat apo pronësitë e impianteve të betoneve apo asfalteve risin kredibilitetin e Autoritetit Kontraktor kundrejt operatorit ekonomik që kjo kontratë do të finalizohet me sukses dhe nuk do të dështojë në faza të ndryshme të ndërtimit, çka përbën risk për AK.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në lidhje me kërkesën për disponibilitetin e mjetit Transportier për mjete të rënda, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), nuk është parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ky mjet. Referuar volumeve të punës të parashikuara në preventivin e punimeve, kërkesa për disponibilitetin e dy Kamionave me vinç është e ekzagjeruar, pasi një mjet i till do të ishte i mjaftueshëm.

7. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.3.7.c Të DT: Për fabriken e asfaltobetonit, nëse është në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes/çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, si dhe plan vendosja e instalimit të pajisjes për vendndodhjen e saj. Nëse është marrë me qira/furnizim krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit, ku të jetë i përcaktuar objekti i këtij prokurimi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Kriter për të cilin ju konstatoni se kërkesa për paraqitjen e lejes mjedisore në rastin e kontratës furnizimit i përket personave të tretë të cilët nuk janë pjesë e procedurës së prokurimit.

Ju paraqesim kontestimet tona sa më poshtë:

Sqarojmë se AK ka mirë argumentuar kërkesat e këtij kriteri themelor në këtë procedurë në përputhje me përcaktimet e rregullave të prokurimit publik si dhe duke garantuar një marrëdhënie ligjore në rast se nga OE ofertues këtë furnizim e siguron me qira ose kontratë furnizimi.

AK ka arsyetuar me objektivitet në përcaktimin e dokumentave të kërkuara dhe lejeve mjedisore pasi nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë dhe të lejes mjedisore, poseduesi i fabrikës të asfaltobetonit vërteton dhe identifikohet se ushtron aktivitet të ligjshëm për t'i ofruar shërbimin e kërkuar nga ofertues të mundshme në këtë procedurë prokurimi si dhe garancia e AK për të përmbushur me sukses kontratën në rast shpallje fituesi.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit në këtë fazë shmang rrezikun, koston financiare dhe efektet negative në rast se gjatë zbatimit të kontratës do të rezultonte se furnizuesi i asfaltobetonit ushtron aktivitetin në kundërshtim me ligjin dhe nuk ofron furnizimin. Kostot dhe efektet për OE ekonomike pjesëmarrës dhe për furnizuesit në fazën e njoftimit të kontratës janë minimale dhe nuk pengojnë konkurrencën e OE përsa kohë që palët paraqiten para dhomës noteriale për të noterizuar kontratën e furnizimit e cila rrjedhimisht duhet të jetë e pajisur me dokumentacionin i cili vërteton ushtrimin e aktivitetit të asfaltobetonit.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në lidhje me kriterin e mësipërm për sa i përket rastit të operatorëve ekonomikë që disponojnë kontratë furnizimi me fabrikë prodhimi asfalti konstatohet se ky kriter ose kërkesa për paraqitjen e Lejes Mjedisore QKL Kodi III.B.1, i përket personave të tretë konkretisht operatorëve ekonomikë të cilët nuk marrin pjesë në këtë procedurë

prokurimi.

8. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjet e grupit të auditit KLSH-së BOE “A. II” Shpk & “N.” Shpk i shpallur fitues i kësaj procedure prokurimi është në kushtet e mosplotësimit të gjithë kriterëve të DST, sqarojmë se:

1. Kërkesat në DST për pikën 2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, për vitin 2021. Sipas Pikës 2.2.3 të DST janë kërkuar taksat vendore ku operatori ekonomik zhvillon veprimtarinë e tij. KVO ka identifikuar të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku OE “N.” Shpk ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij duke u mbështetur në dokumenta zyrtare nga ku rrjedhin detyrimet e operatorëve ekonomike që është ekstrakti i thjeshtë dhe historik i operatorit ekonomik lëshuar nga QKB. ku OE “N.” Shpk vërteton se i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021, referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri

1- Korçë Qendër Bilisht Bitincke Autostrada Bilisht Korçë, Km. i 3, Bitincke. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit nuk ka. Konkluzioni OE “N.” Shpk ka paraqitur dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2021, referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB).

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Ju në lidhje mbi shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore ju bëjmë me dije se, në kriter është e përcaktuar qartë se: **“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor, për vitin 2021”**, referuar pagesave sipas kontratave përkatëse të kryera nga Dega e Thesarit Gjirokastër, OE “N.” Shpk ka pasur aktivitet në këtë qytet pavarësisht se nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj Bashkisë Gjirokastër.

9. Pretendimi i subjektit: 2. Kërkesat në DST për pikën 2.3.7 Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të disponojë dhe paraqesë numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira/kontratë furnizimi: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

-Në lidhje me gjetjet e grupit të auditit KLSH pika a.

Ju sqarojmë se për mjetet kamion me targa K. dhe A. të cilët janë marrë me qira nga operatori ekonomik “A. II” dhe nuk disponojnë certifikatë për transport mallrash për të tretë, KVO këto dy mjetë nuk i ka marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ngarkuar në SPE. Por KVO, nga ana tjetër në vlerësimin e dokumentave teknik që disponojnë operatorët ekonomikë, shqyrton të gjithë dokumentacionin në tërësi të ngarkuar në sistem nga OE.

Kriteri sipas pikës 2.3.7 të DST plotësohet nga OE i sqaruar si më poshtë:

Kriteri për Kamion mbajtës 7.5-20 ton copë 4, përmbushet nga OE nga mjetet me targa:

1. D., 2. A., 3. A., 4. A.

Kriteri për Kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 5 ton copë 2, përmbushet nga OE nga mjetet me targa:

1. A. si dhe mjeti 2. D. që sipas dokumentave teknike është kamion me vinç dhe vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 5 ton. Ky fakt është pasqyruar edhe në gjetjet e KLSH ku citohet se për

mjetin autobot uji është publikuar kamioni i markës Iveco me targë D. i cili nuk ka dokumentacionin përkatës për të kryer funksionin e autobotit te ujit.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Ne i referohemi të dhënave të publikuara në SPE konkretisht deklarata e OE “A.” Shpk për disponibilitetin e një Autoboti uji është paraqitur dokumentacioni për mjetin Kamion Iveco me targë D. së bashku me faturën tatimore nr. 3, datë 14.01.2016, që ka si objekt blerjes një depozitë uji në vlerën 30,000 lekë, për të cilin dokumentacioni i këtij mjeti nuk mund të përdoret si argument për plotësimin e kërkesave për kamionët e tjerë që kërkohen në DT. Në këtë deklaratë OE “A.” Shpk disponon një Kamion me targë K dhe një Kamion me vinç me targë A. sipas kontratave përkatëse të qirasë, për të cilat çertifikata për transport mallrash është për llogari të vet dhe jo për të tretë duke marrë në konsideratë faktin që kjo është kontratë qiraje dhe OE i shpallur fitues nuk e disponon vet si mjet.

10. Pretendimi i subjektit: Në lidhje me gjetjet e grupit të auditit KLSH pika b.

Ju sqarojmë se bashkëlidhur dokumentave të mjetit D. ndodhet edhe fatura tatimore nr. 3, datë 14.01.2016, që ka si objekt blerje të një depozitë uji nga operatori ekonomik OE “A. II” Shpk. Nisur nga ky fakt si dhe duke pasur parasysh mirë menaxhimin e fondeve publike nga AK, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, KVO vlerëson se kjo pajisje i shërben funksionit për të cilën është kërkuar në DST dhe nuk është kusht për s’kualifikimin e operatorit ekonomik.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Në DT kërkohet Autobot uji dhe jo një mjet ekuivalent apo i modifikuar që mund të kryejë funksion të ngjashëm me Autobotin e ujit.

11. Pretendimi i subjektit: -Në lidhje me gjetjet e grupit të auditit KLSH pika c.

Ju sqarojmë se për mjetin ekskavator me goma ne numër shasie CGG02167 disponohet vetëm kontrata e shitjes dhe vërtetimi i zhdoganimit pasi nuk është i regjistruar në regjistrat publike dhe nuk disponon çertifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Në pikën 2.3.7 gërma b të DST përcaktohet se:

a) Për mjetet dhe pajisjet e mësipërme që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Pra ky mjet kategorizohet si makinë teknologjike që duhet të regjistrohet në regjistrat publike nëse do të qarkullojë në rrugë publike. AK ka kërkuar mjete dhe makina teknologjike që do të kenë funksione të ndryshme në zbatim të objektit të prokurimit dhe sqarojmë se ekskavatorët kanë funksion të instalohen brenda kantierin e ndërtimit dhe jo të qarkullojnë në rrugë publike, dhe për sa i përket transportit të tyre deri në kantierin e ndërtimit janë kërkuar transportierë që do të kryejnë zhvendosjen e këtyre mjeteve.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH-së: Për sa i përket pajisjes me dokumentacion regjistrimin mjeti ekskavator, pronësie, leje qarkullimi, policë sigurimi dhe kontroll teknik është detyrim ligjor në zbatim të Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 58 “Makinat teknologjike” dhe neni 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike”, ku përcaktohet që: “Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit”. Kjo situatë konfirmohet edhe për faktin që mjetin tjetër ekskavator (duke marrë në

konsideratë kriterin që kërkohen 2 ekskavator) OE e ka me të gjithë dokumentacionin e sipërpërmendur.

Për sa trajtuar më sipër observacioni Juaj lidhur me këtë çështje është i pa bazuar në prova dhe në fakte ligjore dhe si i tillë nuk merret në konsideratë në hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

Mbi auditimin e procedurave të prokurimit vlerje me vlera të vogla.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të prokurimit vlerje me vlera të vogla u konstatua:

Titulli i gjetjes: Parregullsi në zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla.

Situata: Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, në total janë realizuar 39 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 18,888,395 lekë pa Tvsh dhe me vlerë realizimi kontrate 15,555,619 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje janë audituar në total 9 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 6,052,869 lekë pa tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 5,330,065 lekë pa tvsh ose në masën 32% e vlerës së fondit limit ku konstatohet se:

-Në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit konkretisht:

a. Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,375,000 lekë pa Tvsh, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht: 1. Procedura me objekt “Blerje aksesore të detyrës dhe dritareve” zhvilluar në muajin dhjetor me fond limit 500,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 451,400 lekë pa Tvsh dhe 2. procedura me objekt “Blerje detyrës dhe dritare” zhvilluar në muajin tetor me fond limit 875,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 722,620 lekë pa Tvsh.

b. Në 2 procedura në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,270,380 lekë pa Tvsh, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi konkretisht: 1. Procedura me objekt “Blerje uniforma zjarr-fikësish”, zhvilluar në muajin nëntor me fond limit 895,380 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 880,000 lekë pa Tvsh dhe 2. Procedura me objekt “Blerje uniforma policie” zhvilluar në muajin tetor me fond limit 375,000 lekë pa Tvsh dhe vlerë kontrate 323,100 lekë pa Tvsh. Si rezultat i copëzimit dhe përpjestimit të vlerave të kontratave dhe fondeve të tyre, kanë sjellë për pasojë shmangie nga procedurat standarde të prokurimit.

-Në 10 raste në SPE është publikuar ftesa për ofertë në të cilën janë përfshirë specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim. Në këtë dokument konstatohet se nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk janë argumentuar kriteret e veçanta për kualifikim;

-Në 2 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla në ftesën për ofertë janë konstatuar kritere jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çenojnë pjesëmarrjen e operatorë ekonomikë konkretisht çertifikata ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë”. Kjo çertifikatë në të gjithë “argumentimin” nuk ka asnjë komponent që të sigurojë AK për realizimin e kontratës. Nuk ka asnjë bazë tekniko/ligjore se ç’lidhje ka: “shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve”, me realizimin e kontratës me objekt: “Blerje PC” me fond limit 826,192 lekë pa Tvsh “Uniforma zjarrëfiksi” me fond limit 890,700 lekë pa Tvsh.

-Në 4 raste në SPE nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë) pra kalimi nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s’kualifikimit të tyre për procedurën “Uniforma zjarrëfiksi” me fond limit 890,700 lekë pa Tvsh, “Blerje Materiale elektrike” me fond limit

828,850 lekë pa Tvsh, “Rikualifikim i terreneve të shkollës Proger” me fond limit 706,374.77 lekë pa Tvsh dhe “Veshmbathje për fëmijët me kushte të vështira social-ekonomike” me fond limit 498,819 lekë pa Tvsh.

-Në 3 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë për procedurën “Blerje PC” me fond limit 826,192 lekë pa Tvsh, “Uniforma zjarrëfiksi” me fond limit 890,700 lekë pa Tvsh dhe “Blerje Materiale elektrike” me fond limit 828,850 lekë pa Tvsh;

-Në 3 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Devoll në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 34, pikat 2-3, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pasgesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, dhe Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 3 dhe pikat 11-13.

Ndikimi/Efekti: Parregullsi në zhvillimin e procedurave.

Shkaku: Kjo situatë vjen si pasojë e mos respektimit të legjislacionit përkatës në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrat të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim.

-Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo skualifikimit të tyre.

-Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.B., znj. K.B. në cilësinë e Komisionit të Prokurimeve me Vlera të Vogla, **znj. M.H. me detyrë Përgjegjës** i Sektorit të Menaxhimit Financiar për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, **z. M.H., znj. E.N., z.V.Q., z. G.XH., z. A.M., z. G.K., z. E.L. dhe z. J.S. në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Marrjes së Mallrave në Dorëzim.**

4.4 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

1. Për objektin **“Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) *Dosja teknike e zbatimit:*

- *Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Devoll dhe BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK., me Nr.3322Prot. datë 10.11.2020.*
- *Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);*
- *Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;*

- *Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;*
- 2) *Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK., me Nr.3666/1 Prot. datë 14.12.2020.*
- *Korrespondencat mes Bashkisë Devoll dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “E.-G” ShPK.*

Kontratat.

Punimet kryhen sipas kontratës Nr. 21, për punë publike, me Nr.3322Prot. datë 10.11.2020 me objekt *“Ujësjetllësi i Fshatit Hociisht, Bashkia Devoll”* të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, të përfaqësuar nga Titullari z. E.D. dhe BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK me Nr.3322Prot. datë 10.01.2020 me përfaqësues z. A.Z. dhe z. P.N. me licenca profesionale NZ.7845/3 & NZ.2275/19. Vlera e kontratës është 66,284,231 lekë pa TVSH ose 79,541,080.92 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga data kur fillon zbatimi i saj. Afati i përfundimit të kontratës është ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.1169Prot. datë 05.04.2022, referuar nenit 38 të kontratës fillestare nr.21, duke përcaktuar si datë për përfundimin e tyre 13.04.2022. Arsyeja e ndryshimit të përfundimit të punimeve ka ardhur si rezultat i kushteve klimaterike të pa favorshme për realizimin e tyre.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.29 me Nr.3666/1Prot. datë 14.12.2020 me OE “E.-G” ShPK, me përfaqësues G.I., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1015/14, si dhe me vlerë të kontratës 1,153,345.67 lekë pa TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.12 me Nr.2192/12Prot. datë 06.07.2022 me OE “N.S.” ShPK me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1846/7 dhe me vlerë të kontratës 206,673.51 lekë me TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga OE “A.-S.” ShPK. Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohet linja e rrjetit të jashtëm nga kaptazhi deri tek depoja me gjatësi 5000 m dhe tub PE d=160 mm t=17.9 mm PN 20. Ndërtimi i rrjetit të brendshëm me tuba PE të madhësisë d=15 mm deri d=125 mm me presion PN 10 së bashku me rakorderitë përkatëse. Ndërtim rezervuari me madhësi 100 m³ si dhe hidroizolim i rezervuarit ekzistues me emulsion bitumi me dy shtresa katrama. Gjithashtu janë parashikuar të ndërtohen dhomat e klorinimit duke vendosur dhe impiantin.

Financimi i realizimit të punimeve civile, mbikëqyrja dhe kolaudimi është kryer me fondet e dërguara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta me shkresën Nr.1901Prot. datë 23.07.2020 me ndarjen përkatëse për zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 15.12.2020 dhe administruar në Bashkinë Devoll me Nr.3688/3Prot. datë 15.12.2020.

Me shkresën e administruar në bashki me Nr.2508/2Prot. datë 07.12.2021 mbikëqyrësi i punimeve njofton pezullimin e punimeve duke filluar nga data 06.12.2021 për shkak të kushteve të pa favorshme atmosferike si: temperatura nën zero gradë Celsius, prani të dëborës dhe ngricave ku proceset e punës për germimin dhe ndërtimin e pusetave si dhe izolimi i depos nuk mund të kryhen. Referuar afateve të përcaktuara në kontratë për përfundimin e punimeve kanë mbetur edhe 9 (nëntë) ditë nga ai fillestar.

Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën datë 04.04.2022 të administruar në bashki me Nr.1169/1Prot. datë 04.04.2022 njofton se punimet kanë rifilluar.

Me shkresën e administruar në bashki me Nr.1320Prot. datë 13.04.2022 mbikëqyrësit i punimeve njofton se punimet kanë përfunduar më datë 13.04.2022 pra 9 ditë nga fillimi i tyre e njëjtë me afatin e mbetur nga pezullimi i tyre deri në përfundim sipas kontratës fillestare.

Referuar ndryshimeve në preventiv i volumeve (+/-) si dhe përdorimi i fondit rezervë vlere e preventivit të rishikuar është 79,453,563.95 lekë me TVSH ose 87,543.77 lekë me TVSH më pak se vlere e kontratës.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të administruar në bashki me Nr.1320/1Prot. datë 07.07.2022 dhe janë marrë në dorëzim të përkohshëm me aktin e administruar në bashki me Nr.1320/2Prot. datë 07.07.2022.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ujësjiellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”.				
14.Lidhja e kontratës Nr.3322Prot. datë 10.11.2020		15.Vlera e kontratës (me tvsh) 79,541,080.92 lekë BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK		16.Likuiduar deri dt
17-Situacioni Përfundimtar -Vlera me TVSH 79,453,563.95 lekë -Vlera pa TVSH 66,211,303.29 lekë		18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 12 muaj, Zbatuar 16 muaj Fillimi punimeve: 15.12.2020 Përfundimi punimeve: 13.04.2022		19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate Nr.1169Prot. datë 05.04.2022
20. Mbikëqyrësi i punimeve “E.-G” ShPK		Licenca Nr: MK. 1015/14	Kontrata Nr.3666/1Prot. datë 14.12.2020	
21. Kolaudatori i punimeve “N.” ShPK		Licenca Nr: MK.1846/7	Kontrata Nr.2192/12Prot. datë 06.07.2022	
22.Akt Kolaudimi datë 07.07.2022		23.Akt i marrjes në dorëzim Nr.1320/2Prot. datë 07.07.2022		

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,428,100 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë Ndërtim depo uji 100 m³ (rikonstruksion), zëri Suvatim me grafiato h>4m në librezën e masave pasqyrohet volum 88.99 m² dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Referuar librezës së masave në volumin e suvasë të kryer përfshihet suvatimi i rezervuarit nga jashtë m lartësi 2 m dhe dhoma e komandimit. Nga verifikimi në terren u konstatua se suvaja në dhomën e komandimit nuk është realizuar dhe pas korrigjimit të librezës së masave rezulton se kontraktori ka përfituar më tepër volumin e punimeve prej 47.55 m² në zërin Suvatim me grafiato h>4m kjo në vlerën prej 49,927 lekë pa TVSH (47.55m² x 1050 lekë/m³).

-Në kategorinë Ndërtim depo uji 100 m³ (rikonstruksion), zëri F.V pjesë speciale çeliku Ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë, për ujësjiellësa të jashtëm në librezën e masave pasqyrohet volum 1 ton dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga vizita në teren u konstatua se pjesët speciale prej çeliku që duhet të zëvendësoheshin nuk janë rehabilituar e kështu sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën e tubave të çelikut prej 200,000 lekë pa TVSH në zërin F.V pjesë speciale çeliku ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë, për ujësjiellësa të jashtëm. Gjithashtu u konstatua se saraçineskat në dhomën e komandimit në rezervuarin ekzistues me pjesët e tjera për montimin e tyre nuk janë ndryshuar por janë lënë në funksion saraçineskat e vjetra, kështu që sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve për zërat: 4 (katër) saraçineska në zërin e punimeve F.V Saraçineska bronzi Ø>100 mm në vlerën 100,000

lekë pa TVSH (4copë x 25,000 lekë/copa), 5 copë ventila çeliku në zërin F.V Ventila çeliku me flanaxha PN 25 bar ø 50 në vlerën 75,600 lekë pa TVSH (5 copë x 15,120 lekë/copa) si dhe 2 copë ventila çeliku në zërin F.V Ventila çeliku me flanaxha PN 25 bar ø 100 në vlerën 76,020 lekë pa TVSH (2 copë x 38,010 lekë/copa).

- Në kategorinë Rrjeti shpërndarës, në zërin e punimeve Mbushje me zhavorr në librezën e masave pasqyrohet volum punimesh 3193.8 m³ dhe e njëjta sasi, përmbledhëse, e likuiduar sipas situacionit përfundimtar. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen teknike, konkretisht materiali fotografik, konstatohet se mbulimi i tubit shpërndarës që del nga rezervuari me diametër 125 mm për gjatësinë 930 m, nuk është i mbuluar sipas vizatimeve sipas faktit por vetëm me material të gërmuar, pra nuk është realizuar mbushja me zhavorr dhe shtresa e rërës rreth tubit. Duke qenë se kontraktori ka realizuar vetëm zërin Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri kontraktori ka përfituar më tepër diferencën e çmimit midis zërave mbushje me zhavorr dhe mbushje me material të gërmuar 520 lekë/m³ pa TVSH (1030 lekë/m³- 610 lekë/m³) për volumin 279 m³ (930 ml x 0.3 m²) kjo në vlerën 145,080 lekë pa TVSH (279 m³ x 520 lekë/m³). Gjithashtu edhe për shtresën e rërës mbi tub, të pa realizuar, sipërmarrësi i punimeve ka përfituar diferencën e çmimit midis zërave mbushje me rërë nën tub dhe mbushje me material të gërmuar 1237 lekë/m³ (1847 lekë/m³- 610 lekë/m³) për volumin 167.4 m³ kjo në vlerën 207,073 lekë pa TVSH (167.4 m³ x 1237 lekë/m³).

- Nga verifikimi në terren i depos ekzistuese u konstatua se pajisja për njësi dozimi klori nuk ishte e instaluar, pavarësisht se është e përfshirë nga kontraktori në situacionin përfundimtar, e kështu sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjeno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës.

Impianti i klorinimit nuk kryen funksionin dhe në dhomën e klorinimit gjendej vetëm depozita e klorit, kështu që, në kategorinë Dhomat e klorinimit sipas projektit teknologjik 1 copë depoja e ujit, zëri Impiant klorinimi me vlerë 650,000 lekë pa TVSH është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve deri në instalimin dhe vendosjen në funksion të tij sipas projektit teknologjik.

Për sa më sipër, mos klorinimi i ujit të pijshëm sipas kriterëve të përcaktuara është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, ku në neni 15 thuhet: 1. “Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit”. 2. “Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të shtojcës IX. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cenuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t’i kërkojë autoritetit shëndetësor përjashtimin nga dezinfektantët mbetës.”

- 1. Titulli i gjetjes:** Punime të situacionuara por të kryera në fakt jo në përputhje me specifikimet teknike dhe detajit të projektit.
- Situata:** Në objektin “Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK me

Nr.3322Prot. datë 10.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 79,541,080.92 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre të ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.1169Prot. datë 05.04.2022 nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- Projekti fillestar;
- Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Ndryshimet e miratuara nga AK;
- Korrespondencat mes Bashkisë Devoll dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “E.-G” ShPK.

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Ndërtim depo uji 100 ³ (rikonstruksion)	Suvatim me grafiato h>4m	49,927
		F.V pjesë speciale çeliku Ø>200 mm të hidroizoluar në fabrikë, për ujësjellësa të jashtëm	200,000
		Impiant klorinimi	650,000
		F.V Saraçineska bronzi Ø>100 mm	100,000
		F.V Ventila çeliku me flanaxha PN 25 bar Ø 100	76,020
2	Rrjeti shpërndarës	Mbushje me zhavorr	145,080
		Mbushje me rërë mbi tub	207,073
SHUMA			1,428,100

Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.10.

Kriteri:

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.

-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nën pikat 3.2 dhe 3.3.

- Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK me Nr.3666/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ujësjellësi i Fshatit Hociht, Bashkia Devoll”, Neni 3, pika 3.10

“Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit”.

- Ndikimi/Efekti:** Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 1,428,100 lekë pa TVSH.
- Shkaku:** Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës 1,428,100 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr.3322Prot. datë 10.01.2020 për realizimin e punimeve civile.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “E.-G” ShPK z. G.I. sipas kontratës së shërbimit Nr.3666/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”.

- 2. Titulli i gjetjes:** Rrezikimi i shëndetit publik nga mungesa e klorinimit të ujit të pijshëm sipas standardeve të kërkuara.
- Situata:** Në objektin “Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll” nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe nga vizita në terren u konstatua se pajisja për njësi dozimi klori nuk ishte e instaluar, pavarësisht se është e përfshirë nga kontraktori në situacionin përfundimtar. Kështu që, sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës. Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.10.
- Kriteri:** VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, ku në neni 15 thuhet: 1. “Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit”. 2. “Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të shtojcës IX. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cenuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t’i kërkojë autoritetit shëndetësor përjashtimin nga dezinfektantët mbetës.”
- Kontrata e zbatimit të punimeve Nr.3322Prot. datë 10.11.2020.
- Ndikimi/Efekti:** Mungesë monitorimi për uljen e kostove të operimit dhe dëmtim i shëndetit publik.
- Shkaku:** Mungesa e instalimit të sistemit të klorinimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike.
- Rëndësia:** E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

2. Për objektin **“Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras”**, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Dosja teknike e zbatimit:

- Kontrata e zbatimit të punimeve midis Bashkisë Devoll dhe BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020.
- Projekti i Zbatimit (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;

2) Kontrata e Mbikëqyrjes së punimeve midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK me Nr.3689/1 Prot. datë 14.12.2020.

- Korrespondencat mes Bashkisë Devoll dhe operatorit ekonomik që kryen supervizionimin OE “E.-G” ShPK.

Kontratat

Punimet janë realizuar sipas kontratës për punë publike, me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 me objekt **“Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras”** të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, të përfaqësuar nga Titullari z. E.D. dhe BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 me përfaqësues z. A.I., z.A.L. dhe z. N.C. me licenca profesionale përkatësisht NZ. & NZ. dhe NZ.. Vlera e kontratës është 147,992,038 lekë pa TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 12 muaj nga data kur fillon zbatimi i saj. Për shkak të ndryshimit të burimeve si rezultat i protestave të banorëve dhe shpalljen zone e mbrojtur të burimit “Vala e Senicës” punimet nuk kanë përfunduar sipas afatit të parashikuar si dhe është bërë shtesë fondi për realizimin e objektit për furnizimin me ujë të zonës sipas nevojave. Amendim kontrate me Nr.988Prot. datë 17.03.2021 për shtesë fondi si rezultat i ndryshimit të burimeve. Amendim kontrate Nr.1 me Nr.1019Prot. datë 23.03.2021 zgjatje e afatit të përfundimit të punimeve deri më 12.06.2022 për shkak të pezullimit të punimeve. Amendim kontrate Nr.2 me Nr.56/2Prot. datë 17.03.2022 zgjatje e afatit të përfundimit të punimeve deri më 21.08.2022 për shkak të pezullimit nga kushtet atmosferike. Amendim kontrate Nr.3 me Nr.56/3Prot. datë 17.08.2023 zgjatje afati të përfundimit të punimeve deri 31.12.2022 për shkak të mbivendosjes me projekte që realizohen nga institucione të tjera mbi të njëjtën trase. Amendim kontrate Nr.4 me Nr.2501/1Prot. datë 11.07.2023 zgjatje afati të përfundimit të punimeve deri 01.08.2023 sipas grafikut të punimeve për shkak të pezullimeve.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.3689/1Prot. datë 14.12.2020 me OE “E.-G” ShPK, me përfaqësues G.I., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK., si dhe me vlerë të kontratës 1,902,558.64 lekë pa TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit është lidhur Kontratë Shërbimi Nr.18 me Nr.2958/14Prot. datë 05.10.2023 me BOE “A.-S.” ShPK & “N.” ShPK me licencë mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. dhe me vlerë të kontratës 313,705.9 lekë pa TVSH.

Hartimi i projektit

Projekti është hartuar nga OE “H. C.” ShPK. Në këtë projekt janë parashikuar të ndërtohen kaptazhet, linjat e rrjetit të jashtëm nga kaptazhet deri tek depot si dhe shuarësit e presionit. Kaptazhi kryesor është tek Burimi i Madh i Senicës me prurje 23 l/s si dhe tre shuarës presioni për furnizimin e depove të reja, konkretisht 500 m³ për fshatin Miras, 75 m³ për fshatin Qytezë, 75 m³ për fshatin Senicë dhe 200 m³ për fshatin Vidohovë me pjesët përkatëse si, dhoma e klorinimit, dhoma e komandimit me ujëmatës, puseta e shkarkimit dhe rrethimi i tyre, etj. Ndërtimi i rrjetit shpërndarës me tuba PE të dimensioneve të ndryshme si dhe vendosja e ujëmatësve për klientët familjar. Ndërtimi i pusetave të ajrimit dhe shuarësit e presionit pasi distancat e linjave kalojnë në terren të pjerrët dhe me disnivel të konsiderueshëm. Gjithashtu është parashikuar ndërtimi i linjave për furnizimin me energji elektrike të rezervuarëve për ndriçimin e tyre dhe funksionin e sistemit të klorinimit.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se dorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe fillimi i punimeve, sipas njoftimeve përkatëse është bërë në datën 15.12.2020 dhe administruar në Bashkinë Devoll me Nr.3689/2Prot. datë 15.12.2020.

Me shkresën e administruar në bashki me Nr.3689/3Prot. datë 24.12.2020 mbikëqyrësi i punimeve njofton pezullimin e punimeve për shkak të protestave të banorëve të zonës për mospërdorimin e burimit të madh në fshatin Senicë dhe shpallje zonë e mbrojtur “Vala e Senicës”. Pas këtij pezullimi me shkresën Nr.98Prot. datë 11.01.2021 bashkia i është drejtuar AKUM për heqjen nga skema e furnizimit të burimit “Vala e Senicës” dhe përdorimin e burimeve “Izvori i Dardhës”, “Kroi i Dushkut” dhe “Izvori i Senicës”. Miratimi i ndryshimeve nga AKUM është bërë me shkresën e administruar në bashki me Nr.98/1Prot. datë 26.01.2021 ku gjithashtu për shkak të skemës hidraulike të furnizimit me ujë janë shtuar 2860 ml tub për transmetim dhe tre kaptazhe të rinj me një rritje të vlerës së kontratës prej 33,659,318 lekë me TVSH. Sipas shkresës së administruar në bashki me Nr.988/1Prot. datë 17.03.2021 punimet kanë rifilluar më datë 17.03.2021. Më shkresën e administruar në bashki Nr.56Prot. datë 07.01.2022 punimet janë pezulluar për shkak të kushteve atmosferikë të pa përshtatshme dhe kanë rifilluar më datë 17.03.2022. Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën datë 11.07.2022 ka kërkuar zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve me shkakun se ka mbivendosje me dy projekte që zhvillohen nga institucione të tjera në fshatrat Senicë dhe Qytezë si dhe korrigjimin e plotësimin e projektit. Pasi nuk i është dhënë zgjidhje mbivendosjes së dy projekteve me shkresën Nr.4244Prot, datë 09.12.2022 është kërkuar pezullimi i punimeve në një afat të pa caktuar deri në zgjidhjen e çështjeve. Pas korrigjimeve dhe zgjidhjes së çështjeve të mbivendosjes së projekteve punimet kanë rifilluar më datë 11.07.2022. Referuar shkresës Nr.U-M-D-19Prot. datë 31.07.2023 të administruar në Bashki me Nr.2501/2Prot. datë 01.08.2023, punimet kanë përfunduar më 31.07.2023 kjo sipas afateve të përcaktuara në amendimin e kontratës nr.Nr.2501/1Prot. datë 11.07.2023.

Kolaudimi i punimeve është kryer sipas aktit të mbajtur më datë 18.10.2023 ku në të është përcaktuar dhe afati i garancisë së punimeve 12 muaj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Mira”.		
14.Lidhja e kontratës Nr.3388Prot. datë 16.11.202	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 177,590,445.84 lekë Shtesë kontrate (me TVSH) 33,659,318 lekë BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK	16.Likuiduar deri dt

17-Situacioni Përfundimtar Kontrata Baze -Vlera me TVSH 176,561,399 lekë -Vlera pa TVSH 147,134,499 lekë Kontratë shtesë -Vlera me TVSH 33,649,611 lekë -Vlera pa TVSH 28,041,342 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 12 muaj, Zbatuar 31 muaj Fillimi punimeve: 15.12.2020 Përfundimi punimeve: 01.08.2023		19. Zgjatja e kontratës Amendim kontrate fond shtesë Nr.988Prot. datë 17.03.2021 Amendim kontrate zgjatje afati Nr.1019Prot. datë 23.03.2021 Amendim kontrate zgjatje afati Nr.56/2Prot. datë 17.03.2022 Amendim kontrate zgjatje afati Nr.56/3Prot. datë 23.03.2023 Amendim kontrate zgjatje afati Nr.2591/1Prot. datë 11.07.2023	
20. Mbikëqyrësi i punimeve “E.-G” ShPK	Licenca Nr: MK. 1015/14	Kontrata Nr.3689/1Prot. datë 14.12.2020		
21. Kolaudatori i punimeve “A.-S.” ShPK & “N.” ShPK	Licenca Nr: MK. 2692/5 MK. 3101/13	Kontrata Nr.2958/14Prot. datë 05.10.2023		
22.Akt Kolaudimi datë 18.10.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim nuk ka			

Nga auditimi i situacioneve pjesore, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit në rezervuarin e fshatit Miras dhe Qytezë, të dukshme, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime të llogaritura jo në përputhje me projektin e zbaruar (vizatimet sipas faktit), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **907,955 lekë pa TVSH**.

Diferencat e volumeve të argumentuara si më poshtë:

-Në kategorinë, Punime për pusetat e ajrimit në situacionin përfundimtar të kontratës bazë janë përfshirë volume punimesh për zërat, F.V hekuri betoni periodik Ø 6-10 mm, F.V hekuri betoni periodik Ø mbi10 mm dhe Shkallë të galvanizuara të veshura me plastike sipas EN13101 A400 dhe Pjesë speciale gize por të pa pasqyruara në librezat e masave, ku volumet e punimeve për tre puseta ajrimi janë të përfshira në kontratën shtesë pas ndryshimeve të burimeve dhe skemës hidraulike. Vlera totale e zërave të mësipërm është 96,446.58 lekë pa TVSH e cila është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve dhe e përfshirë në kontratën shtesë pasi këto puseta ajrimi nuk ishin të parashikuara të ndërtoheshin në kontratën bazë.

-Në kategorinë Punime për pusetat e shkarkimit në situacionin përfundimtar të kontratës bazë janë përfshirë volume punimesh për zërat F.V hekuri betoni periodik Ø 6-10 mm, F.V hekuri betoni periodik Ø mbi10 mm dhe Shkallë të galvanizuara të veshura me plastike sipas EN13101 A400 dhe Pjesë speciale gize por të pa pasqyruara në librezat e masave, ku volumet e punimeve për tre puseta shkarkimi janë të përfshira në kontratën shtesë pas ndryshimeve të burimeve dhe skemës hidraulike. Vlera totale e zërave të mësipërm është 57,127.29 lekë pa TVSH e cila është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve dhe e përfshirë në kontratën shtesë pasi këto puseta shkarkimi nuk ishin të parashikuara të ndërtoheshin në kontratën bazë.

-Në kategorinë, Punime për pusetat e shkarkimit në situacionin përfundimtar të kontratës janë likuiduar 27 copë ku përfshihen edhe pusetat e shkarkimit të depove. Nga vizita në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve u konstatuar se puseta e shkarkimit, për rezervuarin 500m³ për fshatin Miras dhe për rezervuarin 75 m³ për fshatin Qytezë nuk ishin të përfunduara dhe të dëmtuara nga reshjet. Një punë e pa përfunduar dhe që nuk kryen funksionin e saj konsiderohet e pa kryer. Vlera totale e likuiduar në situacionin përfundimtar për 27 puseta shkarkimi është

5,893,312.46 lekë pa TVSH dhe vlera e 1 cope është 218,270.83 lekë pa TVSH. Sa më sipër për mosrealizimin e pushtave të shkarkimit në dy rezervuarët e verifikuar në terren sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën prej 436,541.66 lekë pa TVSH (2 cope x 218,270.83 lekë).

- Në kategorinë Punime për dhomën e klorinimit, është parashikuar ndërtimi i objektit dhe vendosja e sistemit të klorinimit i cili do të jetë automatik dhe dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produkt dezinfektues hipoklorit natriumit. Për mbajtjen e produktit dezinfektues janë vendosur dy rezervuara PVC me madhësi 80 litra dhe 125 litra. Gjithashtu në situacionin përfundimtar janë likuiduar edhe pajisje për dhomën e klorinimit sipas zërave: F.V Tavolinë prej druri e stazhionuar 1 copë, F.V Dollap metalik 200cmx80cmx30cm 1copë, F. Set veshje mbrojtëse 2 copë dhe F. Set pajisje mbrojtëse 2 copë. Nga vizita në terren u konstatua se pajisjet e mësipërme nuk gjendeshin në dhomën e klorinimit dhe nuk gjenden gjurmë shkresore që këto pajisje të jenë dorëzuar. Sasia e pajisjeve dhe çmimi njësi i tyre është i njëjtë për të gjitha dhomat e klorinimit të ndërtuara pranë rezervuarëve të fshatit Miras, Qytezë, Çetë dhe Senicë. Për sa më sipër, nga mos furnizimi i pajisjeve, sipërmarrësi i punimeve ka përfituar më tepër volumin për zërat: F.V Tavoline prej druri e stazhionuar në vlerën 25,480 lekë pa TVSH (6370 lekë/copë x 4 copë), F.V Dollap metalik 200cmx80cmx30cm në vlerën 31,360 lekë pa TVSH (7840 lekë/copë x 4 copë), F. Set veshje mbrojtëse në vlerën 74,480 lekë pa TVSH (9310 lekë/copë x 2 copë x 4 dhoma klorinimit) dhe F. Set pajisje mbrojtës në vlerën 101,920 lekë pa TVSH (12740 lekë/copë x 2 copë x 4 dhoma klorinimi). Vlera totale e pajisjeve të përfshira në situacionin përfundimtar por të pa dorëzuara është 233,240 lekë pa TVSH.

-Në kategorinë Punime depo uji rrjeti shpërndarës Qytezë, për ndërtimin e rezervuarit në zërin Transport materiale ndërtimi, dheu, me auto deri 10 km në librezën e masave dhe likuiduar në situacionin përfundimtar pasqyrohet volum punimesh 188 m³. Nga vizita në terren u konstatua se volumi i dheut të likuiduar në situacionin përfundimtar nuk është transportuar por nisur nga fakti se terreni ishte i pjerrët ky material është përdorur për sistemimin përreth depos brenda rrethimit. Për sa më sipër sipërmarrësi i punimeve ka përfituar me tepër volumin e punimeve 188 m³ në zërin Transport materiale ndërtimi, dheu, me auto deri 10 km kjo në vlerën 84,600 lekë pa TVSH (188 m³ x 450 lekë/m³).

- Nga verifikimi në terren i dhomave të klorinimit në depot fshatrat Qytezë dhe Miras u konstatua se pajisja e klorinimit ishte e instaluar me të gjitha pjesët përbërëse të saj por ishte jashtë funksionit pasi nuk ishte e lidhur energjia elektrike, e kështu sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjeno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës. Sipas informacionit edhe në dy dhomat e klorinimit për fshatrat Çetë dhe Senicë sistemi i ri i klorinimit nuk funksionon për të njëjtat arsye, mungesa e energjisë elektrike.

Për sa më sipër, mos klorinimi i ujit të pijshëm sipas kriterëve të përcaktuara është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, ku në neni 15 thuhet: 1. “Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit”. 2. “Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të shtojcës IX. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cenuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk

ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t'i kërkojë autoritetit shëndetësor përjashtimin nga dezinfektantët mbetës.”

1. Titulli i gjetjes: Punime të situacionuara por të pakryera në fakt dhe të dëmtuara.

Situata:

Në objektin “Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Cetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 147,992,038 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me amendimet përkatëse, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konkretisht:

- Projekti fillestar;
- Projekti i Zbatimit pjesor (Vizatimet sipas faktit);
- Pagesat pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Librezat e masave pjesore deri në situacionin përfundimtar;
- Ndryshimet e miratuara nga AK;
- Korrespondencat midis Bashkisë Devoll OE që kryen supervizionimin “E.-G” ShPK.

si dhe nga verifikimi i kryer në terren në prezencë të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH dhe mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera dhe të dëmtuara. Këto diferenca rezultuan në zërat me vlerat përkatëse si më poshtë:

Nr.	Kategoria e Punimeve	Emërtimi i Zërit	Vlera (lekë pa TVSH)
1	Punime për pusetat e ajrimit	- F.V hekuri betoni periodik Ø 6-10mm. - F.V hekuri betoni periodik Ø mbi 10mm. - Shkallë të galvanizuara të veshura me plastike sipas EN13101 A400. - Pjesë speciale gize	96,446.58
2	Punime për pusetat e shkarkimit	- F.V hekuri betoni periodik Ø 6-10mm. - F.V hekuri betoni periodik Ø mbi 10mm. - Shkallë të galvanizuara të veshura me plastike sipas EN13101 A400. - Pjesë speciale gize	57,127.29
		Pusetat e shkarkimit	436,541.66
3	Punime për dhomën e klorinimit	Tavolinë prej druri e stazhionuar	25,480
		F.V Dollap metalik 200cmx80cmx30cm	31,360
		F. Set veshje mbrojtëse	74,480
		F. Set pajisje mbrojtëse	101,920
4	Punime depo uji rrjeti shpërndarës Qytezë	Transport materiale ndërtimi, dheu, me auto deri 10 km	84,600
SHUMA			907,955.53

Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.11.

Kriteri: Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 ku përcaktohet se: “Mbikëqyrësi i

punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”

-Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1 ku përcaktohet se: “Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori. Zërat, sasi, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës”.*

-Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënparagrafi 3.2 dhe 3.3.*

- Kontrata e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK me Nr.3689/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: *“Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Mira”, Neni 3, pika 3.10 “Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit”.*

Ndikimi/Efekti: Dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në shumën 907,955.53 lekë pa TVSH.

Shkak: Certifikimi nga ana e mbikëqyrësit volume punimesh të pakryera në fakt dhe të dëmtuara.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës 129,468 Lekë pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e dëmtuara nuk kryhen dhe materialet nuk dorëzohen, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqësorisë nga BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 për realizimin e punimeve civile.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi përfaqësuesi i mbikëqyrësit OE “E.-G” ShPK z. G.I. sipas kontratës së shërbimit Nr.3689/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Mira”.

2.Titulli gjetjes: i Rrezikimi i shëndetit publik nga mungesa e klorinimit të ujit të pijshëm sipas standardeve të kërkuara.

Situata: Në objektin “Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Mira” nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe nga vizita në terren u konstatua se pajisja e klorinimit ishte e instaluar me të gjitha pjesët përbërëse të saj por ishte jashtë funksionit pasi nuk ishte e lidhur energjia elektrike, e kështu sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të

vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës. Sipas informacionit edhe në dy dhomat e klorinimit për fshatrat Çetë dhe Senicë sistemi i ri i klorinimit nuk funksionon për të njëjtat arsye, mungesa e energjisë elektrike. Konkretisht, argumentimet pasqyrohen të përshkruara në Akt konstatimin Nr.11.

- Kriteri:** VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, ku në neni 15 thuhet: *1. “Dezinfektimi i ujit të pijshëm është përgjegjësi e administratorit”. 2. “Uji i pijshëm i furnizuar nga rrjete shpërndarëse shtetërore apo private, depozita, rezervuarë fiks apo të lëvizshëm, puse kolektive apo individuale, duhet të dezinfektohet sipas përcaktimeve të shtojcës IX. Në këto raste, nënproduktet e dezinfektimit duhet të kenë nivelet më të ulëta të mundshme, pa cenuar në asnjë çast efektshmërinë e dezinfektimit. Kur nuk ka asnjë rrezik ndotjeje ose rritje mikrobiale përgjatë rrjetit shpërndarës nga fillimi deri në rubinetin e konsumatorit, administratori mund t’i kërkojë autoritetit shëndetësor përjashtimin nga dezinfektantët mbetës.”*
Kontrata e zbatimit të punimeve Nr.3388Prot. datë 16.11.2020.
- Ndikimi/Efekti:** Mungesë monitorimi për uljen e kostove të operimit dhe dëmtim i shëndetit publik.
- Shkaku:** Mungesa e instalimit të sistemit të klorinimit për shkak të mungesës së energjisë elektrike.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Devoll sh.a dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

2.5 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Në zbatim të pikës 5 të Programit të Auditimit me nr. 868/1 prot; datë 10.10.2023, i ndryshuar, me objekt: **“Auditim mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, prej datës 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

- Dokumentacioni në sistemin “e-lejet”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Devoll ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 06, datë 14.10.2020, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Çertifikatës së Përdorimit

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUdhËN 01.01.2022 - 31.12.2022

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Devoll, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri në 31.12.2022**, ka pasur **69 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh**, si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 16 aplikime për leje zhvillimi, 7 aplikime për leje ndërtimi, 6 aplikime për çertifikata përdorimi, 4 aplikime për ndryshime projekti gjatë ndërtimit, 7 aplikime për deklarata paraprake për kryerje punimesh, 1 aplikim për ndryshim funksioni, 7 aplikime për rikonstruksione dhe 15 për leje infrastrukture, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

Aneksi 1 – Viti 2022

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar
Leje zhvillimi	16	13	3
Leje ndërtimi mbi 250m ²	4	3	1
Leje ndërtimi deri 250m ²	3	3	-
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	7	7	-
Rikonstruksion	7	6	1
Çertifikatë përdorimi	6	6	-
Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m ²	0	0	0
Ndryshim projekti gjatë zbatimit	4	4	0
Ndryshim funksioni	1	1	0
Njoftim fillim punimesh	7	6	1
Shtyrje afati leje ndërtimi	0	0	0
Leje infrastrukture	15	5	10

Burimi: SPZHT Bashkia Devoll Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Devoll, leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **3 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri sipërfaqe me të vogël se 250 m² janë miratuar **3 leje**, leje përdorimi janë miratuar **6 leje**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m², çertifikata përdorimi dhe leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Dt. e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi për ndërtim stalle dhe ambjente ndihmëse, në pasuritë me nr. 489/4 dhe ZK 1833; 489/5 dhe ZK 1833, me sipërfaqe të përgjithëshme 2528 m ² , me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., me adresë në fshatin Gracë, Bashkia Devoll	z. M.K.; znj. V.K.	13.05.2022	5,332,296.00 lekë
2	Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë, në pasuritë me nr. 5/515 dhe ZK 1187; 5/518 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithëshme 879	z. K.Q.	06.09.2022	51,558,372.00 lekë

	m ² , me zhvillues z. K.Q., me adresë në, Bilisht, Bashkia Devoll			
3	Leje ndërtimi për 2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë, në pasuritë nr. 5/549 dhe ZK 1187; 5/550 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithshme 1106.7 m ² , me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., me adresë në Devoll, Bashkia Devoll	znj. I.T.; znj. E.Q.	10.10.2022	75,665,389.08 lekë
4	Çertifikatë përdorimi për objekt industrial me K.metalik + beton arme për larje dhe pastrim produkteve fasonerie , në adresën Devoll, paraqitur nga zhvilluesi D.P. ShPK, Bashkia Devoll	D. P. ShPK	31/01/2022	-
5	Çertifikatë përdorimi për objektin ndryshim funksioni nga lokal shërbimi në njësi shërbimi në katin 0 dhe nga hotel në banim në katet 1-2-3, në adresën Bilisht, Devoll	z. B.Ç.; znj. V.Ç.	01.09.2022	-

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

Titulli i gjetjes 1: Mosrespektimi i kondicioneve urbane.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga ndërtimet e tjera, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për “2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë”, në pasuritë nr. 5/549 dhe ZK 1187; 5/550 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithshme 1106.7 m², me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., me adresë në Devoll, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022, me problematika si më poshtë vijon:

- Dy objektet e miratuara në lejen e ndërtimit nuk respektojnë distancat urbane ndërtesë – ndërtesë nga njëra-tjetra. Referuar Nenit 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 3, shprehemi se distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve do të duhej të ishte 10 metra. Distanca e miratuar është 3 metra.

- Objektet e miratuar nuk respektojnë distancat nga kufiri i pronës. Referuar Nenit 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, shprehemi se distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve dhe kufirit të pronës do të duhej të ishte 5 metra. Distanca e miratuar është 3.2 metra.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Neni 34, pika 3; Neni 35, pika 1; Neni 40, pika 2. Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Devoll, pika 3.2.2.

Ndikimi/Efekti: Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në standartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Devoll.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqërues, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.D.**, Kryetari i Bashkisë Devoll (për miratimin e lejeve 1 dhe 3);
- **Znj. T.S.**, në funksionin e drejtorit të SPZHT (për miratimin e lejeve 1 dhe 3);
- **Z. R.K.**, në funksionin e nëpunësit pranë SPZHT (për miratimin e lejes 1 dhe 3);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 868/3 prot; datë 13.12.2023, është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 4061/8 prot; datë 07.12.2023, mbi dokumentat e akt-konstatimeve të protokolluar në Bashkinë Devoll. Këto argumenta, observacione prova dhe fakte, janë trajtuar në dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit dhe nuk do të jenë pjesë e dokumentit të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në vazhdim, mbi dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 257/1 prot; datë 24.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 868/5 prot; datë 24.01.2024. Duke qenë se nga ana e Bashkisë Devoll nuk janë sjellë fakte, prova dhe argumenta të rinjë mbi gjetjet e konstatuara më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit vazhdon të jetë i njëjtë. Këto observacione nuk do të bëhen pjesë e këtij dokumenti.

Titulli i gjetjes 2: Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe zhvillimi.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se në **3 (tre) raste** projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ndërtim stalle dhe ambjente ndihmëse, në pasuritë me nr. 489/4 dhe ZK 1833; 489/5 dhe ZK 1833, me sipërfaqe të përgjithëshme 2528 m², me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., me adresë në fshatin Gracë, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Në projektin arkitektonik mungojnë prerjet teknike (dy të tilla), rrjedhimisht ky dokument nuk është i plotë, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, të ndryshuar, pika 1/1, nënpika i);

-Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv dhe të raportit të auditimit të efencës së energjisë, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, të ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika ë);

-Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit arkitektonik, në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, të ndryshuar, Neni 15, pika 1, nënpika g).

2. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë, në pasuritë me nr. 5/515 dhe ZK 1187; 5/518 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithëshme 879 m², me zhvillues z. K.Q., me adresë në, Bilisht, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Leja e zhvillimit, me vendim nr. 3824/1, datë 28.12.2021, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, të ndryshuar, pika 1, nënpika d).

-Mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në kundërshtim me Shtojcën 2 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”*.

-Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të gjithë hartuesit e projekteve që përbëjnë projektin ndërtimor, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Mungon çertifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efencës së energjisë, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika g).

3. Leje ndërtimi për 2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë, në pasuritë nr. 5/549 dhe ZK 1187; 5/550 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithëshme 1106.7 m², me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., me adresë në Devoll, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Leja e zhvillimit, me vendim nr. 394/1, datë 22.02.2022, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika d);

-Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv, elektrik dhe hartuesin e raportit të auditimit të efencës së energjisë, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Mungon çertifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

-Deklarata e hartuesit të projektit arkitektonik nuk është e saktë, pasi në të citohet se: *“... se kam hartuar projektin konstruktiv për objektin ...”*, ndërkohë që znj. B. A.ka hartuar projektin arkitektonik dhe jo atë konstruktiv, në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 1, nënpika e).

-Nuk është marrë siguri e plotë mbi tjetërsimin ose jo të parcelave në zhvillim, pasi nuk është marrë miratimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), si dhe kartela dhe harta treguese e pasurisë së paluajtëshme nuk janë rifreskuar së fundmi, në raport me datën e aplikimit, në kundërshtim me Nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, të ndryshuar, pika 6. Nga auditimi i kësaj procedure, konstatohet se kartelat janë rifreskuar në datën 28.04.2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 07.09.2022.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”*, i ndryshuar, Neni 10, pika 1, nënpika d); Neni 15, pika 1, nënpika e), ë), g); pika 1/1, nënpika i), iii); Neni 21, pika 6. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1162, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen*

me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, Shtojca 2.

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në projektin ndërtimor, në dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe zhvillimi, ndikojnë në cilësinë dhe gatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjieno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Devoll.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacione e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

Rekomandimi 2: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve.

Rekomandimi 3: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë se mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

Rekomandimi 4: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.D.**, Kryetari i Bashkisë Devoll (për miratimin e lejeve 1, 2, 3);
- **Znj. T.S.**, në funksionin e drejtorit të SPZHT (për miratimin e lejeve 1, 2, 3);
- **Z. R.K.**, në funksionin e nëpunësit pranë SPZHT (për miratimin e lejeve 1, 2, 3);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 868/3 prot; datë 13.12.2023, është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 4061/8 prot; datë 07.12.2023, mbi dokumentat e akt-konstatimeve të protokolluar në Bashkinë Devoll. Këto argumenta, observacione prova dhe fakte, janë trajtuar në dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit dhe nuk do të jenë pjesë e dokumentit të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në vazhdim, mbi dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 257/1 prot; datë 24.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 868/5 prot; datë 24.01.2024. Duke qenë se nga ana e Bashkisë Devoll nuk janë sjellë fakte, prova dhe argumenta të rinjë mbi gjetjet e konstatuara më sipër,

qëndrimi i grupit të auditimit vazhdon të jetë i njëjtë. Këto observacione nuk do të bëhen pjesë e këtij dokumenti.

Titulli i gjetjes 3: Përlllogaritje e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë, sipas përcaktimeve të Nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, Nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, në pasuritë me nr. 5/515 dhe ZK 1187; 5/518 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithëshme 879 m², me zhvillues z. K.Q., me adresë në, Bilisht, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022. Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë **51,558,372.00 lekë**. Sipas VKB-së me nr. 89, datë 20.12.2021, mbi “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Devoll”, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është **4%** mbi çmimin e shitjes për metër katror. Referuar këtyre të dhënave, si dhe ri-llogaritjes nga ana e grupit të auditimit, është konstatuar se vlera e saktë e TNI-së është **2.444.400 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Devoll është **2.319.492 lekë**. Diferenca prej **124.908 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Devoll. Kjo diferencë ka ardhur nga llogaritja e gabuar e TNI-së për katin nëntokë dhe katin përdhe (me funksione respektive parkim dhe shërbime), në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 132, datë 07.03.2018...”, Aneksi 2, pika a).

Kriteri: Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 46. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, Neni 27, pika 1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 132, datë 07.03.2018...”, Aneksi 2, pika a).

Ndikimi/Efekti: Përlllogaritja e gabuar e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë ndikon negativisht në buxhetin e Bashkisë Devoll.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Devoll.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të përlllogaritur në mënyrë të saktë vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke e marrë në konsideratë koeficientet e çmimeve mesatare referuese të shitblerjes së hapësirave që përdoren për veprimtari ekonomike, tregtimi dhe shërbimi, si dhe për parkim të mbuluar dhe bodrume.

Rekomandimi 2: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për TNI e pallogaritur në shumën 124,908 lekë, nga zhvilluesi z. K.Q. për lejen e ndërtimit nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022 me objekt “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.D.**, Kryetari i Bashkisë Devoll (për miratimin e lejes nr. 2);

- **Znj. T.S.**, në funksionin e drejtorit të SPZHT (për miratimin e lejes nr. 2);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 868/3 prot; datë 13.12.2023, është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 4061/8 prot; datë 07.12.2023, mbi dokumentat e akt-konstatimeve të protokolluar në Bashkinë Devoll. Këto argumenta, observacione prova dhe fakte, janë trajtuar në dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit dhe nuk do të jenë pjesë e dokumentit të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në vazhdim, mbi dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 257/1 prot; datë 24.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 868/5 prot; datë 24.01.2024. Duke qenë se nga ana e Bashkisë Devoll nuk janë sjellë fakte, prova dhe argumenta të rinjë mbi gjetjet e konstatuara më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit vazhdon të jetë i njëjtë. Këto observacione nuk do të bëhen pjesë e këtij dokumenti.

Titulli i gjetjes 4: Bashkia Devoll dhe SPZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Devoll dhe Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 21, pika 6, SPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Leje ndërtimi për ndërtim stalle dhe ambjente ndihmëse, në pasuritë me nr. 489/4 dhe ZK 1833; 489/5 dhe ZK 1833, me sipërfaqe të përgjithëshme 2528 m², me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., me adresë në fshatin Gracë, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Referuar dokumentit të lejes së zhvillimit, miratuar me vendim nr. 1168/1 prot; datë 05.04.2022, si dhe dokumentit të lejes së ndërtimit, miratuar me vendim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, ku citohet se zhvilluesi duhet të kryejë konvertimin e resursit të tokës, nga tokë “arë” në tokë “truall”, shprehemi se nuk janë marrë në konsideratë kriteret e VKM-së nr. 440, datë 03.06.2020 “*Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës*”, pika 5;

-Referuar dokumentit të lejes së zhvillimit, miratuar me vendim nr. 1168/1 prot; datë 05.04.2022, merret informacioni se zhvillimi i kësaj pasurie mund të bëhet vetëm në përputhje me VKM-në nr. 12, datë 27.02.2019, për “*Miratimin e lejeve të zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urbane (UB), bujqësore (B) dhe Natyror (N)*”, pika 6. Sipas kësaj VKM-je, autoritetet vendore mund të miratojnë lejet e ndërtimit vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) dhe pas njoftimit të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT). Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejes së zhvillimit dhe ndërtimit për këtë objekt, konstatohet se nuk është kërkuar mendimi i AZHT, gjithashtu nuk është njoftuar KKT;

-Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM);

-Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

2. Leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë, në pasuritë me nr. 5/515 dhe ZK 1187; 5/518 dhe ZK 1187, me sipërfaqe të përgjithëshme 879 m²,

me zhvillues z. K.Q., me adresë në, Bilisht, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë (AEE), për dhënie e konformitetit mbi raportin e auditimit të eficientës së energjisë;

-Nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqipëtar (ARRSH), mbi dhënien e konformitetit të projektit në lidhje me respektimin e distancave nga aksi nacional Korçë – Kapshticë, si dhe mbi marrjen e informacioneve nga ana e ARRSH-së për projekte të mundëshme zgjerimi të kësaj rruge.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 440, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 12, datë 27.02.2019, për “Miratimin e lejeve të zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urbane (UB), bujqësore (B) dhe Natyror (N)”, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Mos-marrja dhe mos-respektimi i mendimit të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, rrit mundësitë e zhvillimit të objekteve në kundërshtim me kondicionet urbane, si dhe nuk jep siguri të lartë në lidhje me respektimin e kushteve të sigurisë dhe higjeno-sanitare.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Devoll.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.D.**, Kryetari i Bashkisë Devoll (për miratimin e lejeve 1 dhe 2);

- **Znj. T.S.**, në funksionin e drejtorit të SPZHT (për miratimin e lejeve 1 dhe 2);

- **Z. R.K.**, në funksionin e nëpunësit pranë SPZHT (për miratimin e lejeve 1 dhe 2);

Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 868/3 prot; datë 13.12.2023, është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 4061/8 prot; datë 07.12.2023, mbi dokumentat e akt-konstatimeve të protokolluar në Bashkinë Devoll. Këto argumenta, observacione prova dhe fakte, janë trajtuar në dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit dhe nuk do të jenë pjesë e dokumentit të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në vazhdim, mbi dokumentin e Projekt-Raportit të Auditimit është observuar nga funksionarët e SPZHT, Bashkia Devoll, me anë të shkresës nr. 257/1 prot; datë 24.01.2024, protokolluar në KLSH me nr. 868/5 prot; datë 24.01.2024. Duke qenë se nga ana e Bashkisë Devoll nuk janë sjellë fakte, prova dhe argumenta të rinjë mbi gjetjet e konstatuara më sipër, qëndrimi i grupit të auditimit vazhdon të jetë i njëjtë. Këto observacione nuk do të bëhen pjesë e këtij dokumenti.

Titulli i gjetjes 5: Mangësi në inspektimin e objekteve përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe gjatë zbatimit të punimeve të objektit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast** Bashkia Devoll, SPZHT dhe IMTV nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e kontrolleve dhe inspektimeve të nevojshme për ato raste që aplikojnë për leje ndërtimi, si dhe për inspektimin që këto struktura duhet të ushtrojnë mbi objektet e pajisura me leje ndërtimi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastin e mëposhtëm:

1. Leje ndërtimi për ndërtim stalle dhe ambiente ndihmëse, në pasuritë me nr. 489/4 dhe ZK 1833; 489/5 dhe ZK 1833, me sipërfaqe të përgjithëshme 2528 m², me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., me adresë në fshatin Gracë, Bashkia Devoll, për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, me problematika si më poshtë vijon:

- Zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 13.05.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Maj, 2022, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, ka dyshime të arsyeshme se subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Devoll, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar. Vlen të theksohet se nga informacioni i marrë nga sistemi elektronik i lejeve, zhvilluesi nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me Njoftim për Fillimin e Punimeve.

- Objekti i ndërtuar nuk është i njëjtë me objektin e miratuar, pasi nga inspektimi në terren dhe fotografimi satelitor konstatohen shtesa dhe objekte të tjera, të cilat nuk kanë qënë të parashikuara në lejen e ndërtimit të miratuar. Gjithashtu, objekti ndihmës funksional nuk është pozicionuar në sheshin e ndërtimit sipas projektit të miratuar. Veprimet e mësipërme janë në shkelje të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, Neni 1 dhe Ligjit 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 51, pika 1.

Kriteri: Ligji 107/2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*”, i ndryshuar, Neni 39; Neni 51, pika 1. Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”, i ndryshuar, Neni 1.

Ndikimi/Efekti: Lejimi i zhvillimit të objekteve në mungesë të lejeve të posaçme, si dhe mosushtrimi i inspektimit në objektet në zhvillimi cënon qëllimin e vet lejes së ndërtimit, që është marrja e sigurisë së domosdoshme mbi sigurinë, qëndrueshmërinë, respektimin e parametrave urban dhe të drejtës mbi pronës, si dhe të kushteve higjieno – sanitare, sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Devoll.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të marrin të gjitha masat për të ushtruar kontroll mbi objektin me leje të miratuar, me vendim për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, për verifikimin e situatës, në lidhje me objektet e evidentuara si objekte të paparashikuara në lejen e ndërtimit, si dhe për verifikimin e situatës për ndryshimin e pozicionit të objektit ndihmës funksional, si dhe nisjen e procedurave administrative ndaj kundërvajtësve. Në rast se zhvilluesi aplikon për pajisje me certifikatë përdorimi, SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për miratimin e aplikimit, vetëm pasi të vërtetohet përputhshmëria e objektit të ndërtuar me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit.

Rekomandimi 2: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, të marrin të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin ndërinstytucional në lidhje me kryerjen e inspektimeve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si dhe gjatë ndërtimit dhe para procesit të çertifikimit të objektit, me qëllim minimizimin e rasteve kur zhvilluesi nis ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, ose kur objekti i miratuar nuk është i njëjtë me atë të ndërtuar.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, për mos-ushtrimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Z. E.D.**, Kryetari i Bashkisë Devoll;
- **Z. N.L.**, në funksionin e kryeinspektorit të IMTV;
- **Z. F.Ç.**, në funksionin e inspektorit të IMTV;
- **Z. J.S.**, në funksionin e inspektorit të IMTV.

Në lidhje me dy procedurat e miratimit të çertifikatave të përdorimit, më konkretisht për:

1. Çertifikatë përdorimi për objekt industrial me K.metalik + beton arme për larje dhe pastrim produkteve fasonerie , në adresën Devoll, paraqitur nga zhvilluesi Denim Production ShPK, Bashkia Devoll;
 2. Çertifikatë përdorimi për objektin ndryshim funksioni nga lokal shërbimi në njësi shërbimi në katin 0 dhe nga hotel në banim në katet 1-2-3, në adresën Bilisht, Devoll:
- Shprehemi se këto procedura janë audituar dhe nuk janë konstatuar problematika në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të tyre.

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit:

1. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga ndërtimet e tjera, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapsira publike.
2. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se në 3 (tre) raste projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, siç janë mangësi në projektin arkitektonik, vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për hartuesit e projekteve ndërtimore, mungojnë licencat, deklaratat dhe policat e sigurimit të përgjegjësisë profesionale në disa raste, leja e zhvillimit është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit në dy raste, mungon studimi sizmik dhe gjeologjik në një rast, si dhe, në një rast, kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit.
3. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë, sipas përcaktimeve të Nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, Nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Për procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është

marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, është paraqitur preventivi me vlerë 51,558,372 lekë. Sipas VKB-së me nr. 89, datë 20.12.2021, vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregëtimi dhe shërbimi është 4% mbi çmimin e shitjes për metër katror. Referuar këtyre të dhënave, si dhe ri-llogaritjes nga ana e grupit të auditimit, është konstatuar se vlera e saktë e TNI-së është 2,444,400 lekë. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Devoll është 2,319,492 lekë. Diferenca prej 124,908 lekë përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Devoll.

4. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Devoll dhe SPZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, nuk është kryer konvertimi i resursit të tokës, nga tokë “arë” në tokë “truall”, sipas AKM-së; leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të mendimit pozitiv nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) dhe pa njoftuar Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT); nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM); nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST); nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Eficencës së Energjisë, për dhënie e konformitetit mbi raportin e auditimit të efikasitetit të energjisë; nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqipëtar, mbi dhënien e konformitetit të projektit në lidhje me respektimin e distancave nga aksi nacional Korçë–Kapshticë, si dhe mbi marrjen e informacioneve nga ana e ARRSH-së për projekte të mundshme zgjerimi të kësaj rruge.

5. Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 (një) rast Bashkia Devoll, SPZHT dhe IMTV nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e kontroleve dhe inspektimeve të nevojshme për ato raste që aplikojnë për leje ndërtimi, si dhe për inspektimin që këto struktura duhet të ushtrojnë mbi objektet e pajisura me leje ndërtimi. Më konkretisht, për objektin me leje ndërtimi për ndërtim stalle dhe ambjente ndihmëse, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, është konstatuar se zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Gjithashtu, zhvilluesi nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me Njoftim për Fillimin e Punimeve. Objekti i ndërtuar nuk është i njëjtë me objektin e miratuar, pasi nga inspektimi në terren dhe fotografimi satelitor konstatohen shtesa dhe objekte të tjera, të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në lejen e ndërtimit të miratuar. Gjithashtu, objekti ndihmës funksional nuk është pozicionuar në sheshin e ndërtimit sipas projektit të miratuar.

2.6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Territorit të Njesisë Vendore.

Në zbatim të pikës 6, të programit të auditimit “**Nr 868/1 prot., datë 10.10.2023**”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Pasqyrat financiare të vitit 2022.
- 2.Bllloqet e mara me procesverbal nga magazina.
- 3.Të tjera dokumente mbështetëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Për vitin 2022, Struktura e Inspektoratit së Mbrojtjes së Territorit Vendor të Bashkisë Devoll (IMTV) për vitin 2022 është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr. 120, datë 21.02.2020 “Për miratimin e strukturës organike të Aparatit të Bashkisë” për vitin 2020, i përbërë nga 4 punonjës, nga të cilët 1 kryeinspektor 2 inspektore dhe 1 specialist topograf si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
1	N.L.	Kryeinspektor	Turizëm	20.12.2019	Aktualisht në punë
2	F.Ç.	Inspektor	Agrobiznes, master	02.09.2020	Aktualisht në punë
3	J.S.	Inspektor	Gjuhe Letërsi, master	02.09.2020	Aktualisht në punë
3	V.B.	Specialist, topograf	Inxhinier ndërtimi	01.01.2023	Aktualisht në punë

Burimi: Bashkia Devoll

1.Përshkrimi i situatës për periudhën 01/01/2022– 31/12/2022.

Në ushtrimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Devoll për periudhën objekt auditimi, aktiviteti i veprimtarisë së punës në terren i cili është pasqyruar dhe dokumentuar me procesverbale konstatimi dhe për më tej me vendime pezullimi punimesh dhe vendime për prishje objekti të ndërtuar pa leje ndërtimi, në mënyrë të përmblëdhur paraqiten në tabelën në vijim.

Pasqyra e vendimeve të marra për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

Nr.	Emërtimi i vendimit	Sasia
1	Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 10 ditore	0
2	Vendime për pezullim punimesh ndërtim me afat 60 ditore	0
3	Vendime për prishje objektësh	1
4	Vendime për gjoba	3
5	Vendim për kallëzim penal	0

Burim: Bashkia Devoll.

2. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IVMT) të Bashkisë Devoll, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, i paraqitur nga IMTV. Gjatë periudhës objekt auditimi IMT-ja ka ushtruar funksionin publik duke u bazuar në ligjin nr. 183/2014, datë 24/2014 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga veprimet e kundërligjshme” sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji. IMT-ja e Bashkisë Devoll, ka bashkëpunuar rregullisht me Zyrën e Urbanistikës, me Policinë Bashkiake, me Zyrën e Shërbimeve, me I.K.M.T. qendror në Tiranë.

Rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll janë vendosur 3 gjoba në vlerën 600.000 lekë si vijon:

Nr.	Emri Subjektit (Shoqëria)	Lloj objektit	Vendimi		Vlera e Gjobës
			Nr.	Datë	
1	H.F.	Mur rrethues, punime çatie pa ndryshim forme	61	27.07.2022	50,000
2	F.I.	Shtëpi banimi	62	01.08.2022	500,000
3	K.M.	Mur rrethues, kolona betoni	64	07.10.2022	50,000

Burimi: Bashkia Devoll

Shënim: (F. I. falur me vendim gjykatë)

Pasqyra e vendimeve me gjobave për të cilat arkëtimi/pagesa është bërë në mënyrë vullnetare nga vete subjektet kundërvajtësi.

Nuk ka pagese gjobe të bëra vullnetarisht.

Nuk ka kallëzime penale për këtë periudhë nga IVMT Devoll.

Sa më sipër rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll janë vendosur 3 gjoba në vlerën **600,000 lekë** nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë gjobe, një gjobe me vlerë 500.000 leke është falur me vendim gjykatë me **Nr.2587-(352)** date 23.11.2022 duke mbetur pa u arkëtuar vlera 100,000 lekë, duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 100,000 lekë.**

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

c-Nga Drejtoria Juridik dhe IVMT, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

➤ **Vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi.**

Për periudhën objekt auditimi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin 9780/2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga IKMT dhe INUV" i ndryshuar, IMT Bashkia Devoll, ka marrë 1 vendim për prishje objektesh pa leje (sipas tabelës së mëposhtme), vendime të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara.

Në 1 rast (sipas tabelës së mëposhtme) rezulton se është mbajtur procesverbal konstatimi dhe procesverbal prishje, por nuk është marrë asnjë masë tjetër nga ana e IMT Bashkia Devoll për prishjen e ndërtimit dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, pasi kjo masë është rrëzuar nga gjykata .

Pasqyra mbi vendimet e marra nga IMT për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi për periudhën 01.01.2022– 31.12.2022 **si vijon:**

Nr.	Emri Subjektit (Shoqëria)	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1	F.I.	Shtëpi banimi	97	01/08/2022

Burimi: Bashkia Devoll

2.Baza ligjore.

Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar,

Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar,

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar,

VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore";

Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit";

Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.02.2001: "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.6.2011;

Titulli gjetjes: Problematikat e konstatuara në IMT bashkia Devoll.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT bashkia Devoll, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll janë vendosur 3 gjoba në vlerën **600,000 lekë** nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë gjobe, një gjobë

me vlerë 500.000 lekë është falur me vendim gjykatë me **Nr.2587-(352)** date 23.11.2022 duke mbetur pa u arkëtuar vlera 100,000 lekë,

a)duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 100,000 lekë.

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjykatës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

c-Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar; Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar,

VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"; Udhëzimi i KM nr. 2,datë 13.05.2005" Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"; Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.02.2001: "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.6.2011;

Efekti/Ndikimi: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, çon në mos njohjen e terrenit nga IMTV për ndërtimet pa leje.

Shkak: Mos njohja dhe zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të ri kërkohet edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin për arkëtimin e 2 kundërvajtësve në vlerën **100,000 lekë**), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përlllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimit: Nga auditimi mbi strukturën dhe veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Devoll, konstatohet se kjo strukturë është ngritur me vendim nr.93,date 26.12.2021 të Këshillit Bashkiak. Për veprimtarin e vitit 2022 në NJA kanë qenë të angazhuar vetëm 2 specialist të pajisur/ ose jo me certifikatë (shprehuni), dhe pa përgjegjës sektori, veprime në kundërshtim me pika 3 e VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës së NJBA.

Brenda datës 31.03.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GMS nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri në njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike.

“Menaxhimi i Riskut”

Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Bashkia Devoll nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi një punonjës kontrollon të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

-Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

-Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e

Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, të marrë masa e nevojshme, që grupi i GMS të kryejë detyrat përkatëse, duke vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar si dhe të ndjekë realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, drejtorët e drejtorive, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Brenda 6-mujorit të parë 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Bashkisë Devoll u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe buxhetit të shtetit, për vitin 2022 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 646,913 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 515,780 mijë lekë, ose në masën 79 %. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 281,095 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 226,637 mijë lekë, ose në masën 80%. Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 216,015 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 166,076 mijë lekë, ose në masën 76%.

Zëri transfertat korente të brendshme është planifikuar në vlerën 23,323 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 7,718 mijë lekë, ose në masën 33%. Zëri transfertat buxhete familjare është planifikuar në vlerën 17,565 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,784 mijë lekë, ose në masën 73%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 108,915 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 91,565 mijë lekë, ose në masën 84 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Devoll në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. *Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 gërma "c" dhe "ç", Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë/sectorët e tjerë të bashkisë Devoll, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit dhe krijimin e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore.

Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Devoll në datën 01.01.2022 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën 51,000,950 lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2022 është planifikuar për likuidim gjatë vitit

2022 vlera 49,606,531 lekë. Gjatë vitit 2022 është likuiduar vlera 11,506,596 lekë për detyrimet e prapambetura. Gjatë vitit 2022 janë krijuar detyrime të reja të prapambetura në vlerën 35,725,601 lekë për faturat e pranuar gjatë periudhës 01.01.2022-31.10.2022 dhe për periudhën 01.11.2021-31.12.2021 janë krijuar detyrime në vlerën 36,592,665 lekë. Pra në total, gjatë vitit 2022 vlera e detyrimeve të prapambetura është 115,580,200 leke. Situata e faturave të prapambetura e ka çuar Bashkinë Devoll në vështirësi financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55 “Probleme financiare”, Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, UMF nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 29,59,60,61. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1-2.5, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Bashkisë Devoll referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, konstatohet se për vitin 2022 ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar, disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real. Në mos realizimin e të ardhurave ka ndikuar zëri tarifë pastrimi është planifikuar në vlerën 41,632,500 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 28,875,964 lekë ose realizuar në masën 53%, taksë toke është planifikuar në vlerën 24,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 12,884,191 lekë ose realizuar në masën 53%, tarifë ndriçimi” është planifikuar në vlerën 18,641,600 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,388,905 lekë ose realizuar në masën 53%. Zërat fiskal të cilat kanë tejkaluar parashikimin.

“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 2,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,413,456 lekë ose realizuar në masën 336.54%.

“Të ardhura nga ASHK” është planifikuar në vlerën 150,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 501,495 lekë ose realizuar në masën 334.33%.

“Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 13,274,544 lekë ose realizuar në masën 132.27%.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nën pika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, 200. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryejë parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme

për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të ardhurat nga agentët tatimore (Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, ASHK në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Korçë në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Devoll dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Devoll. Në lidhje me mos realizimin/mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore nga agentët tatimorë, Bashkia Devoll duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj si dhe të fillojë procedurat për gjëbajtjen e këtyre agentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117, ku përcaktohet që “Dënimet për agentët e mbajtjes së tatimit në burim, agentët e taksave dhe agentët e tarifave”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15 si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura nga agentët tatimorë sipas llojit të taksës apo tarifës të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat e nevojshme për penalizimin e Agentëve Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 17. Të krijojë bazën e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat të cilat mbledhen nga Agentët Tatimorë, të kryqëzojë informacionet me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të kryhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licensimit nuk ka hartuar regjistrin e abonentëve familiar dhe private sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj. Në regjistrim e mbajtur nga Bashkia Devoll gjendet si informacion vetëm lista emërore e personave të cilët duhet të ngarkohen me bazën e taksave. Regjistrim fizik i mbajtur nga Bashkia Devoll nuk është i plotësuar sipas abonentëve për detyrimet e tyre sipas paketës fiskale dhe pagesat e kryera prej tyre. Duke mos patur informacioni e saktë nga regjistri kjo do të sjelli edhe parashikim të gabuar për mbledhjen e taksave. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa për hartimin e regjistrit të taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve në Bashkinë Devoll dhe Njësitë Administrative Proger, Miras, Hoçisht, Qendër në total janë asgjësuar aktive në vlerën totale 5,523,841 lekë për të cilat nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Konkretisht nuk dokumentohet mënyra e dorëzimit të aktiveve në vend depozitim. Gjithashtu në listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cilat konsiderohen të dëmshme, për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.

Nga titullari i institucionit nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre dhe nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” Kreu I pika 1 dhe pika 2, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 108 dhe pika 122. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit si dhe të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 135,072,931 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 79,935,202 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 79,935,202 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 20,627,875 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitet në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 20,627,875 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2024

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datën 01.01.2022, në vlerën 66,571,862 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 66,670,236 lekë me një rritje në vlerën 98,374 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 51,642,272 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitoare. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së

auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçensave të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Deri më datë 30.06.2024

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202” “Studime dhe Kërkime”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) dhe pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 1,562,000 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Deri më datë 30.06.2024

13. Gjetje nga auditimi: 1. Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” në vlerën 768,513,311 lekë kosto historike është përfshirë vlera 94,936,727 lekë (47,488,945 lekë nga ish-Komuna Qendër Bilisht + 47,447,782 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Qendër Bilisht dhe Hoçisht e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

2. Në gjendjen e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 2,017,277,250 lekë kosto historike është përfshirë vlera 572,125,235 lekë (57,441 lekë nga ish-Komuna Miras + 338,481,513 lekë ish-Komuna Qendër + 233,586,281 lekë ish-Komuna Hoçisht) e pa analizuar

si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i ish-Komunës Miras, Qendër dhe Hoçisht e pa analizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Deri më datë 30.06.2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Bashkia Devoll ka në pronësi në total 3,036 pasuri të cilat janë transferuar sipas VKM-ve përkatëse ku konstatohet se:

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Devoll dhe Njësive Administrative Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37.

b. Në total në pronësi të Bashkisë Devoll janë 3,036 pasuri të transferuara sipas VKM-ve të sipërpërmendura nga të cilat vetëm për 64 prej tyre janë të pajisura me certifikatë pronësie.

c. Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Devoll nga 345 pasuri të pasqyruara në kontabilitet vetëm 10 prej tyre posedon titull pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, germa “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor.

Nga Bashkia Devoll nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

d. Gjithashtu në Njësinë Administrative Hoçisht konstatohet se 2 pasuri janë zaptuar apo zënë forcërisht pasuritë si më poshtë:

-Pasuria me nr. 626/1, ZK nr. 1254, me emërtimin “Ish-Kopshti Borsh” është zënë forcërisht.

-Pasuria me nr. 1096/1, ZK nr. 1260, me emërtimin “Muzeu Bradvice” e zaptuar.

Nga Bashkia Devoll nuk janë marrë masat e duhura, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të kthyer pasuritë e sipërpërmendura në gjendjen e mëparshme pra në përdorim si aset të bashkisë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene”, 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Bashkia Devoll të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të kthyer pasuritë me nr. 626/1, ZK nr. 1254, me emërtimin “Ish-Kopshti Borsh” dhe nr. 1096/1, ZK nr. 1260, me emërtimin “Muzeu Bradvice” të zaptuara nga persona të tretë në përdorim si aset të bashkisë

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” paraqitet në vlerën 8,095,000 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 146,304,014 lekë ku totali i këtyre llogarive nuk kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 2,539,409 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” me kundërparti llogaritë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar dhe në llogarinë 101 “Fondi Bazë”.

Deri më datë 31.03.2024

16. Gjetje nga auditimi: Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, përmbledhësja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 4,705,731 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 4,605,392 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 632,794 lekë dhe 467 “Kreditore të ndryshëm” në vlerën 4,524,882 lekë ku totali shkon në vlerën 174,573,505 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 58,560,742 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2024

17. Gjetje nga auditimi: a. Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në datën 01.01.2022, ka qenë në vlerën 142,546,292 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 18,549,440 lekë dhe pakësim në vlerën 183,527,525 lekë ndërsa në datën 31.12.2022,

gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 144,568,207 lekë e cila përbëhet nga shpenzime kryesisht për kontrata shërbimesh dhe blerje mallrash etj., angazhime të marra mbi bazën e burimit të financimit nga të ardhurat e veta të bashkisë, por këto angazhime janë marrë pa u siguruar këto fonde reale në llogarinë e njësisë vendore në thesar, thjesht mbi bazën e planifikimit e të pritshmërisë së të ardhurave.

b. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2022 janë në vlerën 4,524,882 lekë. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,215,358 lekë dhe pakësim në vlerën 13,337,167 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 16,646,691 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 50, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 85, pika 2 dhe Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndo shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 16,646,691 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Devoll në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerë 10,224,794 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Devoll. Për 5 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Devoll janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,307,917 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Devoll, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 20,228,104 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Devoll, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2022, paraqitet në vlerën 2,408,318,717 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 490,471,432 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 1,193,422 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 5,523,841 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 110,562,369 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2023 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2024

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, mungojnë rregulla të shkruara dhe kriteret për zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe rregulla lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë për punonjësit e Bashkisë Devoll të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune. Këto veprime janë në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja si dhe për transferimet dhe ngritjen në detyrë për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Deri më datë 30.06.2024

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit të Agjencisë së Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative u konstatua se, janë punësuar gjashtë punonjës me profesion elektrikistë pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Devoll dhe Agjencia e Shërbimeve Utilitare, Komunitare dhe Administrative të merren masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektrikistë me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; **në 3 (tre)** procedura prokurimi, në kriteret e veçanta të kualifikimit, është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të kenë si kusht s’kualifikimi kërkesa/kriteret të cilat nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ndikojnë në

kufizimin e pjesëmarrjen, konkretisht në procedurat 1. “RiK.Shkolla fillore “Myrteza Sala”, me fond limit në shumën 91,833,096 lekë pa TVSh dhe vlerë kontrate në shumën 91,001,674 lekë me OE të shpallur fitues BOE “A.-I.G. C.& A.I.C.”, 2. “Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara” me fond limit në shumën 27,650,357 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë me OE të shpallur fitues BOE “A.K.2002 ShPK & "V.-CO" ShPK” dhe 3. “Servis dhe Pjese Kembimi” me fond limit në shumën 15,130,000 pa TVSh, dhe vlerë kontrate në shumën 14,189,167 lekë pa TVSh, me OE të shpallur fitues BOE “T.3A” SHA. Gjithashtu rezulton se disa prej kërkesave të veçanta, në këto procedura si dhe specifikimet teknike nuk janë sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, duke sjellë një konfuzion ndaj OE pjesëmarrës, nuk është sqaruar lidhja e ngushtë me objektin e prokurimit dhe natyrës së kontratës. Këto kriteret nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP, vendosja e tyre, mund të ndikojë në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, pasi nuk janë të lidhura me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet, të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik. Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës dhe argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë punonjësish. Në dokumentin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike rezulton nuk është bërë argumentimi tekniko/ligjor i tyre. *Veprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, neni 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 3, neni 78, pika 2, paragrafi dytë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandimi: Autoritetit Kontraktor Bashkia Devoll, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysht kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit u konstatua se; **në 5 (pesë)** procedura prokurimi, nuk janë argumentuar specifikimet teknike të në mënyrë teknike dhe ligjore. Gjithashtu në 4(katër) procedura rezulton se nuk është bërë një përshkrim i objektit të kontratës në lidhje me përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit të aplikuar nga AK, për mallrat apo punët, apo shërbimet që do të kryhen. Në 2 (dy) raste rezulton se nuk argumentohet dhe dokumentohet llogaritja e fondit limit të kontratës. *Veprime jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, pika 2, neni 78, pika 2, paragrafi dytë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, përpara hartimit të urdhrat të prokurimit të aplikojë mënyrën dhe përllogaritjen e vlerës së kontratës me qëllim dokumentimin dhe argumentimin e saj në përputhje me fondet buxhetore të miratuara. Gjithashtu të mbahen parasysht kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit referuar specifikimeve teknike të objektit të kontratës.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatua se në procedurën e prokurimit me objekt *"Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Devoll Naftë dhe Benzine"*, Autoriteti Kontraktor nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës së kontratës sipas VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, neni 76, pika 2-3, pasi nuk dokumentohet dhe argumentohet sasia e karburantit mbi të cilën është hartuar fondi limit. Në njësinë e prokurimit nuk është asnjë nga anëtarët specialist i fushës, i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet me qëllim argumentimin tekniko/ligjor të kriterëve të kualifikimit, referuar specifikimeve teknike të caktuara, në Dokumentet e Tenderit. Gjithashtu në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave nuk ka asnjë specialist apo ekspert të fushës së objektit që prokurohet i cili të ketë njohuri të specializuara për objektin që prokurohet. *Veprime këto jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 74, pika 2, neni 75, neni 76 pika 2 dhe 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të përcaktojnë saktë sasinë për karburant, duke argumentuar me dokumentacion justifikues dhe provues nevojat e Institucionit. Titullari i AK të caktojë në komisionet e ngritura, specialist të fushës me qëllim vlerësim sa më objektiv të procesit të prokurimit. Gjithashtu të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e teknikoligjor të specifikimeve teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2022, deri më 31.12.2022, në total janë realizuar 39 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit 18,888,395 lekë pa Tvsh dhe me vlerë realizimi kontrate 15,555,619 lekë pa Tvsh. Me zgjedhje janë audituar në total 9 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 6,052,869 lekë pa tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 5,330,065 lekë pa tvsh ose në masën 32% e vlerës së fondit limit ku konstatohet se:

Në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.. Janë kryer 4 procedura blerje me vlera të vogla ndërkohë që këto procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim pasi kanë të njëjtën objekt prokurimi Si rezultat i copëzimit dhe përpjesëtimit të vlerave të kontratave dhe fondeve të tyre, kanë sjellë për pasojë shmangie nga procedurat standarde të prokurimit.

-Në 10 raste në SPE është publikuar ftesa për ofertë në të cilën janë përfshirë specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta për kualifikim. Në këtë dokument konstatohet se nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla nuk janë argumentuar kriteret e veçanta për kualifikim;

-Në 2 raste nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla në ftesën për ofertë janë konstatuar kriteret jo në përputhje me shërbimin/investimin e kërkuar, nuk janë të argumentuara dhe çenojnë pjesëmarrjen e operatorë ekonomikë.

-Në 4 raste në SPE nuk është respektuar afati i njoftimit (24 orë).

-Në 1 rast referuar procesverbalit të hapjes dhe verifikimit të ofertave të mbajtur nga Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla është s'kualifikuar një operatorë ekonomik për mospërputhje të fushës së veprimtarisë nga objekti i prokurimit.

-Në 3 raste mallrat nuk janë bërë hyrje në institucion brenda afateve të përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë.

-Në 3 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Devoll në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorë ekonomikë duke sjellë risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale. Këto veprime janë në kundërshtim me *Ligjin nr. 162, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni*

34, pikat 2-3, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 12, pika 3, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 3 dhe pikat 11-13. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Komisioni i Prokurimeve me Vlera të Vogla të marrë masa që:

- Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

- Të argumentohen kriteret e veçanta për kualifikim.

- Për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit publik të respektohet afati i kalimit nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo s’kualifikimit të tyre.

- Për rastet që mallrat e prokuruar nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë të bëhet s’kualifikimi i tyre.

- Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

26. Gjetja nga auditimi: Në objektin “Ujësjiellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll” dhe “Ndërtim i ujësjiellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras” nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe nga vizita në terren u konstatua se në të gjitha pikat ku janë vendosur pajisjet e klorinimit me pjesët përbërëse nuk ishin në funksion. Sistemi i klorinimit nuk ishte vendosur në funksion pasi nga ana e operatorit OSHEE nuk ishte instaluar matësi i energjisë elektrike. Klorinimi i ujit të pijshëm kryhej me metodë mekanike dhe jo në mënyrë të vazhdueshme ku sasia e klorit mund të jetë jashtë normave të lejuara, më e lartë ose më e ulët, duke rrezikuar shëndetin publik të popullatës, e kështu sasia e ujit që hyn në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Mos klorinimi i ujit të pijshëm sipas parametrave të kërkuara është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 15 (shtojca IX). (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll në bashkëpunim me Ujësjiellës Kanalizime Devoll sh.a dhe sistemin OSHEE të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e energjisë elektrike për vendosjen në funksion të sistemit të klorinimit, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë rruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se për lejen e ndërtimit me vendim me nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022 për “2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë”, me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane nga ndërtimet e tjera, përcaktimet për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike, konkretisht:

- Dy objektet nuk respektojnë distancat urbane ndërtesë – ndërtesë nga njëra-tjetra, pasi distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve do të duhej të ishte 10 metra, ndërsa distanca e miratuar është 3 metra, në kundërshtim me nenin 34 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 3;

- Nuk respektojnë distancat nga kufiri i pronës, pasi distanca minimale e lejuar midis këtyre objekteve dhe kufirit të pronës do të duhej të ishte 5 metra, ndërsa distanca e miratuar është 3.2 metra, në kundërshtim me nenin 35 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 156-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të merren masa për respektimin e distancave dhe kondicioneve urbane sipas përcaktimeve ligjore dhe rregullatorë në fuqi, për shqyrtimin e vetëm atyre aplikimeve që kanë informacion të saktë në dokumentacionin shoqërues, si dhe për të kërkuar në çdo rast evidentimin e përcaktimeve për shfrytëzimin e territorit për rrugë dhe për hapësira publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se në **3 (tre) raste** projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, konkretisht:

1. Për leje ndërtimi për “Stallë dhe ambiente ndihmëse”, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, është konstatuar se në projektin arkitektonik mungojnë prerjet teknike (dy të tilla), rrjedhimisht ky dokument nuk është i plotë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1/1, nënpika i); mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv dhe të raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit arkitektonik, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika g).

2. Për leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, është konstatuar se leja e zhvillimit, me vendim nr. 3824/1, datë 28.12.2021, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika d); mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në kundërshtim me shtojcën 2 të VKM-së nr. 1162, datë 24.12.2020; mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për të gjithë hartuesit e projekteve që përbëjnë projektin ndërtimor, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon çertifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika g).

3. Për leje ndërtimi për “2 objekte me 5 kate banim dhe 1 kat nën tokë”, me zhvillues znj. I.T. dhe znj. E.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2970/1 prot; datë 10/10/2022, është konstatuar se leja e zhvillimit, me vendim nr. 394/1, datë 22.02.2022, është miratuar në mungesë të projekt-idesë arkitektonike të zhvillimit, në kundërshtim me nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika d); mungojnë vërtetimet e regjistrimit në QKB për hartuesit e projektit arkitektonik, konstruktiv, elektrik dhe hartuesin e raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); mungon çertifikata e ekspertit privat zjarrfikës, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika ë); deklarata e hartuesit të projektit arkitektonik nuk është e saktë, pasi në të citohet se: “se kam

hartuar projektin konstruktiv për objektin”, ndërkohë që znj. Bruna Arkaxhiu ka hartuar projektin arkitektonik dhe jo atë konstruktiv, në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar, pika 1, nënpika e); kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit, pasi referuar Ligjit nr. 111/2018, neni 17, pika 4 dhe 6, të VKM-së nr. 457, datë 29.6.2022, neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 45, pika c), kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilat zhvillohet ndërtimi, duhet të jenë të rifreskuara tre (3) muajt e fundit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 156-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. SPZHT duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

28.2 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm mbi objektin në zhvillim, duke respektuar gjithashtu afatet e përcaktuara në ligj për shqyrtimin e aplikimeve.

28.3 Rekomandimi: SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, rifreskimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme në më pak se tre muajt e fundit, me qëllim marrjen e sigurisë se mbi pronë nuk janë aplikuar tjetërsime.

Menjëherë dhe në vijimësi

28.4 Rekomandimi: Nga SPZHT dhe Bashkia Devoll të merren të gjitha masat për të shqyrtuar vetëm ato aplikime për leje zhvillimi, të cilat kanë ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, ndër të tjera, edhe projekt-idenë arkitektonike të objektit që kërkohet të zhvillohet, me qëllim dhënien e një vlerësimi të saktë mbi respektimin e kriterëve urbane në varësi të funksionit të saj dhe të përdorimit të tokës, në përputhje me dispozitat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Devoll dhe SPZHT nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6, SPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

1. Për leje ndërtimi për “Stallë dhe ambiente ndihmëse”, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, është konstatuar se nuk është kryer konvertimi i resursit të tokës, nga tokë “arë” në tokë “trual”, duke mos marrë në konsideratë kriteret e VKM-në nr. 440, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”, pika 5; Nuk është respektuar VKM-në nr. 12, datë 27.02.2019, për “Miratimin e lejeve të zhvillimit / ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në njësitë që i përkasin sistemeve urbane (UB), bujqësore (B) dhe Natyror (N)”, pika 6, pasi sipas kësaj VKM-je, autoritetet vendore mund të miratojnë lejet e ndërtimit vetëm pas marrjes së mendimit pozitiv nga AZHT dhe pas njoftimit të KKT-së. Nga

auditimi konstatohet se nuk është kërkuar mendimi i AZHT, gjithashtu nuk është njoftuar KKT; Nuk është kërkuar mendimi i AKM-së; Nuk është kërkuar mendimi i OST-së.

2. Për leje ndërtimi për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022, është konstatuar se nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Efiçencës së Energjisë, për dhënie e konformitetit mbi raportin e auditimit të efiçencës së energjisë; Nuk është kërkuar mendimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar, mbi dhënien e konformitetit të projektit në lidhje me respektimin e distancave nga aksi nacional Korçë – Kapshticë, si dhe mbi marrjen e informacioneve nga ana e ARRSH-së për projekte të mundshme zgjerimi të kësaj rruge. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 156-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

29.1 Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Bashkia Devoll të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast** Bashkia Devoll, SPZHT dhe IMTV nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për ushtrimin e kontrolleve dhe inspektimeve të nevojshme për ato raste që aplikojnë për leje ndërtimi, si dhe për inspektimin që këto struktura duhet të ushtrojnë mbi objektet e pajisura me leje ndërtimi. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në lejen e ndërtimit për “Stallë dhe ambiente ndihmëse”, me zhvillues z. M.K. dhe znj. V.K., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, me problematika si më poshtë vijon:

-Zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 13.05.2022. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Maj, 2022, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, ka dyshime të arsyeshme se subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Devoll, kjo në shkelje të nenit 39 të Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Vlen të theksohet se nga informacioni i marrë nga sistemi elektronik i lejeve, zhvilluesi nuk ka aplikuar dhe nuk është pajisur me Njoftim për Fillimin e Punimeve.

-Objekti i ndërtuar nuk është i njëjtë me objektin e miratuar, pasi nga inspektimi në terren dhe fotografimi satelitor konstatohen shtesa dhe objekte të tjera, të cilat nuk kanë qënë të parashikuara në lejen e ndërtimit të miratuar. Gjithashtu, objekti ndihmës funksional nuk është pozicionuar në sheshin e ndërtimit sipas projektit të miratuar. Veprimet e mësipërme janë në shkelje të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, neni 1 dhe Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, neni 51, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 156-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT) dhe Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të marrin të gjitha masat për të ushtruar kontroll mbi objektin me leje të miratuar, me vendim për miratim nr. 1442/1 prot; datë 13.05.2022, për verifikimin e situatës, në lidhje me objektet e evidentuara si objekte të parashikuara në lejen e ndërtimit, si dhe për verifikimin e situatës për ndryshimin e pozicionit

të objektit ndihmës funksional, si dhe nisjen e procedurave administrative ndaj kundërvajtësve. Në rast se zhvilluesi aplikon për pajisje me certifikatë përdorimi, SPZHT dhe Bashkia Devoll të marrin masa për miratimin e aplikimit, vetëm pasi të vërtetohet përputhshmëria e objektit të ndërtuar me projektin e miratuar në lejen e ndërtimit.

Menjëherë

30.2 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, të marrin të gjitha masat për të rritur bashkëpunimin ndërinstytucional në lidhje me kryerjen e inspektimeve përpara miratimit të lejeve të ndërtimit, si dhe gjatë ndërtimit dhe para procesit të certifikimit të objektit, me qëllim minimizimin e rasteve kur zhvilluesi nis ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, ose kur objekti i miratuar nuk është i njëjtë me atë të ndërtuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *“Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”* sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK me Nr.3322Prot. datë 10.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 79,541,080 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre të ndryshuar me Amendim Kontrate Nr.1169Prot. datë 05.04.2022, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave volume pune të kryera në fakt jo sipas specifikimeve teknike dhe detajit të projektit, për 7 (shtatë) zëra punimesh në shumën **1,428,100 lekë** pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; -Kontratën e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK me Nr.3666/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ujësjellësi i Fshatit Hocisht, Bashkia Devoll”, Neni 3, pika 3.10 “Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës **1,428,100 lekë** pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “Z.” ShPK & “K.” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr.3322Prot. datë 10.01.2020 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Në objektin *“Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Miras”* sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK me Nr.3388Prot. datë 16.11.2020 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 147,992,038 lekë me TVSH me afat përfundimi të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre, e ndryshuar me

amendimet përkatëse, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se janë përfshirë në librezat e masave dhe vizatimet sipas faktit volume pune të pakryera, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën 907,955.53 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit të lidhur midis Bashkisë Devoll dhe OE “E.-G” ShPK me Nr.3689/1Prot. datë 14.12.2020 me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin, Ndërtim i ujësjellësit të jashtëm dhe të brendshëm për fshatin Senicë, Qytezë, Çetë, Miras, Vidohovë, Njësia Administrative Mira”, Neni 3, pika 3.10 “Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll të marri masa, për arkëtimin e shumës **907,955 lekë** pa TVSH, e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore, në rast se punimet e dëmtuara nuk kryhen dhe materialet nuk dorëzohen, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit nga BOE “E.K.” ShPK & “N.” ShPK & “A.S.” ShPK sipas kontratës së lidhur me Nr.3388Prot., datë 16.11.2020 për realizimin e punimeve civile.

Menjëherë

C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Devoll konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën **7,807,399 lekë** shumë e cili i përket vetëm abonentëve privat. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën **26,752,371 lekë**. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, janë në vlerën **34,559,770 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll e përbëra nga:**

- Detyrime abonentët familjarë në vlerën **21,081,770 lekë**
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **8,312,347 lekë;**
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **4,464,085 lekë;**
- Detyrime nga institucionet në vlerën **702,000 lekë;**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe, 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2022, në **vlerën totale 34,559,770 lekë**, e cila përbëhet nga:

-21,081,338 lekë detyrime nga **abonentët familjarë**;

-8,312,347 lekë detyrime nga **biznesi i madh**;

-4,464,085 lekë detyrime nga **biznesi i vogël**;

-702,000 lekë detyrime nga **institucionet**;

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Devoll, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Brenda datës 31.12. 2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Devoll në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Korçë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, sipas listave të vendosura në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 1,635,662 lekë për 44 persona, kanë paguar detyrimet 40 persona me vlerë 1,498,217 lekë dhe kanë mbetur për likuidim deri datë 31.12.2022 gjithsej **4 persona** me vlerë **137,445 lekë**. Debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga vitet e mëparshme janë **29 persona** me vlerë **2,176,456 lekë**. Vlera debitorë **2,313,901 lekë është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll**.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", neni 27, pika "d", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe, 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën **2,313,901 lekë** ndaj 33 personave.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Lejeve dhe Liçencave, për personat të cilat nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leja, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Korçë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.12. 2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave nga dhënia me qira e tokave bujqësore për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, konstatohet se, Bashkia Devoll nuk ka lidhur kontrata të reja por ka vazhduar me kontratat e mëparshme duke i rinovuar afatin sipas kontratave fillestare. Në total për 6 njësitë administrative janë aktive 13 kontrata për vitin 2022 sipas **aneksit 10 në Raportin Përfundimtar të Auditimit.**

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i Financës mbi zbatimin e detyrave të lëna nga auditim i mëparshëm në këtë bashki dhe konkretisht mbi problematikat për kontratat e qirave, rezulton se nga Sektori Juridik dhe Sektori i të Ardhurave Vendore nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e detyrimeve të evidentuara nga KLSH-ja, vlerën 21,538,000 lekë, nga ku është arkëtuar vlera 161,200 lekë, dhe ka mbetur pa arkëtuar **vlera 21,376,000lekë. Kjo shumë konsiderohet e ardhur munguar në buxhetin e Bashkisë Devoll.**

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe, 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Liçensave dhe Lejeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Pyjeve, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Financë Buxhetit, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për qiranë e pa llogaritur dhe papaguar në shumë **21,376,000 lekë**, respektivisht:

- vlera 650,000 lekë** nga shoqëria “V.” sha;
- vlera 300,000 lekë** nga shoqëria ‘I.02’ SHPK;
- vlera 705,020 lekë** nga shoqëria ‘A.AL’ SHPK;
- vlera 2,482,980 lekë** nga shoqëria “M.H.Q.” SHPK;
- vlera 17,238,800 lekë** nga shoqëria “K.” SHPK.

Brenda datës 31.12. 2024

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Devoll nuk ka lidhur kontratë qiraje me 3 subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare sipas tarifave minimale ligjore për zbatimin e kontratave të shfrytëzimit/kërkim-zbulimit. Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Devoll kanë ushtruar aktivitet 5 subjekte private për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore për nxjerrje guri gëlqeror dhe hekur nikel referuar lejeve minerare të miratuara nga MEI. Nga bashkia nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen totale prej 113 ha, detyrimi dysHEME/minimal është përlllogaritur përafërsisht **7,006,000 për vitin 2022**, për 3 subjekte **vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll** si rezultat mos lidhjes së kontratave.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet në pikën 5 të nenit 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe

pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, dhe neni 38 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 26-52 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Devoll, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Mbrojtjes së Tokës dhe Konsumatorit duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 113 ha, duke aplikuar tarifat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (7,006,000, për 3 subjektet e mësipërme).

Brenda datës 31.12. 2024

5. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Devoll dhe nga auditimi i tyre, rezulton se ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve gjithsej aktivë **9 pika** të tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tij, ku detyrimi për taksën e autorizimeve që subjekte duhet të likuidojnë është 9,000,000 lekë. Kanë paguar detyrimin 6 subjekte me vlerë 6,000,000 lekë dhe 3 subjekte e kanë paguar atë pjesërisht, ku nga vlera 3,000,000 lekë është paguar vlera 1,600,000 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 1,200,000 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Devoll.** Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 77 të ligjit nr. 77, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pasi marrëveshje është për detyrimet e palikujduara në fund të periudhave ushtrimore dhe zgjat vetëm një vit kalendarik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 42-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi:Bashkia Devoll, Drejtoria e të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur prej **1,200,000 lekë** nga 3 subjektet, *respektivisht*; 1. **vlera 200,000 lekë** nga subjekti “R.H.” ShPK; 2. **vlera 400,000 lekë** nga subjekti “M.” ShPK; dhe 3. **vlera 600,000 lekë** nga subjekti “I.O.” ShPK.

Brenda datës 31.12. 2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMT bashkia Devoll, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll janë vendosur 3 gjoba në vlerën **600,000 lekë** nga të cilat nuk është arkëtuar asnjë gjobë, një gjobë me vlerë 500.000 lekë është falur me vendim gjykate me **Nr.2587-(352)** date 23.11.2022 duke mbetur pa u arkëtuar vlera 100,000 lekë,

a)duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 100,000 lekë.

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjobjës) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

c-Nga Drejtoria Juridik dhe IMTV, nuk është kërkuar në Gjykatë, shndërrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar; Ligji nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin e punimeve në ndërtim", i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"; Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"; Udhëzim i KM nr. 3, datë 15.02.2001: "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.6.2011. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 167-170 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të ri kërkohet edhe njëherë Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme

6.2. Rekomandimi: Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Devoll, të përcjellë në kontabilitet dhe të vazhdojë procedurat për arkëtimin për arkëtimin e 2 kundërvajtësve në vlerën **100,000 lekë**), duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore. Ndërkohë për rastet e mos pagesës të vlerës gjobave brenda afatit 5 ditor kur të dërgohen në Gjykatë për kthimin në tituj ekzekutiv të përlllogariten edhe kamat vonesat 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj.

Brenda datës 31.03.2024

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Permiresimi i banesave ekzistuese per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara*", me fond limit në shumën 27,650,357 lekë, dhe vlerë kontrate në shumën 22,968,741 lekë, u konstatua: Referuar raportit përmbledhës të hartuar dhe nënshkruar nga KVO dhe titullari i AK, ku për këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 OE nga të cilët janë s'kualifikuar 2 OE dhe janë kualifikuar 2 OE, vërehet se është s'kualifikuar OE "A.A." ShPK, me vlerë oferte në shumën 19,037,241 lekë me arsyen se nuk ka paraqitur vërtetimin për të provuar kapacitetet financiare për xhiron vjetore për vitet 2019,2020 dhe 2021, ku për një prej këtyre viteve vlera e xhiros së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Vlerësimi i KVO nuk është bërë i drejtë pasi OE "A.A." ShPK ka paraqitur bilancet e viteve 2019 dhe 2020, në të cilat është evidente në llogaritë përkatëse situata e qarkullimit vjetor disa herë më shumë se vlera e objektit të kontratës për këtë procedurë. Pra rrjedhimisht nëse KVO do të kualifikonte këtë OE, në përputhje me qëllimin dhe parimet e LPP, Bashkia Devoll do të lidhte një kontratë me vlerë më pak nga kontrata që ka lidhur, në një diferencë prej **3,931,500 lekë** (22,968,741-19,037,241) pa TVSh dhe një vlerë **4,717,800 lekë me TVSh e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë Devoll**. Kjo pasi dokumenti për xhiron vjetore, nuk ndikon thelbësisht në karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe konsiderohet devijim i vogël, për përmbushjen e kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 90-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Përgjegjësi i Prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masat që, në procedurat e prokurimit në vijim, të bëjnë vlerësim objektiv ndërmjet OE pjesëmarrës, duke mbajtur parasysh parimet dhe qëllimin e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik me qëllim mire përdorimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomicitet.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë konstatohet se, në **6 raste** janë zhvilluar projekte artistike për të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, nenet 7-9 dhe nenet 65-70, Ligjit nr. 25/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10/352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe Kulturën”, neni 20, neni 26, neni 29, neni 32, dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas Vendimit nr. 100, datë 28.12.2021, të Këshillit Bashkiak. Nga Bashkia Devoll për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 6 subjekte është likuiduar shuma 1,778,500 lekë. **Vlera 1,778,500 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 59-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) nuk është përlllogaritur e saktë, sipas përcaktimeve të nenit 46 të Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, si rrjedhojë, nenit 27 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, pika 1. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në përlllogaritjen e TNI-së për lejen e ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”, me zhvillues z. K.Q., për të cilën është marrë vendimi për miratim nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022. Për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 51,558,372.00 lekë. Sipas VKB-së me nr. 89, datë 20.12.2021, mbi “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Devoll”, vlera e TNI-së për ndërtimet e reja për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi është **4%** mbi çmimin e shitjes për metër katror. Referuar këtyre të dhënave, si dhe ri-llogaritjes nga ana e grupit të auditimit, është konstatuar se vlera e saktë e TNI-së është **2,444,400 lekë**. Vlera e TNI-së e përlllogaritur nga funksionarët e Bashkisë Devoll është **2,319,492 lekë**. Diferenca prej **124,908 lekë** përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Devoll. Kjo diferencë ka ardhur nga llogaritja e gabuar e taksës për katin nëntokë dhe katin përdhe (me funksione respektive parkim dhe shërbime), në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 168, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 132, datë 07.03.2018...”, Aneksi 2, pika a). (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 156-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll të marren të gjitha masat për të përlllogaritur në mënyrë të saktë vlerën e taksës së

ndikimit në infrastrukturë, duke e marrë në konsideratë koeficientet e çmimeve mesatare referuese të shitblerjes së hapësirave që përdoren për veprimtari ekonomike, tregtimi dhe shërbimi, si dhe për parkim të mbuluar dhe bodrume.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (SPZHT), Bashkia Devoll, të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit për TNI e pa llogaritur në shumën 124,908 lekë, nga zhvilluesi z. K.Q. për lejen e ndërtimit nr. 2061/1 prot; datë 06/09/2022 me objekt “Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat me çati dhe 1 kat parkim nëntokë”.

Brenda datës 30.03.2024

E. MASA DISIPLINORE.

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Devoll, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

A. “Vërejtje me paralajmërim” në zbatim të pikës “a” të nenit 58, për 7 punonjës;

1. **Zj. E.A.**, me detyrë Specialiste prokurimesh, në cilësinë e përgjegjës të prokurimeve, hartuesit të kriterëve të kualifikimit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e prokurimit në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit për mos argumentimin, mos dokumentimin e llogaritjes së fondit limit, kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 6 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).
2. **Z. R.H.**, me detyrë Specialist, në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në cilësinë e kryetarit të KVO, për shkeljet e konstatuar në vlerësimin e ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).
3. **Z. G.K.**, me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik në 2 procedura, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e konstatuar në vlerësimin e ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).
4. **Zj. A.H.**, me detyrë Specialiste e PAK, në sektorin e Shërbimeve Sociale, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. (*Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156*).
5. **Z. N.L.**, me detyrë kryeinspektor i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtrimin e

inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

6. **Z. F.Ç.**, me detyrë inspektor pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

7. **Z. J.S.**, me detyrë inspektor pranë Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara, për mos-ushtimin e inspektimit në objektet e pajisur me leje ndërtimi, për lejimin e zhvillimit të objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, si dhe për mos-evidentimin e shmangieve nga projekti i miratuar të objekteve të pajisur me leje përdorimi në një rast. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

B. “Vërejtje” në zbatim të pikës “b” të nenit 58, për 12 punonjës:

1. **Znj. T.S.**, në funksionin e drejtorit pranë Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në lidhje me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit për **3 (tre)** raste, me problematika si: mosrespektim i kondicioneve urbane në një rast; miratimi i lejeve të ndërtimit me mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj në **3 (tre)** raste; për përllogaritjen e gabuar të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në **1 (një)** rast; nuk është kërkuar dhe respektuar mendimi i autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në **2 (dy)** raste. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 156-167).*

2. **Znj. A.F.** me detyrë Përgjegjëse i Sektorit të Menaxhimit Financiar: Për mos kuadrimin e llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar” me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtimore” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Duke nënvlerësuar llogarinë 520 “Disponibilitet në thesar” në vlerën 20,627,875 lekë. Për arsye se në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë përfshirë projekti “Përmirësimi i infrastrukturës Shkolla Miras” në vlerën 1,562,000 lekë (kosto historike) i cili nuk duhej të kontabilizohet në këtë llogari pasi investimi për të cilin është hartuar ky projekt ka përfunduar dhe si rrjedhojë edhe vlera e projektit duhet të kishte kaluar në vlerën e investimi për pasojë vlera e kësaj llogarie në pasqyrat financiare nuk është e saktë. Për mos kuadrim të shumatores së llogarisë 230 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” me mbylljen e shumatores së llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” dhe llogarisë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë. Për mos kuadrim të përmbledhëses së llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, 435 “Sigurime shoqërore”, 436 “Sigurime shëndetësore”, 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”. Për arsye se informacioni kontabël i llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 120,774,784 lekë. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 59-90).*

3. **Z. G.H.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Lejeve dhe Licencave, për mos ndjekjen e të gjitha rrugëve për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tatimet për debitorët në vlerën 34,559,770 lekë. Për mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë dhe biznesit. Për tarifimin jo të saktë të taksës së ndërtesës dhe të truallit. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 42-59).*

4. **Znj. E.M.**, me detyrë Specialiste në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

5. **Z. E.K.**, me detyrë përgjegjës i sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

6. **Z. K.M.**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të transporti në Agjencinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 2 procedura prokurimi. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

7. **Z. M.M.**, me detyrë Drejtor i Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

8. **Z. Th.K.**, me detyrë Specialist në sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e hartuesit të kriterëve të kualifikimit, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, në 1 procedurë prokurimi. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

9. **Z. R.K.** anëtarë i Njësisë së Prokurimit; Për arsye vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe vlerën e kontratës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021 nga Bashkia Devoll. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

10. **Z. F.Z.** anëtarë i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

11. **Znj. M.H.** anëtarë i Komisionit të Vlerësimit të Oferta *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*ve, për arsye se ka shpallur fitues BOE “A. II” Shpk & “N.” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur, për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Bilisht-Vernik Loti II” me fond limit në vlerën 47,802,971.60 lekë pa Tvsh, zhvilluar në vitin 2021 nga Bashkia Devoll. *(Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit në faqet 90-156).*

C. Për punonjësit **z. A.C., znj. A.K., znj. E.B., z. E.B., znj. K.B., z. M.H., znj. E.N., z.V.Q., z. G.XH., z. A.M., z. G.K., z. E.L. dhe z. J.S.** nuk rekomandojmë masë disiplinore për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një rëndësie të ulët dhe nuk janë materiale.

D. Për punonjësin **znj. M.H.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit Financiar nuk rekomandojmë masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara

ekzistojnë, pasi punonjësi nuk është në marrëdhënie pune në këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e masës disiplinore.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT